



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 39 regjistër (JR)
Datë 21.09.2020

Nr. 38 i vendimit
Datë 24.10.2022

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Natasha Mulaj	Kryesuese
Ina Rama	Relatore
Albana Shtylla	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare
Sokol Çomo	Anëtar

- mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 24.10.2022, ditën e hënë, në orën 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Theo Jacobs, me Sekretare Gjyqësore Elba Arapi, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit, znj. Fatmira Hajdaraj (Hajdari), gjyqtare në Gjykatën e Apelit Tiranë.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 265, datë 18.06.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Fatmira Hajdaraj (Hajdari).

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 2,3,5 dhe 10, i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Nenet A, Ç, D, DH, E dhe F, pika 2, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ndryshuar me ligjin 76/2016, datë 22.07.2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”.

Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

Ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

Nenet 1, 2, 63 dhe 66, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” .

Neni 6 i “Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Trupi gjykes i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi shkaqet dhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit të paraqitura në ankim dhe në parashtrime, e cila përfundimisht kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 265, datë 18.06.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin në detyrë, dëgjoji relatorin e çështjes, gjyqtaren Ina Rama, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Fatmira Hajdaraj (në vijim subjekti i rivlerësimit), për shkak të ushtrimit të funksionit të gjyqtarës në Gjykatën e Apelit Tiranë, në kohën e hyrjes në fuqi të nenit 179/b të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji 84/2016), i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio* nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”).
2. Komisioni, në funksion të zhvillimit të procesit të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, bazuar në përcaktimet e neneve 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, ka administruar raportet e dërguara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”), si dhe Këshilli i Lartë Drejtësisë (në vijim “KLD”) .

2.1. Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së, pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë të subjektit të rivlerësimit¹, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar², duke konstatuar se:

- (i) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
- (ii) nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- (iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë;

¹ Subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar deklaratën e pasurisë pranë ILDKPKI-së, brenda afatit ligjor, në përputhje me nenet 31, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

² Raporti i ILDKPKI-së, përcjellë në Komision me nr. {***} prot., datë 2.11.2017.

- (iv) nuk ka kryer deklarin të rremë;
- (v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

2.2. DSIK-ja, pasi kreu kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, znj. Fatmira Hajdaraj, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016, në përputhje me nenin 39 të këtij ligji, ka dërguar raportin për kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, ku ka konstatuar *përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, znj. Fatmira Hajdaraj (Dosku).*

2.2.1. Komisioni, në përmbushje të kompetencës për realizimin e një procesi të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi në lidhje me kontrollin e figurës, nga hetimi i fakteve dhe rrethanave të nevojshme, konstatoi se subjektit të rivlerësimit i ishte revokuar VISA e tipit B1/B2 për në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ndërkohë që për këtë fakt subjekti ishte përgjigjur me *jo* në deklaratën për kontrollin e figurës. Nisur nga këto fakte, Komisioni i ka kërkuar DSIK-së rishikimin e raportit mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit³.

2.2.2. DSIK-ja, me qëllim integrimin e informacioneve të ardhura pas afatit ligjor të përfundimit të procedurave të kryera nga Grupi i Punës për Kontrollin e Figurës, ka dërguar raportin e rishikuar për subjektin e rivlerësimit⁴, duke informuar se: *“Në vlerësim të të dhënave të ardhura pas konstatimit fillestar mbi subjektin e rivlerësimit, referuar parashikimeve të nenit DH, pika 4 të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, subjekti i rivlerësimit, znj. Fatmira I. Hajdaraj, evidentohet se ka bërë deklarin të pasaktë në plotësimin e Deklaratës për Kontrollin e Figurës, konkretisht në germën ‘g’, të pjesës Nr. 5, ‘Të dhëna për sigurinë’. Mosdeklarimi në këtë rast e ngarkon znj. Fatmira Hajdaraj me përgjegjësinë e fshehjes së faktit dhe me plotësimin jo me vërtetësi të Deklaratës për Kontrollin e Figurës, për rrjedhojë rishikohet konstatimi në raportin fillestar për subjektin e rivlerësimit dhe arrihet në përfundimin mbi papërshtatshmërinë e vijimit të ushtrimit të detyrës për subjektin e rivlerësimit, znj. Fatmira I. Hajdaraj”.*

3. Bazuar në nenin Ç të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara për subjektin e rivlerësimit nga ILDKPKI-ja dhe DSIK-ja, kreu procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, bazuar në kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe kriterin e vlerësimit të figurës, duke marrë vendimin nr. 265, datë 18.06.2020.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

4. Komisioni, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin D, pikat 1,3, 5 dhe nenin DH, pikat 2 dhe 4 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe në pikat 3 dhe 5, të nenit 61, të

³ Shkresat nr. {***} prot., datë 21.01.2019, nr. {***} prot., datë 21.10.2019 (kërkesë për informacion lidhur me datën e dorëzimit të formularit të kontrollit të figurës dhe dokumentacion/libri i protokollit), nr. {***} prot., datë 28.10.2019 (kërkesë për rishikimin e raportit, në funksion të përfshirjes së informacioneve të dërguara nga DSIK-ja me shkresat nr. {***} prot., 02.05.2018, nr. {***} prot., datë 04.02.2019, nr. {***} prot., datë 25.02.2019, nr. {***} prot., datë 12.03.2019, interpretimin e të dhënave me sa konkluduar nga DSIK-ja, rishikimin e konkluzionit të raportit); nr. {***} prot., datë 17.01.2020 (kërkesë për rishikim të raportit, konsiderimin për efekt vlerësimi të informacioneve shtesë të dërguara nga DSIK-ja në Komision).

⁴ DSIK-ja, me shkresën me nr. {***} prot., datë 25.01.2020, ka përcjellë raportin për kontrollin e figurës, të rishikuar me kërkesë të Komisionit, i deklasifikuar plotësisht me vendim nr. {***}, datë 6.2.2020, të KDZh-së.

ligjit nr. 84/2016, me vendimin nr. 265, datë 18.06.2020, vendosi shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, bazuar në konkluzionet e mëposhtme.

4.1. Për kriterin e vlerësimit të pasurisë:

- (i) *Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tij, sipas pikës 1, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.*
- (ii) *Subjekti i rivlerësimit nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave të përmendura në këtë vendim, referuar nenit D, paragrafi 3 i Aneksit të Kushtetutës.*
- (iii) *Subjekti i rivlerësimit është përpjekur të fshehë dhe ka paraqitur në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, zotërim dhe përdorim të tij, referuar nenit D, paragrafi 5 i Aneksit të Kushtetutës.*
- (iv) *Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë, sipas parashikimeve të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.*

4.2. Për kriterin e kontrollit të figurës:

Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë, bazuar në pikat 2 dhe 4, të nenit DH të Aneksit të Kushtetutës së Shqipërisë, pasi ka plotësuar formularin e deklaramit për kontrollin e figurës në mënyrë të pasaktë dhe jo në përputhje me parashikimet e germës “g”, të kreut V “Të dhëna për sigurinë”, si dhe ka fshehur fakte të ndodhura, sipas nenit 39 të ligjit nr. 84/2016.

III. Shkaqet e ankimit

5. Kundër vendimit nr. 265, datë 18.06.2020, të Komisionit, në respektim të afateve dhe kërkesave ligjore⁵, subjekti i rivlerësimit ushtroi ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelit (në vijim “Kolegji”), duke pretenduar se vendimi është marrë mbi bazën e një hetimi administrativ të pjesshëm, të njëanshëm, në kundërshtim me normat procedurale, në zbatim të gabuar të së drejtës materiale, pasi është mbyllur procesi hetimor pa i dhënë mundësi për plotësimin me dokumentet përkatëse, duke mbetur hetimi i paplotë, i cili ka çuar në vendimmarrjen e gabuar.

5.1. Para shqyrtimit të çështjes në seancë gjyqësore publike, subjekti i rivlerësimit ka dërguar në Kolegj parashtrime me shkrim dhe akte në datën 12.10.2022⁶.

6. Subjekti i rivlerësimit, kundërshtoi konkluzionet e Komisionit, duke pretenduar se nuk ka asnjë rrethanë që kërkohet nga neni 61, pika 5 e ligjit 84/2016, e cila do të përbënte shkak për shkarkimin e saj nga detyra dhe bazuar në nenin 66, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, kërkoi që Kolegji të marrë në shqyrtim shkaqet e ankimit dhe të vendosë:

⁵ Komisioni, me shkresën nr. {***} prot., datë 10.08.2020, përmes shërbimit postar, ka përcjellë vendimin e arsyetuar me shkrim në adresën e vetëdeklaruar prej subjektit në procesin e rivlerësimit, kthyer dy herë nga shërbimi postar me shënimin “objekt i pa kërkuar”. Në këto kushte, në datën 18.08.2020, Komisioni ka përcjellë vendimin e skanuar në adresën e postës elektronike të subjektit, deklaruar prej saj në procesin e rivlerësimit, konfirmuar prej subjektit marrja e tij në datën 19.08.2020. Me nr. {***} prot., datë 8.09.2020, është regjistruar në Komision ankimi i paraqitur prej subjektit ndaj vendimit të Komisionit nr. 265, datë 18.06.2020. Komisioni, bazuar në nenet 453 dhe 455/a të Kodit të Procedurave Civile, i ka kthyer subjektit ankimin për plotësim të të metave brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit të kryer me shkresën nr. {***} prot., datë 11.09.2020, konfirmuar marrja e njoftimit në datë 22.09.2020. Subjekti ka paraqitur ankimin e plotë, administruar në Komision me nr. {***} prot., datë 14.09.2020, i pranuar nga Komisioni me vendimin nr. {***}, datë 14.09.2020, “Për pranimin e ankimit”.

⁶ Administruar me nr. {***} prot., datë 12.10.2022.

- o Ndryshimin e vendimit nr. 265, datë 18.06.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.
- o Rihapjen e hetimit në lidhje me:
 - a) Kriterin e rivlerësimit të pasurisë dhe rivlerësimit të figurës, pasi do të depozitojë prova të reja për të vërtetuar të kundërtën e konkluzioneve të Komisionit.
- o Hapje të hetimit në lidhje me:
 - b) Vlerësimin e aftësive profesionale, kërkesë kjo e bërë pranë Komisionit gjatë hetimit dhe në seancën dëgjimore të procesit të rivlerësimit.
- o Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Fatmira Hajdaraj, me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.

7. Shkaqet e ankimit, lidhur me aspektet procedurale të gjykimit, si dhe të zbatimit të ligjit material, parashtrohen në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.

7.1. Vendimi është marrë mbi bazën e një hetimi të paplotë, pa u bazuar në Kushtetutë dhe në ligjin nr. 84/2016, pasi nuk është kryer hetim administrativ për të tria kriteret e rivlerësimit.

7.2. Komisioni ka kryer të gjithë proceset procedurale dhe shpalljen e vendimit pa përfunduar ende periudha e gjendjes së jashtëzakonshme, në datën 23.06.2020, periudhë gjatë së cilës nuk mund të siguronte asnjë provë shtesë në afatin e përcaktuar fillimisht nga Komisioni, datë 23.03.2020, por edhe në afatet në vijim.

7.3. Komisioni nuk i ka dhënë mundësinë, për plotësim më shterues të pyetësorëve gjatë hetimit administrativ kryesisht, veçanërisht për pyetjet, për të cilat ka bërë me dije se i është drejtuar institucioneve të ndryshme apo individëve, si dhe nuk ka disponuar lidhur me kërkesën e saj për shtyrje të afatit të hetimit [riçelje të hetimit administrativ].

8. Shkaqet e ankimit, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, në aspekt të konstatimit të drejtë të situatës faktike dhe zbatimit të ligjit material, parashtrohen në mënyrë të përmbledhur si vijon.

8.1. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të pabazuar konkluzionin e Komisionit se *nuk ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin, interesat private në vitin 2003 dhe në deklaratën vetting, në lidhje me burimin e krijimit të apartamentit të ndodhur në rrugën “{***}”, blloku i {***}, në qytetin e Tiranës*, duke pretenduar se: (i) burimi i krijimit të pasurisë apartament është deklaruar saktë: kursime familjare; (ii) deklarimi në deklaratën e rivlerësimit *vetting*, ku është shënuar vetëm vlera e blerjes fillestare dhe është ndarë vlera prej 2.5 milion e investimit në rikonstrukcion e marrë nga Banka e Kursimeve, nuk ndryshon nga deklarimi i kësaj pasurie në deklaratën e interesave private të vitit 2003.

8.2. *Lidhur me pasuritë tri njësi dhe 12 apartamente në një objekt 10-katësh, të ndërtuar në truallin me sipërfaqe 433,3 m², të ndodhur në rrugën “{***}”, blloku i {***}, në qytetin e Tiranës*, subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të pabazuar konkluzionet e Komisionit si vijon.

8.2.1. *Se nuk ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin në DIPP-të e viteve përkatëse, investimin, fillimin dhe përfundimin e punimeve të kryera në ndërtesën informale 5-katëshe karabina, në kundërshtim me germën “a”, të pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016*, duke pretenduar se: (i) investimi në godinë fillon me investimin e bërë nga z. E.B.[shoqëria “{***}” ShPK], në bazë të marrëveshjes verbale të tij me djalin e subjektit, si një marrëdhënie *kleringu*, ku vlerat do të shlyheshin në përfundim të ndërtimit dhe djali i subjektit nuk kishte dijeni sa ishte vlera e materialeve të ndërtimit të sjella nga kjo shoqëri, e cila do të shkëmbehej me sipërfaqe ndërtimore pas rakordimeve në përfundim të ndërtimit; (ii) në vitin 2012, kur filloi ndërtimi i

godinës, djali i subjektit nuk kishte dijeni nëse ndërtimi do të vijonte apo do të merreshin masa administrative për ta prishur; (iii) në deklaratën e interesave private të vitit 2013 ka deklaruar aktmarrëveshjen private nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 04.06.2013, në të cilën janë shënuar të dhënat përkatëse; (iv) për përfundimin e punimeve të ndërtimit në vitin 2014 nuk ka pasur pse të deklaronte situacionet e punimeve të të tretëve, për sa investimi i djalit prej 207.400 eurosh, i deklaruar në vitin 2013, është konsideruar i përfunduar po në vitin 2013 dhe në vitet vijuese nuk pati shtim të investimit nga ana e tij.

8.2.2. *Se nuk ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin pasurinë truall 142 m², të përfitur në vitin 2013, por kjo e vetme nuk mund të përbëjë shkak për shkarkim, duke qenë se ka deklaruar sipërfaqen totale të truallit, përfshirë edhe sipërfaqen 142 m², duke pretenduar se: (i) pronësinë e truallit me sipërfaqe 142 m² e ka fituar me vendim të gjykatës dhe e ka deklaruar në deklaratën e interesave private të vitit 2013, si rritje të sipërfaqes së tokës truall të deklaruar në vitin 2003; (ii) sipërfaqja 142 m² ka qenë pjesë e procesit të legalizimit të finalizuar në janar 2016 dhe regjistruar e gjithë pasuria në ZVRPP-në Tiranë, në prill 2016; (iii) në deklaratën e interesave private të vitit 2014 është deklaruar rritja e sipërfaqes truall, ndërsa në vitin 2015 nuk është përsëritur deklarimi, pasi nuk kishte ndryshime nga viti 2014.*

8.2.3. *Se nuk ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin, në deklaratën e interesave privatë të vitit 2015, sipërfaqen e tokës truall 150 m², të përfitur me VKM-në nr. 823, datë 7.10.2015 dhe kontratën për kalimin e pronësisë së disa parcelave ndërtimore nr. {***}, datë 23.12.2005, duke pretenduar se: (i) kontrata e shitblerjes së truallit me sipërfaqe 150 m², me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 23.12.2015, me palë shitëse ALUIZNI, ka qenë pjesë e të gjithë procesit të legalizimit, dërgohej për regjistrim pranë ZVRPP-së nga vetë ALUIZNI; (ii) për kontratën e shitblerjes na u pohua se do të konsiderohej e përfunduar vetëm pas legalizimit të godinës dhe regjistrimit të saj në ZVRPP, regjistrim i cili do të kryhej nga ALUIZNI; (iii) ky truall së bashku me godinën është regjistruar në datën 19.04.2016, pas dorëzimit të deklaratës së interesave privatë më datë 31.03.2015 dhe, për këtë shkak, nuk u bë pjesë e deklarimit për vitin 2015; (iv) trualli me sipërfaqe 150 m² është deklaruar në deklaratën e interesave privatë të vitit 2013, si pjesë e sipërfaqes totale rreth 890 m², e cila përfshin sipërfaqen e truallit 595,3 m² blerë nga Enti Kombëtar i Banesave në vitin 1995, sipërfaqen 142 m² të fituar me vendim gjykate në vitin 2013, si dhe sipërfaqen 150 m², të deklaruar në korrik 2013, pranë ALUIZNI-t.*

8.2.4. *Për burimin e krijimit të shumës 207.400 euro të investuar në karabinanë 5-katëshe dhe kolonat e katit të 6-të se nuk deklaroi në mënyrë të qartë në deklaratën vetting burimin e krijimit të kësaj shume dhe periudhën gjatë së cilës është kryer investimi. Vetëm në seksionin e detyrimeve financiare ndaj personave fizikë dhe juridikë, subjekti ka deklaruar një detyrim në vlerën prej 10.000.000 lekësh, shumë e marrë nga personi i lidhur, z. K.H., në formën e materialeve të ndërtimit në fazën e ndërtimit të karabinasë, si pjesë e financuar prej tyre, duke pretenduar se: (i) në deklaratën e rivlerësimit të pasurisë vetting, qartësisht janë deklaruar në formularët përkatës detyrimi në shumën 10 milion lekë ndaj z. G. B. [{"***"} ShPK], e marrë në formën e materialeve të ndërtimit, si dhe shuma 160.000 euro e përfitur nga shitja e biznesit të djalit K.H., shitja e investimit të kryer në ambientin e marrë me qira, investim i realizuar me kredinë e marrë nga "Alpha Bank"; (ii) burimi i krijimit të shumës 207.400 euro, i sqaruar me deklaratimet në deklaratën e rivlerësimit të pasurisë vetting, është sqaruar, gjithashtu, me përgjigjet e pyetësorëve, si dhe të dokumentacionit të dorëzuar.*

8.2.5. *Se nuk dorëzoi dokumentacion të nevojshëm provues, lidhur me lindjen e detyrimit ndaj shtetasit G. B., se nuk e ka deklaruar këtë detyrim për vitet 2012, 2013, 2014 dhe 2015, për pasojë ka bërë deklarim të pasaktë në deklaratet periodike vjetore dhe se nuk provoi me dokumentacion justifikues ligjor marrjen e materialeve të ndërtimit në vlerë prej 10.000.000 lekësh, për pasojë subjekti ka mungesë të burimit të krijimit të kësaj shume të përdorur për ndërtimin e karabinasë 5-katëshe, duke pretenduar se: (i) për sa marrëveshja e kleringut mes djalit dhe z. G. B. ishte verbale nuk ka pasur çfarë dokumentacioni të depozitonte, përpos deklaratës të z. G. B.; (ii) nuk e ka deklaruar detyrimin në deklaratën e interesave privatë të vitit 2012, pasi sipas marrëveshjes verbale, nëse godina nuk do të legalizohej dhe prishej, detyrimi do të ishte 0 (zero) lekë; (iii) në shpjegimet e datës 05.06.2020 ka insertuar 115 fletëdaljet që dispononin të sjella nga shoqëria “{***}” ShPK, dokumentacioni justifikues ligjor që vërteton marrjen e materialeve nga kjo shoqëri.*

8.2.6. *Se nuk arriti të provonte investimin e kryer nga djali për këtë godinë, pasi nuk paraqiti dokumentacion justifikues ligjor, i cili të vërtetonte këtë investim, sipas deklaratave të saj, duke pretenduar se: (i) në vitet 2007-2009, kur i biri ka realizuar investimin, nuk kërkohej leje specifike nga organet kompetente që mbulonin territorin, i cili do të shërbente si dokument; (ii) për kohën e gjatë, faktin se investimi dhe biznesi janë shitur, nuk janë ruajtur dokumentet e blerjeve; (iii) në fillim të vitit 2007, pas bisedave verbale me sektorin që mbulonte dhënien e pronave shtet me qira të ish-METE, verbalisht iu rekomandua të dakordësonte me Drejtorinë e Qytetit Studenti për të marrë ndonjë prej ambienteve të ish-mensës së Qytetit Studenti e shkatërruar dhe e parikonstruktuar në një pjesë të konsiderueshme, me kushtin, që pas përfundimit të investimit në të, ta vinte në shfrytëzim vetëm pas lidhjes së një kontrate qiraje me ish-METE-n; (iv) në bazë të këtij rekomandimi, në bisedime me Drejtorinë e Qytetit Studenti, u pa ambienti me sipërfaqe 306,5 m², në kat të dytë, për të cilin u përcaktuan zërat e punimeve për ta kthyer në gjendje pune, si dhe djali filloi negociatat me “Alpha Bank”, për të mbuluar një pjesë të investimit; (v) formularët Tip dhe disa prej dokumenteve në dosjen e kredisë i kanë plotësuar specialistët e bankës dhe subjekti është bërë me dije për to në takim zyrtar në ILDKPKI; (vi) në kontratën e huas me “Alpha Bank”, nënshkruar prej saj, deklarohet se shuma është për rikonstruksion godine, pa specifikuar që godina është shtëpia e saj e banimit; (vii) qëllimi i përdorimit të kredisë është deklaruar në deklaratën e interesave privatë të pasurisë 2008.*

8.2.7. *Se nuk provoi me dokumentacion ligjor justifikues deklarimin dhe pagimin e detyrimeve tatimore mbi këtë të ardhur, për rrjedhojë shuma 160.000 euro nuk përmbush kriteret e pikës 3, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe, si e tillë, nuk merret në konsideratë nga Komisioni, duke pretenduar se: (i) shuma prej 160.000 eurosh nuk përfshin asnjë vlerë “fitim të munguar”, por investimin, inventarin e pajisjeve dhe mobilimin e kryer nga djali në ish-Sallën e Lojërave të {***}, zëra të cilët janë të patatueshëm për shkak të amortizimit në kohë; (ii) në aktmarrëveshjen, me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 06.06.2012, mes djalit të subjektit, shtetasve E.H. e F.P. dhe bashkëpronarëve T., shprehja “fitim i munguar” mbeti e pakorrigjuar në përfundim të negociatave, ku pala blerëse nuk pranoi të paguante aforfe, për sa nuk vërtetohej fitimi i realizuar nga djali i saj.*

8.2.8. *Se nuk provoi me dokumentacion ligjor justifikues të ardhurat e personit tjetër të lidhur, z. S.T., me pretendimet se: (i) z. S.T. ka lidhur marrëveshje private me djalin e subjektit, në cilësinë e investitorit në godinën 10-katëshe dhe pas lidhjes së marrëveshjes, nga djali i subjektit nuk u krye më asnjë investim në godinë deri në përfundimin e punimeve të ndërtimit; (ii) investimi i*

djalit në godinë kishte përfunduar përpara lidhjes së marrëveshjes me z. S.T.; (iii) investimi i z. S.T. në godinë kishte burim të ardhurat nga shitjet me kontrata porosie.

9. Lidhur me pasurinë, njësi me sipërfaqe 67 m², në “{***}”, subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të pabazuar konkluzionin e Komisionit se *ndërmjet deklaratës vetting dhe deklaratës periodike të vitit 2003 ka mospërputhje në deklarinimet lidhur me burimin e krijimit të dyqanit me sip. 67,5 m² dhe ka dyshime për çmimin e blerjes së pasurisë, pasi sipas kontratës së porosisë vlera e përcaktuar për këtë pronë është 125.000 USD, ndërkohë që sipas kontratës së shitjes çmimi është 1.700.000 lekë, me pretendimet se: (i) shuma e përdorur për blerjen e pasurisë dhe për shpenzimet administrative dhe noteriale përkatëse është siguruar nga shitja e apartamentit në rrugën “{***}”, në vlerën 2 milion lekë; (ii) apartamenti në rrugën “{***}” i është dhuruar nga kunati, por është kaluar me transaksion “blerje” në funksion të kredisë së marrë nga Banka e Kursimeve, kredi përdorur për rikonstruksionin e shtëpisë në rrugën {***}, në Tiranë dhe, për këtë arsye, në deklaratën e interesave privatë të vitit 2003, burimi i krijimit të njësisë është deklaruar “dhurim nga kunati”; (iv) kontrata e sipërmarrjes me shoqërinë “{***}” ShPK, një kontratë Tip, u plotësua për rezervimin e njësisë dhe nuk është paguar asnjë vlerë deri në lidhjen e kontratës së shitjes së njësisë me çmim në vlerë kosto prej 1.7 milion lekësh.*
10. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të pabazuar konkluzionin e Komisionit se *nuk ka bërë deklarinim të mjaftueshëm në lidhje me pasurinë automjet tip “Mercedes-Benz”, me targë {***}, pasi ka pasaktësi në deklarime dhe mungesë të të ardhurave të ligjshme, shoqëruar me dokumentacion justifikues ligjor nga personi tjetër i lidhur/motra e subjektit, duke pretenduar se: (i) në deklaratën vetting, në mungesë të mandatpagesave dhe sqarimeve të motrës së ndjerë, u vendos vlera sipas faturës së zhdoganimi; (ii) në deklaratën e interesave privatë të vitit 2003 është shënuar vlera 18.000 euro që përfshin blerjen e mjetit të koncesionari në Frankfurt dhe shpenzimet e tjera deri në mbërritjen e mjetit në Shqipëri; (iii) nuk e ka deklaruar vlerën e huas prej 20.000 eurosh të marrë nga motra në vitin 2009, duke e konsideruar si një marrëdhënie brenda familjes, ku 10.000 euro janë likuiduar brenda vitit 2009 dhe vetëm aktualisht që trashëgimtarët e motrës nuk ja njohin pjesën e mbetur të detyrimit, mundet ta konsiderojë atë si dhurim.*
11. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të pabazuar konkluzionin e Komisionit, lidhur me pasurinë e llojit ullishte me sipërfaqe 950 m², Durrës, se *nuk ka deklaruar saktë në deklaratat e interesave privatë për vitet 2003 dhe 2004, pasuritë në pronësi të saj, duke pretenduar se: (i) shumën për shitjen e kësaj pasurie e kishte marrë përpara se të emërohej në detyrën e gjyqtares, përpara muajit nëntor 2003, pa u finalizuar kontrata e shitjes për shkak të kryerjes së disa procedurave të panjohura më parë prej tyre; (ii) për faktin se asnjë marrëdhënie financiare [as blerja dhe as shitja] nuk janë bërë para fillimit të ushtrimit të detyrës së gjyqtares ka menduar të mos i shënojë në deklaratat e pasurive, sikundër nuk ka shënuar në deklarinim as dhurimin nga kunati të apartamentit në bulevardin “{***}” dhe as shitjen e tij.*
12. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të pabazuar konkluzionin e Komisionit se *ka bërë deklarinim të pasaktë, për shkak se nuk ka deklaruar pronësinë e kuotave të shoqërive “{***}”, dhe të “{***}”, ShPK, në emër të personit të lidhur K.H. në deklaratën vetting dhe ka mungesë të dokumentacionit ligjor justifikues, lidhur me burimin e krijimit të këtyre kuotave nga dhuruesit, duke pretenduar se: (i) nuk është vënë në dijeni nga personi i lidhur, djali, për kryerjen e veprimeve noteriale për këto kuota; (ii) për asnjërin prej tyre nuk pati transferim shume, shpërndarje fitimi a dividendi në përfundim të vitit ushtrimor financiar; (iii) personi i lidhur, djali,*

ka pasur detyrimin për deklarim të këtyre dhurimeve, por nuk ka pasur çfarë të deklaronte për faktin se nuk ka paguar dhe nuk ka fituar asgjë.

13. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të pabazuar konkluzionin e Komisionit se *bazuar në pikën 5, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, situata ligjore dhe faktike për ndërtimin pa leje të objektit 10-katësh, parë në vlerësimin tërësor, në kuptim të pikës 2, të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, vlerësohet se çon në rezultatin se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut dhe cenimin e etikës së magjistratit*, duke pretenduar se: (i) besimi publik dhe etika e magjistratit nuk mund të cenohen nga një ndërtim pa leje i realizuar me iniciativën e personit të lidhur, djalit; (ii) arsyeja e mospasjes së lejes së ndërtimit është fakti i mospasjes pronësi mbi të gjithë parcelën ndërtimore, e cila ishte në posedim të pandërprerë nga familja jonë prej vitit 1995; (iii) për personin e lidhur, djalin, nxitës ishin politikatat që me miratimin e ligjit “Për Urbanistikën”, në vitin 1998 e ligjet vijuese deri në vitin 2014, hapën rrugën si për dënim të atyre që ndërtonin pa leje, ashtu edhe për legalizim të atyre që ndërtonin pa leje, për më tepër në kushtet kur toka nuk ishte në pronësi të askujt, dikur kishte qenë përrua dhe për shkak të ndërtimeve në të gjithë zonën përreth i takonte vetëm familjes sonë.
14. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të pabazuar konkluzionin e Komisionit se *subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë mungesë të ardhurash të ligjshme për blerjen e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve në vlerën 18.799.664 lekë për periudhën përpara vitit 2003 dhe në vlerën totale prej 80.805.536 lekësh, për vitet 2003, 2005, 2006, 2007, 2008, 2009, 2010, 2011, 2012, 2013, 2015 dhe 2016*, duke pretenduar se: (i) ndryshime të vlerave sipas viteve në bazë shpjegimeve të dhëna prej saj, përfshirje të disa vlerave të papërfshira, kryesisht të likuiditeteve *cash*, për të cilat deklaroi se për reflektimin e këtyre shumave në deklaratat e interesave private është bërë me dije me vonesë nga institucioni përkatës; (ii) të gjithë vitet kalendarike, qysh para vitit 2003 e deri në dhjetor 2016, dalin me balancë pozitive, përfundim që sipas saj, për të gjithë periudhën e analizuar, ajo dhe familja kanë pasur burime të ligjshme dhe në rastet e kredive, huave, apo investimeve me risk ka pasur gjithmonë mundësi likuidimi.
15. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të pabazuar konkluzionin e Komisionit për kontrollin e figurës, duke pretenduar se: (i) është konkluzion i pambështetur në ligj, bazuar në hetim të përpiluar, pasi nuk u paraqit asnjë provë e vetme që të vërtetonte se në datën 27 janar 2017 është vënë në dijeni të revokimit të vizës nga Ambasada e ShBA-së në Tiranë; (ii) njoftimi përmes komunikimit telefonik për t’u paraqitur pranë Ambasadës së ShBA-së ka qenë pas datës 27.01.2017, kur ka dorëzuar formularin pranë DSIK-së; (iii) njoftimi i parë i Ambasadës së ShBA-së, për revokim të vizave të disa gjyqtarëve dhe prokurorëve, mban datën 26.01.2017, i cili u reflektuar në të gjithë mediat e shkruara dhe *audiovizive* ishte pa emra konkretë.

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelit

A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

16. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna, sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, me objekt kundërshtimin e vendimit të Komisionit,

i cili ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Legjitimimi i ankuesit

17. Ankuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe të nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 e ligjit nr. 84/2016.

c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

18. Në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin 49 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012”), trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim “trupi gjykues”), fillimisht mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi vendimin e Komisionit nr. 265, datë 18.06.2020. Në këndvështrim të pretendimeve të parashtruara në ankim nga subjekti i rivlerësimit, lidhur me procesin e rregullt ligjor dhe konstatimin në mënyrë të plotë të gjendjes faktike, trupi gjykues nuk evidentoi shkelje procedurale apo konstatim të gabuar të situatës faktike, të cilat në kuptim të nenit 51 të ligjit nr. 49/2012, do të sillnin nevojën e debatit gjyqësor në seancë gjyqësore publike për korrigjimin e tyre.

18.1. Nga shqyrtimi tërësor i parashtrimeve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues konstatoi se ato dhe dokumentacioni bashkëlidhur ndërlidhen me pretendimet e parashtruara prej saj për disa prej shkaqeve të ankimit, konkretisht si vijon.

18.1.1. Për pretendimin se kredia e marrë në “Alpha Bank” është përdorur për rikonstruksionin e ambientit të marrë me qira në Qytetin Studenti nga personi i lidhur, subjekti paraqiti: (i) kërkesë e subjektit të rivlerësimit, drejtuar Drejtores së Rezidencës Studentore Universitare nr. {***}, datë 30.09.2022; (ii) shkresë nr. {***} prot., datë 07.10.2022, e Rezidencës Studentore Universitare nr. {***}, ShA., drejtuar subjektit të rivlerësimit në përgjigje të kërkesës sipërcituar, bashkëlidhur së cilës janë përcjellë - kërkesë e personit të lidhur K. H. drejtuar drejtorit të shoqërisë “Trajtimi i Studentëve nr. {***}”, për dhënien me qira të një ambienti për ushtrim aktiviteti privat - vendim nr. {***}, datë 08.01.2007, i Këshillit Mbikëqyrës i “Trajtimi i Studentëve Nr. {***}, Tiranë”, ShA., sipas së cilit është miratuar propozimi i shoqërisë nr. {***}, datë 28.12.2006, për dhënien me qira të një ambienti që ndodhet në ish-mensën e Qytetit Studenti, për subjektin K. H. sipas kontratës tip të miratuar. Trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit i ka paraqitur këto dokumente pas depozitimit të ankimit, kur ligji lejon vetëm paraqitjen e parashtrimeve, nuk ka provuar se pa fajin e saj këto dokumente nuk janë paraqitur në Komision. Trupi gjykues, bazuar në nenin 47 të ligjit nr. 49/2012, si dhe duke vlerësuar se fakti që kërkohet të provohet përmes këtyre dokumenteve rezulton i provuar gjatë gjyqimit, bazuar në shkronjën “b”, pika 6 e nenit 49 e ligjit nr. 84/2016, refuzon marrjen e këtyre dokumenteve në cilësinë e provës.

18.1.2. Për të provuar lidhur me burimin dhe ligjshmërinë e të ardhurave të personit tjetër të lidhur, z. S.T., për shumën e investuar prej tij në ndërtimin e objektit 10-katësh, subjekti ka paraqitur: (i) deklaratën noteriale të z. S.T. të datës 06.10.2022,⁷ bashkëlidhur saj janë depozituar 9 kontrata shitblerje të periudhës 2016-2018, si dhe dokumentacion të administruar në fashikujt e Komisionit;

⁷ Nr. {***} rep., {***} kol., datë 06.10.2022, notere M. D..

(ii) marrëveshjen private ndërmjet K. H. dhe S.T. dhe shtesën e parë të saj; (iii) deklaratën noteriale të K.H.; (iii) kontratën e shkëmbimit mes palës shkëmbuese pronar të truallit: Fatmira, K., R. e A. H. dhe palës shkëmbuese investitore: S.T.. Duke rievidentuar, sikundër në pikën 18.1.1, lidhur me kohën e paraqitjes së dokumentit që paraqitet për herë të parë, si dhe në vlerësim të përmbajtjes së tyre, bazuar në nenin 49, paragrafin 6, germa “a” e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues e vlerëson të panevojshme marrjen e këtyre provave.

18.1.3. Për të mbështetur pretendimet për përfshirje në analizën financiare e të ardhurave nga dhënia me qira e njësisë në {***}, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur deklaratën noteriale të z. A.V., qiramarrës për vitet 2003-2006, bashkëlidhur kontrata e qirasë, me nr. {***} rep., {***} kol., datë 04.08.2003, e cila është e administruar në fashikujt e Komisionit. Në konsideratë të qëndrimit të mbajtur nga Kolegji, për zbehje të forcës provuese të deklaratës noteriale në kuadër të procesit të rivlerësimit, duke rievidentuar sikundër në pikën 18.1.1, lidhur me kohën e paraqitjes së dokumentit, bazuar në nenin 49, paragrafin 6, germa “a” e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues e vlerëson të panevojshme marrjen e kësaj prove.

18.1.4. Për të mbështetur pretendimet e saj për kontrollin e figurës, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur të noterizuar, me nr. {***} rep., datë 07.10.2022, e-mail e datës 26.09.2022, të Seksionit Konsullor të Ambasadës së SHBA-së, në gjuhën angleze dhe përkthimin e tij në shqip. Duke marrë në konsideratë informacionin nga burime të hapura⁸, rezulton se për shkak të kufizimeve të burimeve dhe ndikimit të vazhdueshëm të pandemisë Covid-19, Seksioni Konsullor i Ambasadës së SHBA-së, në Tiranë, ka rifilluar shërbimet e kufizuara për të gjitha kategoritë e vizave joemigruese nga data 8 nëntor 2021. Referuar në këtë njoftim publik, pavarësisht se në të bëhet fjalë për rifillim të shërbimeve të kufizuara/numrit të kufizuar të takimeve për kategoritë e vizave joemigruese, ndërkohë që subjekti pretendon t’i jetë drejtuar Ambasadës me kërkesë për informacion, dëshmohet se Seksioni Konsullor i Ambasadës së SHBA-së ka kufizuar veprimtarinë e tij për shkak të pandemisë Covid-19, për rrjedhojë, trupi gjykues vlerëson *a prima facie* që provohet se subjekti, pa fajin e saj, nuk ka mundur të paraqesë provën për të provuar lidhur me kohën e marrjes së njoftimit për revokimin e vizës nga Ambasada e SHBA-së. Por, në referim të të përmbajtjes, e-mail nuk jep të dhëna për datën që Ambasada e SHBA-së ka njoftuar subjektin për revokimin e vizës. Për rrjedhojë, bazuar në nenin 49, paragrafin 6, germa “a” e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues e vlerëson të panevojshme marrjen e kësaj prove.

18.1.5. Për të gjitha arsyet e dhëna sa më sipër, trupi gjykues vendosi të vijojë shqyrtimin e kësaj çështje në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimin e nenit 49 e ligjit nr. 49/2012

B. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit lidhur me shkaqet e ankimit për procesin e rregullt ligjor dhe aspektet procedurale të procesit të rivlerësimit

- 19.** Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se vendimi është marrë mbi bazën e një hetimi të paplotë, pa u bazuar në Kushtetutë dhe në ligjin nr. 84/2016, pasi nuk është kryer hetim administrativ për të tria kriteret e rivlerësimit, si dhe Komisioni nuk ka disponuar lidhur me kërkesën e saj për shtyrje të afatit të hetimit [riçelje të hetimit administrativ], trupi gjykues analizon si vijon.

⁸ <https://al.usembassy.gov/sq/visas-sq/nonimmigrant-visas-sq/>.

19.1. Subjekti i rivlerësimit, për këtë shkak ankimi, shprehet se Komisioni ka kryer shkelje procedurale duke mos u shprehur në seancën e datës 18.06.2020, për kërkesën e saj për vlerësim të aftësive profesionale, kërkesë e parashtruar prej saj në seancën dëgjimore të datës 15.06.2020, si edhe në materialin me shkrim të dorëzuar në datën 16.06.2020, duke pohuar se do të shprehej në seancën e radhës. Në përgjigje të kërkesës së subjektit, për kryerjen e hetimit për kriterin e aftësive profesionale, kërkesë e bërë prej saj pas njohjes me rezultatet e hetimit administrativ kryesisht, subjekti është informuar prej Komisionit në datën 10.06.2022 se *trupi gjykues, pasi mori në shqyrtim kërkesën për riçelje të hetimit administrativ dhe përfshirjen në procesin e rivlerësimit të kriterit të vlerësimit profesional, çmon se hetimi në lidhje me këtë kriter mund të rihapet vetëm, nëse subjekti arrin të provojë me prova dhe shpjegimet përkatëse, respektivisht në prapësime me shkrim dhe seancë dëgjimore të kundërtën e rezultateve të hetimit, në lidhje me kriterin e pasurisë dhe kontrollin e figurës. Këto prova dhe shpjegimet tuaja në prapësimet me shkrim dhe gjatë seancës dëgjimore do të vlerësohen nga ky trup gjykues para marrjes së vendimit përfundimtar. Për sa më sipër, deri në këtë fazë të procesit, trupi gjykues rrëzon kërkesën e subjektit për rihapjen e hetimit për kriterin e vlerësimit profesional.* Bazuar në këtë komunikim të Komisionit, si dhe në kuptim të ligjit nr. 84/2016, i cili nuk përcakton detyrimin e organeve të rivlerësimit, në këtë rast të Komisionit, për t'u shprehur me vendim të ndërmjetëm, lidhur me kërkesa të subjektit për riçelje të hetimit për vlerësim të kriterëve të çmuara irelevante nga ana e Komisionit, por i njeh këtyre organeve një pushtet *diskrecionar*, lidhur me kohën e trajtimit të këtyre kërkesave, trupi gjykues e gjen të pabazuar pretendimin e subjektit se Komisioni ka kryer shkelje procedurale, duke mos u shprehur për kërkesën e saj në seancën dëgjimore dhe atë të shpalljes së vendimit.

19.2. Bazuar në parashikimet e pikës 2, neni 4, të ligjit 84/2016⁹, si dhe në konsideratë të qëndrimit të Kolegjit në çështje të mëparshme, trupi gjykues sjell në vëmendje se në vlerësim të shkeljeve të konstatuara në drejtim të kontrollit të kriterit të pasurisë dhe të kontrollit të figurës Komisioni ka arritur në përfundimin se subjekti nuk e kalon testin e besueshmërisë për këto dy kritere, dhe hetimi për kriterin profesional do të mbetet irelevant në funksion të efikasitetit të procesit, pasi çfarëdolloj konkluzioni për të nuk do të afektonte vlerësimin për kriterin e pasurisë dhe kriterin e vlerësimit të figurës, të mjaftueshme për arritjen e marrjes së vendimit. Për sa subjekti i rivlerësimit, me shpjegimet me shkrim dhe gjatë seancës dëgjimore, si dhe me provat e paraqitura, nuk ka arritur të provojë të kundërtën e përfundimeve të arritura për kriterin e pasurisë dhe të figurës nga Komisioni, pretendimi për hetim të pjesshëm dhe për zbatim të gabuar të së drejtës materiale është i pabazuar.

20. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se *Komisioni nuk i ka dhënë mundësinë për plotësim më shterues të pyetësorëve gjatë hetimit administrativ kryesisht, veçanërisht për pyetjet për të cilat ka bërë me dije se i është drejtuar institucioneve të ndryshme apo individëve, trupi gjykues analizon si vijon.*

20.1. Referuar akteve në fashikujt e Komisionit, rezulton se në asnjë prej përgjigjeve të dhëna për pyetësorët nga ana e subjektit të rivlerësimit nuk është paraqitur ndonjë pretendim për afatin e caktuar për kthimin e përgjigjes apo në ndonjë rast prej saj të jetë kërkuar kohë shtesë për dhënie të shpjegimeve dhe për sigurim të dokumentacionit në mbështetje të pretendimeve të saj. Në nisje të hetimit administrativ, në dy pyetësorët e parë me numër të konsiderueshëm pyetjesh për dhënie

⁹ Neni 4 “Objekti dhe parimet e procesit të rivlerësimit”, në pikën 2 parashikon se: “Vendimi merret bazuar në një ose disa prej kriterëve, në vlerësimin e përgjithshëm të tre kriterëve, ose në vlerësimin tërësor të procedurave”.

të shpjegimeve për të gjithë pasuritë e subjektit objekt kontrolli, Komisioni i ka lënë subjektit afat 10-ditor për dhënien e përgjigjeve dhe sipas rastit paraqitjen e dokumentacionit. Në vijim të përgjigjeve të dhëna prej subjektit, përmes tri pyetësorëve në vijim [njëri prej të cilëve me afat përgjigje katër ditë dhe dy të tjerët një ditë], është synuar sqarimi më i detajuar i situatës faktike. Në rast të kërkesës për paraqitje të dokumentacionit me afat ditën e nesërme¹⁰, referuar përgjigjes së subjektit qysh në pikënisje se *sikurse kam sqaruar dhe deklaruar në formularët e mëparshëm, përgjigje e shoqëruar me paraqitje të dokumentacionit të paraqitur me pyetësorët e mëparshëm, dëshmon se subjekti ka çmuar mjaftueshmërinë e sqarimeve dhe dokumentacionit të paraqitur pa pasur synim të kërkojë apo të pretendojë paraqitje të dokumenteve të tjerë*¹¹.

20.2. Lidhur me pretendimin për *pamundësi për plotësimin specifikisht të pyetjeve ku ka bërë me dije që i është drejtuar institucioneve të ndryshme*, nga aktet e administruara në fashikujt e Komisionit, rezulton se gjatë hetimit administrativ, për t'i dhënë përgjigje pyetësorëve të Komisionit, subjekti është shprehur se i ka adresuar kërkesë {***} University, SHBA dhe Ambasadës së SHBA-së, në Tiranë, ka paraqitur dokumentacionin e çmuar prej saj provues dhe nuk është shprehur se gjendet në pamundësi objektive, për shkaqe të pavarura prej saj, për të siguruar dokumentacionin në këto dy raste. Më konkretisht, trupi gjykues konstaton si vijon.

20.2.1. Për dokumentacion justifikues për përgjigjen e dhënë për pyetjen, lidhur me shpenzime të kryera për shkollimin fëmijëve, përmes postës elektronike në datën 23.12.2019, një javë pas marrjes së pyetësorit, i është adresuar kërkesë {***} University, SHBA dhe nga ana e subjektit është paraqitur kopja e e-mail/përgjigjes së Universitetit me përmbajtje *janë me pushime dimërore dhe puna rifillon në datën 3.01.2020*. Në këtë situatë faktike, *së pari*, vetë subjekti ka vonuar adresimin e kërkesës për Universitetin, duke e dërguar atë në vigjilje të festave të fundvitit, periudhë në të cilën është e njohur botërisht se institucionet arsimore janë pushim dhe *së dyti*, është mjaftuar me paraqitjen në format fotografie të e-mail të korrespondencës me Universitetin, duke e cilësuar përgjigjen e Universitetit si “dokumentacion provues”. Në kuadër të pretendimit të subjektit, për mbulimin e shpenzimeve të studimeve *bachelor* 2005-2009, të personit të lidhur, vajzës, në këtë Universitet me tarifë shkollimi 30.000 USD në vit, duke pretenduar financimin e tyre në masën 80 % nga Federal and State Student Aid dhe mesatarisht 6.000 USD në vit nga Universiteti dhe viti i fundit totalisht prej Universitetit, mosdepozitimi prej saj i dokumentacionit justifikues as në vijim dhe as pas njohjes me rezultatet e hetimit administrativ, si dhe as në seancë dëgjimore apo bashkëlidhur ankimit, sjell si pasojë konkluzionin që pretendimi i subjektit, sa i përket kohës në dispozicion për të siguruar përgjigje nga institucioni, në këtë rast Universiteti, të jetë i tejkaluar.

20.2.2. Nga shqyrtimi i akteve në fashikujt e Komisionit, në pretendimet mbi rezultatet e hetimit administrativ kryesisht, si dhe në shpjegimet përfundimtare të dorëzuara në seancë, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se *i është drejtuar Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë me anë të dy e-mail dhe një letër nëpërmjet Postës Shqiptare, duke Ju kërkuar konfirmim e*

¹⁰Pyetjen shtesë të datës 13.01.2020: [...] në kuadër të hetimit administrativ për procesin tuaj të rivlerësimit, kërkojmë të na vini në dispozicion dokumentacion ligjor justifikues për vlerën e investimit të deklaruar nga ana juaj në shumën 207.400 euro, për objektin 10-katësh, nëse e dispononi [...].

¹¹Dokumentacioni i përcjellë nga subjekti: (1) deklarata noteriale e G. B., nr. {***} rep., {***} kol., datë 23.12.2019, notere V. S.; [riparaqitur] (2) statement bankar, për transferimi e shumës 68.342.32 euro në favor të “{***}” ShPK; [riparaqitur]; (3) aktmarrëveshja nr. {***} rep., {***} kol., datë 06.06.2012, notere E. H., për zgjidhje të kontratës së qirasë, [riparaqitur]; (4) statement bankar për kalimin në favor të K. H. të shumës 100.000 euro dhe 107.000 euro.

datës së marrjes dijëni në lidhje me revokimin e vizës, fakt të cilin e provoj me provat në vijim. Provat e referuara nga subjekti janë dy e-mail të sajat në adresë të Konsullatës së SHBA-së, respektivisht të datave 19.03.2020 dhe 14.05.2020, me tekst “*në attach gjëni shkresën me kërkesën specifike drejtuar jush*”, si edhe një dëftesë lajmërim-marrje e Postës Shqiptare, ku pasqyrohet vetëm adresa e subjektit. Dokumentet sipërcituar janë përfshirë në format fotografie në material prej subjektit, e cila shprehet se vijon të mos ketë asnjë përgjigje për këto kërkesa, pasi në dijëni të saj, deri në datën 23.06.2020, e përcaktuar si gjendje e jashtëzakonshme për shkak të pandemisë, Zyra Konsullore është pjesërisht e mbyllur. Të njëjtin dokumentacion, në të njëjtën formë, subjekti e ka përfshirë në ankimin e paraqitur në Kolegj. Trupi gjykues, *së pari*, eidenton se këto kërkesa të subjektit nuk qartësojnë se çfarë informacioni është kërkuar konkretisht prej saj, *së dyti*, DSIK-ja e në vijim Komisioni ka përcaktuar gjendjen e fakteve dhe rrethanave që kanë lidhje me çështjen bazuar në informacionet e agjencive ligjzbatuese e në këto kushte dokumentacioni i administruar ka qenë i plotë dhe shterues, duke mos diktuar nevojën për mjete të tjera të kërkimit të provës.

21. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se *Komisioni ka kryer të gjithë proceset procedurale dhe shpalljen e vendimit pa përfunduar ende periudha e gjendjes së jashtëzakonshme, e caktuar me aktet përkatëse në datën 23.06.2020 dhe për shkak të gjendjes së jashtëzakonshme ishte e pamundur që prej saj të siguroheshin provat shtesë në datën 23 mars 2020, si edhe në afatet në vijim*, trupi gjykues analizon si vijon.

21.1. Nga aktet në fashikuj rezulton se, *së pari*, rezultatet e hetimit administrativ kryesisht i janë përcjellë subjektit në datën 10.03.2020 dhe në vijim, në vlerësim të situatës, si dhe të kërkesave të subjektit, Komisioni ka shtyrë tre herë afatin, për paraqitjen e shpjegimeve dhe provave për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit administrativ kryesisht, shtyrje që përkojnë me një periudhë kohore rreth dy muaj e gjysmë¹², *së dyti*, duke mbajtur në konsideratë problematikat dhe situatën që shkaktoi pandemia Covid-19 dhe duke referuar në përcaktimet e kuadrit nënligjor lidhur me masat në situatën e pandemisë, është fakt i njohur botërisht se institucionet, private apo publike, kanë vijuar punën në forma dhe mënyra të përshtatura në kushtet e pandemisë, pa ndërprerë veprimtarinë e tyre¹³, *së treti*, në komunikimet me Komisionin, po ashtu edhe në seancë dëgjimore, prej subjektit nuk janë paraqitur pretendime lidhur me pamundësi për sigurimin e provave për shkak të situatës së shkaktuar nga pandemia, *së katërti*, për këtë shkak ankimi, subjekti nuk referon provat shtesë të synuara për t’u siguruar/paraqitur prej saj, cilat do të ishin ato, vlerën provuese të tyre përkundrejt çështjeve të analizuara/vlerësuara nga ana e Komisionit, *së pesti*, me gjithë periudhën tremujore nga shpallja e vendimit, bashkëlidhur ankimit subjekti nuk ka bashkëlidhur provë tjetër përpos atyre të paraqitura në Komision dhe në këtë situatë faktike, trupi gjykues vlerëson se në dhënien e vendimit objekt ankimi veprimtaria e Komisionit vjen në përputhje të plotë me përcaktimet kushtetuese dhe ligjore për kryerjen e procesit të rivlerësimit,

¹² Komisioni ka përcaktuar dhe njoftuar subjektin shtyrjen e afatit si vijon:

- (i) datë 27.03.2020 [në bazë të kërkesës së subjektit, konfirmuar dhe falënderuar prej saj me e-mail në datën 18.03.2020];
- (ii) datë 20.05.2020 [në bazë të kërkesës së subjektit, për të cilën Komisioni ka kthyer përgjigje se “sipas llogaritjes së afateve nga data e dërgimit të rezultateve të hetimit deri në daljen e aktit normativ të datës 25.03.2020, për shkak të gjendjes së fatkeqësisë natyrore, trupi gjykues ju njofton se duhet të dorëzoni shpjegimet 7 ditë nga data e heqjes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore”, afat i konfirmuar fillimisht nga subjekti, por kërkuar më vonë shtyrje të tij [në datën 20.05.2020].
- (iii) datë 05.06.2020 [me miratimin e aktit normativ nr. 21, datë 27.05.2020, Komisioni njoftoi subjektin për këtë afat të ri].

¹³ VKM-ja nr. 243, datë 24.03.2020, pika 6.1.

ku subjektit i janë garantuar të drejtat për një proces të rregullt ligjor, për t'u njohur me rezultatet e hetimit, me të gjithë materialet e dosjes, për të provuar të kundërtën e konkluzioneve të Komisionit dhe për t'u dëgjuar prej tij.

22. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se *Komisioni ka realizuar hetim administrativ të pjesshëm, të njëanshëm, në kundërshtim me normat procedurale, në zbatim të gabuar të së drejtës materiale, ka mbyllur procesin hetimor pa mundësuar plotësimin me dokumentet përkatëse nga ana e saj dhe, për pasojë, hetimi i paplotë ka çuar në vendimmarrjen e gabuar*, trupi gjykues vlerëson, *së pari*, Komisioni ka respektuar normat procedurale duke realizuar një hetim administrativ të plotë përgjatë të cilit subjektit i janë garantuar të drejtat për një proces të rregullt ligjor, për t'u dëgjuar dhe mbrojtur, duke disponuar me shtyrje të afateve procedurale në përgjigje të çdo kërkesë të saj, *së dyti*, subjekti në seancë dëgjimore nuk ka referuar për pamundësi për të kontaktuar apo komunikuar me të tretë në funksion të adresimit të kërkesave të saj për të siguruar dokumentacion në përmbushje të barrës së provës apo të ketë referuar përgjigje të të tretëve për pamundësi të tyre për nxjerrje/referim të të dhënave të kërkuara apo për vënie në dispozicion të dokumentacionit për shkak të kushteve të krijuara prej pandemisë, *së treti*, për sa nga vlerësimi i dy kriterëve, atij të pasurisë dhe të kontrollit të figurës, Komisioni ka arritur në përfundimin se subjekti nuk e kalon testin e besueshmërisë për to, mospërfshirja e kriterit të aftësive profesionale në procesin e rivlerësimit nuk përbën shkak për të ngritur pretendime për hetim administrativ të pjesshëm dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale. Në këtë situatë faktike, pretendimet e subjektit vlerësohen të pabazuara prej trupit gjykues dhe si një përpjekje për të mbështetur shkaqet e ngritura prej saj në ankim. Fakti që Komisioni nuk ka mbajtur qëndrim të njëjtë me sa ka pretenduar subjekti, si dhe për vlerën provuese të deklaratave noteriale të hartuara dhe paraqitura gjatë procesit të rivlerësimit, nuk përbën shkak për të pretenduar për njëanshmëri të hetimit administrativ, por është ushtrim prej Komisionit i kompetencave dhe attributeve të tij analizuese e vlerësuese të njohura nga ligji nr. 84/2016, në funksion të përcaktimit të gjendjes së fakteve dhe rrethanave që kanë lidhje me çështjen. Për të gjitha sa dëshmuar nga aktet në fashikuj, trupi gjykues vlerëson se subjektit i është garantuar e drejta për të paraqitur prova, të cilat janë vlerësuar në mënyrë objektive, në përputhje me përcaktimet e nenit 49, pika 9 e ligjit nr. 84/2016, për rrjedhojë pretendimet e subjektit të rivlerësimit janë të pabazuara.
23. Lidhur me pretendimin e subjektit se Komisioni ka cenuar parimin e barazisë para ligjit, si pasojë e zhvillimit të procesit të rivlerësimit kalimtar me standarde të dyfishta, në konsideratë të qëndrimit të konsoliduar të Kolegjit¹⁴, një pretendim i tillë nuk mund të përbëjë *a priori* një arsye për të konsideruar të padrejtë vendimin e Komisionit. Çdo vendim i Komisionit, ndaj të cilit ushtrohet ankim, vlerësohet nga Kolegji në mënyrë individuale, sipas shkaqeve konkrete të ankimit, bazuar në specifikat e gjendjes faktike të provuar nga hetimi administrativ apo gjyqësor dhe zbatimit korrekt të ligjit për situatën konkrete faktike dhe jo nga mënyra apo standardi i përdorur për të rivlerësuar subjektet e tjera të rivlerësimit nga Komisioni.

C. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, në aspektin e konstatimit të drejtë të situatës faktike dhe zbatimit të ligjit material

24. Lidhur me pasurinë truall me sipërfaqe 454 m² dhe ndërtesë 95,3 m², ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë, subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionin e Komisionit se *nuk ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin, interesat privatë në vitin 2003 dhe në deklaratën vetting, në lidhje me*

¹⁴ Shih vendimet nr. 7, datë 05.04.2019 dhe nr. 34, datë 15.11.2021, e Kolegjit.

*burimin e krijimit të këtij apartamenti, duke pretenduar se: (i) në deklaratën e interesave private 2003 ka konsideruar të gjithë shumën e investuar për këtë pasuri, blerje+rikonstruksion, duke shënuar të rrumbullakosur shumën 2.700.000 lekë, me burim pjesërisht kursime familjare që i përkiste vlerës fillestare të blerjes së apartamentit 129.600 lekë, në dhjetor 1995 dhe pjesërisht kredinë e marrë nga Banka e Kursimeve Tiranë, në shumën 2.500.000 lekë, të marrë në vitin 2000 dhe të përdorur totalisht për rikonstruksion të kësaj banese; (ii) deklarimi në deklaratën *vetting* nuk ndryshon me deklarimin e vitit 2003, në këtë rast është shënuar vetëm vlera e blerjes fillestare dhe është ndarë vlera prej 2.500.000 lekësh e investimit në rikonstruksion; (iii) nuk ka pohuar as në pyetësorë, as në seancë dëgjimore se kredia është marrë nga Banka e Kursimeve për blerjen e apartamentit në blv. “{***}”.*

24.1. Lidhur me apartamentin e ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si vijon.

24.1.1. Në deklaratën *vetting*: posedon bashkë me fëmijët e saj, me nga ¼ pjesë secili një truall, në zonën kadastrale {***}, me numër pasurie {***}, vol. {***}, {***}. {***}, me adresë, rruga “{***}”, Tiranë. Sipërfaqe totale 454 m², nga e cila 95,3 m² është ndërtesa: burim krijimi apartamenti në rrugën “{***}”, {***}, në Tiranë, i përfutur nga blerja me anë të kontratës së shitjes, datës 14.1.1995, me shitës Enti i Banesave, Dega Tiranë dhe blerës A. H., Fatmira Hajdari dhe Sh. H., në vlerën 129.600 lekë, e derdhur me mandatarë nr. {***}, datë 11.1.1995. Ky apartament ndodhet në katin I+II, me sip. 95,3 m², sipërfaqja totale e truallit¹⁵ 500 m².

24.1.2. Në deklaratën e interesave private 2003: (i) në formularin A-1 *pasuri të paluajtshme dhe të drejta reale mbi to*: shtëpi banimi me oborr, me vlerë 2.7 milion lekë, me adresë rruga “{***}”, lagja {***}, ish-{***}, nr. {***}, Tiranë. Burim krijimi, kredi e marrë nga Banka e Kursimeve Tiranë dhe pjesërisht kursime familjare; (ii) në formularin A-8, *detyrime financiare ndaj personave juridik dhe fizikë*: kredi, vlera 25 milion lekë, Banka e Kursimeve, arsyeja e krijimit të detyrimit rikonstruksion banese.

24.2. Lidhur me apartamentin e ndodhur në blv. “{***}”, Tiranë, {***}, nr. pasurie {***}, me sipërfaqe 120 m², nga dokumentacioni i administruar në fashikujt e Komisionit, rezulton se subjekti i rivlerësimit:

24.2.1. Në datën 11.09.2000¹⁶ e ka blerë këtë apartament nga shtetasi R. H., të regjistruar në emër të shitësit në regjistrin hipotekor me nr. {***}, datë 28.01.2000. Sipas përmbajtjes së kontratës së shitblerjes, përcaktohet se *në marrëveshje të përbashkët çmimi i shitblerjes është caktuar*

¹⁵ Subjekti ka paraqitur dokumentacionin: certifikatë për vërtetim pronësie nr. {***}, datë 19.4.2016, për pasurinë me nr. {***}, e llojit truall me sip. 454 m², nga kjo ndërtesë me sip. 95.3 m², në pronësi të shtetasve Fatmira, A., K. dhe R. H., kartela e pasurisë, harta treguese e regjistrimit; kontratë shitblerje datë 14.1.1995, për apartament me sip. 95.3 m² dhe truall me sip. 500 m². Blerës A. H. dhe bashkëpronarët Fatmira dhe Sh. H.. Shitës Enti Kombëtar i Banesave, Dega Tiranë, çmimi 129.600 lekë; vërtetim nga dokumenti hipotekor nr. {***}, datë 15.2.2002, për pasurinë nr. {***}, me ndërtesë me sip. 95.3 m² dhe truall me sip. 500 m², regjistruar në emër të Fatmira, K., R. dhe A. H., harta treguese e regjistrimit.

Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit standard, ka deklaruar se sipërfaqja e truallit të shtëpisë nga 500 m², e blerë në vitin 1995, bëhet 454 m², pasi ka bashkuar të gjitha sipërfaqet e trojeve të përfuturara në vite: në total 887.3 m² = (500 m² + 150 m² + 142 m²), të cilat i ka ndarë në dy pjesë, ku sip. prej 454 m² ia ka lënë shtëpisë dhe oborrit, dhe sip. 433.3 m² ia ka lënë godinës së re, të ndërtuar në vitin 2012.

¹⁶ Kontratë shitblerje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 11.09.2000, notere Sh. K., Dhoma e Noterisë Tiranë.

2.500.000 lekë, shumë të cilën shitësi do ta tërheqë nga Banka e Kursimeve Tiranë, shumë e cila i jepet familjes Hajdari për zgjerim sipërfaqe banimi.

24.2.2. Në datën 31.10.2000¹⁷, subjekti i rivlerësimit në cilësinë e huamarrësit ka lidhur “Kontratë huaje për blerje banese”, me huadhënës Banka e Kursimeve, huaja e akorduar 2.500.000 lekë. Në pikën 7 të kontratës përcaktohet se: “Pas miratimit të huas dhe para se të lëvrohet shuma e huas, huamarrësi pranon të nënshkruajë kontratën e hipotekës duke vendosur si garanci reale në zyrën e regjistrimeve të pasurive të paluajtshme në favor të huadhënësit, banesën që financohet ...[...].

24.2.3. Në datën 31.10.2000¹⁸ ka lidhur kontratë për hipotekimin në favor të Bankës së Kursimeve të këtij apartamenti në pronësi të hipotekueses (subjektit të rivlerësimit), në bazë të regjistrimit hipotekor nr. {***}, datë 01.11.2000. Nga përmbajtja e kontratës, rezulton se subjekti i rivlerësimit është paraqitur personalisht përpara noteres dhe në kontratë pasqyrohet i plotësuar me shkrim dore emër mbiemër i subjektit dhe nënshkrimi. Në datën 01.11.2000, sipas vërtetimit të ZVRPP-së Tiranë lëshuar në këtë datë, kontrata e hipotekës është regjistruar në regjistrin e inskriptimeve me nr. {***}, datë 01.11.2000.

24.2.4. Në datën 15.03.2002¹⁹, pasuria apartament, në {***}, nr. pasurie {***}, me sipërfaqe 120 m², është shitur nga subjekti i rivlerësimit me çmimin 2.000.000 lekë, likuiduar jashtë zyrës noteriale.

24.3. Lidhur me pretendimin e subjektit se në deklaratën vetting nuk ndryshon asgjë me çfarë kam deklaruar në vitin 2003, vetëm se në këtë rast është ndarë vlera prej 2.5 milion e investimit në rikonstruktion e marrë nga Banka e Kursimeve dhe është shënuar vetëm vlera e blerjes fillestare, trupi gjykues analizon si vijon.

24.3.1. Në konsideratë të pretendimit të subjektit se shuma e kredisë është përdorur për rikonstruktionin e apartamentit të ndodhur në rrugën “{***}”, deklarimi i burimeve të krijimit të kësaj pasurie në deklaratën e interesave privatë të vitit 2003, duke përfshirë kredinë e marrë në Bankën e Kursimeve, vjen në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9049/2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, (në vijim referuar ligji nr. 9049/2003) dhe sipas qartësimeve në formularin përkatës për deklaram të çdo gjëje që është e trupëzuar në mënyrë të qëndrueshme e të vazhdueshme me tokën ose ndërtesën. Referuar deklaramit të parë të kësaj pasurie prej subjektit, trupi gjykues, duke sjellë në vëmendje përcaktimet e Kodit Civil²⁰ se rikonstrukcioni në ndërtim apo organizimi me qëllim përmirësimin e banesës bëhet pjesë përbërëse dhe e pandashme e banesës, vlerëson të pabazuar pretendimin e subjektit që nuk ka ndryshim të deklarimeve të saj sa i përket burimeve të krijimit të kësaj pasurie.

24.3.2. Deklarimi i kësaj pasurie në vitin 2003 në deklaratën e interesave privatë (në vijim DIPP), si edhe deklarimet e subjektit në DIPP të viteve 2004, 2007, 2008, 2009, 2010, 2012, 2013, 2014 dhe 2015, lidhur me detyrimin ndaj Bankës së Kursimeve për kredi të marrë për rikonstruktion banese, për sa janë deklarime të kryera nën përgjegjësinë ligjore të buruar nga ligji nr. 9049/2003, duket t’i japin kredibilitet pretendimeve të subjektit lidhur me përdorimin e shumës së kredisë.

¹⁷ Kontratë huamarrje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 31.10.2000, notere N. K., Dhoma e Noterisë Tiranë.

¹⁸ Kontratë hipotekimi nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 31.10.2000, notere N. K., Dhoma e Noterisë Tiranë.

¹⁹ Kontratë shitblerje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 15.03.2002, notere Sh. K., Dhoma e Noterisë Tiranë.

²⁰ Neni 146 i Kodit Civil përcakton se: “Është pjesë përbërëse e një sendi çdo gjë që është bashkuar me të dhe nuk mund të ndahet prej tij pa iu shkaktuar një dëm thelbësor”.

Njëherazi, deklarimi prej subjektit i arsyetimit të krijimit të detyrimit/kredisë për *rikonstrukcion banesë* në mospërputhje me përcaktimet e aktit prej të cilit subjektit i ka lindur detyrimi ndaj Bankës së Kursimeve, vjen në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 9049/2003. Referuar kontratës së huas për blerje banesë, lidhur mes subjektit dhe Bankës së Kursimeve, si në titull, ashtu dhe në përmbajtje përcaktohet qartë se objekti i huas është: blerje banesë. Nga aktet e administruara rezulton e provuar se me shumën e kredisë së përfituar nga Banka e Kursimeve, subjekti ka shlyer çmimin e shitjes së apartamentit të ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë, ka gëzuar e qetë tagret e pronësisë dhe sipas deklarimeve të saj e ka disponuar pas një viti e gjysmë, me shitje me qëllim përfitimin e shumës për krijimin e një pasurie të re. Në kontekst të pasaktësive të deklarimeve të subjektit të paraqitura më parë prej saj në ILDKPKI, si dhe të situatës faktike të provuar me provat e administruara, trupi gjykues konstaton se pasaktësitë e evidentuara në deklaratat periodike bëjnë të pamundur përdorimin e deklaratave me cilësinë e provës, në kuptim të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Për pasojë, vlerësimi i këtyre situatave faktike nuk mund të bëhet referuar në këto deklarata, të cilat janë kontradiktore dhe të paqarta.

24.3.3. Lidhur me pretendimin e subjektit se nuk qëndron sa referuar nga Komisioni se *është shprehur në pyetësorë dhe në seancë dëgjimore se kredia 2.500.000 lekë e marrë nga Banka e Kursimeve është përdorur për blerje të një apartamenti në rrugën “{***}”*, trupi gjykues konstaton se gjatë hetimit administrativ subjekti ka dhënë shpjegime kontradiktore sa i përket përdorimit të shumës së kredisë. Shpjegimet se kjo shumë është investuar totalisht për rikonstrukcionin e apartamentit vijnë në kundërshtim me shpjegimet *se shuma e kredisë i kaloi kunatit, shitës i apartamentit në rrugën “{***}”*, përmes së cilit subjekti, duke deklaruar për destinacionin e shumës, ka pohuar lidhur me përdorimin e saj.

24.4. Lidhur me pretendimin e subjektit se *nuk i ka parë dhe nënshkruar dokumentet e kredisë, pasi për shkak të ngarkesës së saj të atyre kohëve me to është marrë kunati*, nga aktet e praktikës së kredisë [kërkesa e subjektit e datës 18.10.2000, kontrata e huas për blerje banesë, kontrata e hipotekës, kontrata e shitjes së apartamentit], trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit është paraqitur personalisht përpara noteres dhe se pasqyrohet i plotësuar me shkrim dore emër mbiemër i subjektit, si dhe nënshkrimi i saj. Referuar kërkesës së datës 18.10.2000, subjekti, nën përgjegjësinë e saj personale, deklaroi se familjarisht dhe personalisht nuk zotëron banesë të përfituar nga procesi i privatizimit të banesave, nga Enti Kombëtar i Banës apo të fituar në çdo mënyrë tjetër ligjore, pavarësisht se qysh në vitin 1995 zotëronte apartament të përfituar nga procesi i privatizimit, nga EKB-ja, në rrugën ish-blloku i {***}, Tiranë²¹.

24.5. Në konsiderim të fakteve të rezultuara nga aktet e administruara, të cilat dëshmojnë se, *së pari*, subjekti për të fituar pronësinë e apartamentit të ndodhur në rrugën “{***}” ka shlyer çmimin e shitjes me shumën e kredisë së përfituar nga Banka e Kursimeve, *së dyti*, nuk ka asnjë akt apo *indicie* për të vërtetuar se kunati [shitësi i apartamentit] i ka kthyer subjektit çmimin e shitjes së apartamentit, *së treti*, subjekti në deklaratën *vetting* për pasurinë tjetër - *njësi (lokal), me sip. 67,5 m², në {***}, Tiranë* - ka deklaruar burim krijimi të ardhura të përfituara nga shitja e apartamentit në rrugën “{***}”, *blerë me kontratë huaje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 31.10.2000, me huadhënës Dega e Bankës së Kursimeve, Tiranë*, trupi gjykues vlerëson të pasakta dhe

²¹ VKM-në nr. 102, datë 5.3.1999, “Për trajtimin me strehim të funksionarëve politikë dhe nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore”, e cituar në kontratën e dhënies së huas, në pikën 2 të saj përcaktohen: “Gjatë kohës që funksionarët politikë dhe nëpunësit civilë të administratës së lartë shtetërore janë në këto funksione dhe janë pa banesë ose kanë nevojë për një shtesë sipërfaqeje banimi, u lind e drejta të kërkojnë strehim nga shteti”.

kontradiktore deklarimet e subjektit, lidhur me përdorimin e shumës së kredisë së marrë në Bankën e Kursimeve dhe, për rrjedhojë, të pabazuara pretendimet e saj.

24.6. Në konkluzion, lidhur me pasurinë truall me sipërfaqe 454 m² dhe ndërtesë 95,3 m², të ndodhur në rrugën “{***}”, {***}, në qytetin e Tiranës, Kolegji vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin nr. 84/2016 në deklaratën *vetting* burimin e krijimit të këtij apartamenti dhe vlerën e tij, në kundërshtim me parashikimet e nenit 33 pika 5, germa “a” e këtij ligji.

25. Lidhur me pasuritë tri njësi dhe 12 apartamente në një objekt 10-katësh, të ndërtuar në truallin me sipërfaqe 433,3 m², të ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë, subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionet e Komisionit se nuk ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin: (i) investimin, fillimin dhe përfundimin e punimeve të kryera në ndërtesën informale 5-katëshe karabina në DIPP e viteve përkatëse, në kundërshtim me germën “a”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016; (ii) nuk ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin sipërfaqen e tokës truall 142 m² të përfituar në vitin 2013, por kjo e vetme nuk mund të përbëjë shkak për shkarkim, duke qenë se ka deklaruar sipërfaqen totale të truallit, përfshirë edhe sipërfaqen 142 m²; (iii) nuk ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin në DIPP-në 2015, sipërfaqen e tokës truall 150 m² të përfituar me VKM-në nr. 823, datë 7.10.2015 dhe kontratës për kalimin e pronësisë së disa parcelave ndërtimore nr. {***}, datë 23.12.2005; (iv) në deklaratën *vetting* nuk ka deklaruar në mënyrë të qartë burimin e krijimit të shumës 207.400 euro [investuar në godinën 10 kate] dhe as periudhën gjatë së cilës është kryer investimi; (v) nuk dorëzoi dokumentacion të nevojshëm provues lidhur me lindjen e detyrimit ndaj shtetasit G. B. dhe nuk e ka deklaruar këtë detyrim për vitet 2012, 2013, 2014 dhe 2015, për pasojë ka bërë deklaram të pasaktë në deklarimet periodike vjetore; (vi) se e ardhura në shumën 160.000 euro, nuk përmbush kriteret e pikës 3, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe, si e tillë, nuk merret në konsideratë nga Komisioni; (v) nuk provoi me dokumentacion ligjor justifikues burimin dhe ligjshmërinë të të ardhurave të personit tjetër të lidhur S.T..

25.1. Subjekti i rivlerësimit, për këto pasuri, ka deklaruar:

25.1.1. Në deklaratën *vetting*:

- *Sipërfaqen e truallit prej 150 m² e kam përfituar me legalizim, në bazë të kontratës për kalimin e pronësisë së disa parcelave ndërtimore, me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 23.05.2005²², notere M. D., shumë e paguar për këtë blerje është 978.267 lekë. Në kolonën “vlera me shifra dhe fjalë” ka deklaruar 978.267 lekë.*
- *Në bazë të vendimit nr. {***} dhe nr. Akti {***}, datë 30.07.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. {***}, datë 31.10.2013, të Gjykatës së Apelit Tiranë, kam fituar të drejtën e pronësisë mbi një sipërfaqe trualli 142 m², e cila ndodhet në {***}, pjesë e pasurisë 8/2, ngjitur me pronën e sipërpërmendur (595.3+150+142=887.3 m²).*
- *Mbi truallin me sip. 433.3 m², nr. pasurie {***}, {***}. {***}, vol. {***}, {***}. {***}, rruga “{***}”, Tiranë, i cili zotërohet nga Fatmira Hajdaraj 3/6 pjesë, A. H.. 1/6 pjesë, K.H. 1/6 pjesë, R. H. 1/6 pjesë, është ndërtuar një objekt 10 kate, me palë ndërtuese dhe investitore, z. S.T.. Pjesa e investuar nga ana jonë në këtë objekt është në vlerën 207.400 euro. Në cilësinë e*

²² Kontrata është e datës 23.05.2015 (gabim material në plotësimin e vitit nga ana e subjektit).

pronarit të truallit dhe të pjesës së investuar kemi përfituar 3 njësi dhe 12 apartamente të pa shitura.²³ Në kolonën “vlera me shifra dhe fjalë” ka deklaruar 207.400 euro.²⁴

25.1.2. Në DIPP-në 2013, subjekti deklaroi për herë të parë marrëveshje private me nr. {***} rep., {***} kol., datë 4.6.2013, palë e parë K.H. dhe palë e dytë S.T.. Pala e parë disponon truallin prej 890 m², {***} dhe pala e dytë përfunduar objekt 10-katësh i pa legalizuar, në pritje të legalizimit (bashkëpronarë 50% me 50%). Të dhënat e tjera në vitin 2014, dhe në kolonën “vlera me shifra dhe fjalë” ka plotësuar viti 2013. Në DIPP-në 2014, subjekti bëri deklaram të njëjtë, sikundër deklarimi në DIPP-në 2013, duke shtuar se përgjatë vitit 2014 nuk u arrit përfundimi i legalizimit²⁵.

²³ Subjekti, në vijim në deklaratën e rivlerësimit vetting, ka deklaruar 3 njësi dhe 12 apartamente të pa shitura: (1) unë dhe fëmijët e mi, me nga ¼ pjesë/secili, një njësi (dyqan), Tiranë, {***}, nr. pasurie {***}, sip. 93,94 m²; (2) me nga ¼ pjesë/secili, një njësi (zyrë), Tiranë, {***}, nr. pasurie {***}, sip. 158.98 m²; (3) me nga ¼ pjesë/secili, një njësi, Tiranë, {***}, nr. pasurie {***}, sip. 158,91 m²; (4) me nga ¼ pjesë/secili, {***}, nr. pasurie {***}, hyrja {***}, ap. {***}, Tiranë, me sip. totale 103 m²; (5) me nga ¼ pjesë/secili, apartament, {***}, nr. pasurie {***}, hyrja {***}, ap. {***}, Tiranë, sip. totale 32,85 m²; (6) me nga ¼ pjesë/secili, apartament, {***}, nr. pasurie {***}, hyrja {***}, ap {***}, Tiranë, sip. totale 98,75 m²; (7) me nga ¼ pjesë/secili, apartament, {***}, nr. pasurie {***}, hyrja {***}, ap. {***}, Tiranë, sip. totale 103,13 m²; (8) me nga ¼ pjesë/secili, apartament, {***}, nr. pasurie {***}, hyrja {***}, ap. {***}, Tiranë, sip. totale 103,13 m²; (9) me nga ¼ pjesë/secili, apartament, {***}, nr. pasurie {***}, hyrja {***}, ap. {***}, Tiranë, sip. totale 103,13 m²; (10) me nga ¼ pjesë/secili, apartament, {***}, nr. Pasurie {***}, hyrja {***}, ap. {***}, Tiranë, sip. totale 98.75 m²; (11) me nga ¼ pjesë/secili, apartament, {***}, nr. Pasurie {***}, hyrja {***}, ap. {***}, Tiranë, sip. totale 160,82 m²; (12) me nga ¼ pjesë secili, apartament, {***}, nr. pasurie {***}, hyrja {***}, ap. {***}, Tiranë, sip. totale 204,68 m².

²⁴ Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur dokumentacionin:

- kërkesë nr. {***} prot., datë 15.7.2013, për legalizimin e ndërtimit pa leje, objekt 10 kate, me sipërfaqe bazë ndërtimi me sip. 420 m² dhe sipërfaqe të përgjithshme të ndërtimit me sip. 4,200 m²;
- deklaratë noteriale nr. {***}, datë 1.4.2015, e lëshuar nga z. K.H., për pronësinë e truallit mbi të cilin është ndërtuar objekti 10-katësh dhe kërkesën për përfshirjen e bashkëpronarëve Fatmira, R. dhe A. H., në procedurat e legalizimit;
- certifikatë për vërtetim pronësie nr. {***}, datë 5.3.2015, për pasurinë me sipërfaqe truall 737.3 m², nga kjo ndërtesë me sip. 95,3 m², në emër të shtetasve Fatmira, K., R. dhe A. H.;
- kartela e pasurisë e llojit truall me sip. 737,3 m², nga kjo ndërtesë 95,3 m², me shënimin “Transaksion i gjeneruar nga bashkim pasurish”, harta treguese e regjistrimit;
- kërkesë e bërë nga shtetasit Fatmira, Fatmira, K., R. dhe A. H., për ndarjen e pasurisë truall me sip. 737,3 m² në pasuri me sipërfaqe truall 454 m² e ndërtesë 95,3 m² dhe pasuria tjetër me sipërfaqe truall 283,3 m²;
- certifikatë për vërtetim pronësie nr. {***}, datë 30.3.2016, për pasurinë me sip. truall 887,3 m² dhe ndërtesë me sip. 302.3 m², në emër të shtetasve Fatmira, K., R. dhe A. H., kartela e pasurisë;
- marrëveshje private nr. {***}, datë 4.6.2013, lidhur midis palëve K. H. dhe S. T., për përfundimin e punimeve për ndërtimin e objektit 10-katësh. Rezulton i ndërtuar deri në fazën e karabinasë, në katin e 5-të (pestë) teknik karabina dhe kolonat e betonuara mbi këtë kat dhe vlera e këtij investimi rezulton të jetë 207.400 euro;
- vërtetim nga dokumenti hipotekor nr. {***}, datë 15.2.2002, për pasurinë nr. {***}, ndërtesë me sip. 95,3 m² dhe truall me sip. 500 m², regjistruar në emër të shtetasve Fatmira, K., R. dhe A. H., kopje pasaporte e djalit K. H.;
- kontratë formimi të shoqërisë së thjeshtë, lidhur mes shtetasve K.H. dhe S. T. [dhe shoqërisë “{***}” ShPK, referuar si palë në kontratë, por administratori, G. D. nuk ka firmosur], për ndërtimin e objektit 10-katësh, ku ndarja paraprake është sip. 1742,5 m² K. H. dhe 1416,2 m² S. T., planimetria e kateve;
- kontratë shkëmbimi nr. {***}, datë 25.4.2016, me palë shkëmbyese pronar truall Fatmira, K., R. dhe A.H.dhe palës shkëmbyese investitor S. T., së bashku me të gjitha certifikatat e pronësisë;
- kopje ID e subjektit Fatmira Hajdaraj; kopje pasaporte e djalit K. H.j, kopje pasaporte e vajzës R. H.;
- prokurë e përgjithshme nr. {***}, datë 18.1.2016, e përfaqësuar R. H., përfaqësuese Fatmira Hajdaraj;
- vendim nr. {***}, datë 26.2.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për lejimin e kërkueses Fatmira Hajdaraj për të kryer veprimet e tjetërsimit të pjesës takuese të fëmijës së mitur A. H.. Certifikatë e përbërjes familjare të subjektit Fatmira Hajdaraj. Kopje ID e shtetasit S. T.;

²⁵ Në DIPP-të e viteve vijuese, subjekti nuk deklaroi lidhur me ndërtimin/përfundimin e legalizimit, por deklaroi të ardhura nga shitja e pjesëve takuese të ndërtimit; në DIPP-në 2015, subjekti deklaroi shtesë të ardhurash në

26. Lidhur me pretendimin e subjektit se nuk qëndron konkluzioni i Komisionit se *nuk ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin në DIPP-të e viteve përkatëse investimin, fillimin dhe përfundimin e kryer në ndërtesën informale 5-katëshe karabina, në kundërshtim me germën “a”, të pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016*, pasi, sipas saj, deklarimi në DIPP-në 2013 dhe DIPP-në 2014, i marrëveshjes private lidhur mes djalit të saj dhe investitorit S.T. në datën 04.06.2013, përfshin brenda saj të dhënat për investimin e kryer prej tyre [truallin, shumën e investimit, masën e përfitimit në %] dhe për investime të mëpasshme dhe se nuk ishte detyrim i subjektit t’i kërkonte llogari shoqërisë sa investonte dhe situacionet periodike të saj për t’i bërë pjesë të deklarimit, trupi gjykues analizon si vijon.

26.1. Referuar dokumentacionit të praktikës së legalizimit dhe aktit të kolaudimit të objektit 10-katësh rezulton se përgatitja e sheshit të ndërtimit ka filluar në shtator 2012, punimet kanë filluar në tetor të vitit 2012 dhe kanë përfunduar në dhjetor 2014. Subjekti i rivlerësimit pretendon se në vitin 2012 nuk ka deklaruar *as fillimin e punimeve e as investimin* pasi: (i) investimi në ndërtimin e objektit, nga fund shtatori 2012 deri në qershor 2013 ishte i z. G. B., administrator i shoqërisë “{***}” ShPK., si një marrëveshje verbale *kleringu* e këtij shtetasi me personin e lidhur [djalin e subjektit], me kushtin që vlera e materialeve ndërtimore të sjella nga z. G. B. në objekt, vlerë jo më e madhe se 10 milion lekë, do të shlyhej me sipërfaqe ndërtimore në përfundim të ndërtimit, kur do të bëheshin rakordimet përkatëse të mallit të sjellë dhe të çmimit; (ii) në vitin 2012, personi i lidhur (djali) nuk dinte sa ishte ekzaktësisht vlera e materialit ndërtimor të sjellë nga shoqëria “{***}” ShPK., nuk e dinte nëse ky ndërtim do të vazhdonte apo do të merreshin masa për ta prishur dhe vlera e investimit do të shkëmbehej me sipërfaqe ndërtimore, nëse do të finalizoheshin ndërtimi pas legalizimit të tij.

26.2. Nga mënyra si subjekti e pretendon *marrëveshjen verbale të kleringut* mes personit të lidhur [djalit] dhe shtetasit G. B., mbetet e paqartë, nëse shuma e investuar ka buruar nga një marrëdhënie huadhënie apo dhurim, por në çdo rast subjekti kishte detyrimin të deklaronte në DIPP vlerën e materialeve ndërtimore të sjella në objekt nga shtetasi G. B.. Referuar në ligjin nr. 9049/2003, nuk ka asnjë parashikim për përjashtimin nga deklarimi i një detyrimi të lindur në vitin korrent, për shkak se në vitet në vijim, në një situatë të mundshme hipotetike, ky detyrim mund të shuhet dhe të konsiderohet si dhurim. Subjekti ka dorëzuar deklaratën e interesave privatë të vitit 2012 në datën 30.03.2013, kohë në të cilën vijonin punimet për ndërtimin e objektit informal dhe në këtë situatë faktike, në zbatim të nenit 4, germa “dh” e ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, që parashikon: [...] *Subjektet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji detyrohen të deklarojnë [...] brenda datës 31 mars të çdo viti, gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të pasurive, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare si më poshtë: [...] dh) detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë, të shprehura në lekë ose në valutë të huaj; [...]*, subjekti kishte detyrimin të deklaronte vlerën e investimit të kryer në objekt nga z. G. B., duke përcaktuar qartë edhe llojin e veprimtimit juridik që mundësonte kryerjen e këtij investimi. Gjithashtu, sqarimet në formularët e

*shumën 49.888 lekë nga kontrata e sipërmarrjes në lidhje me shitjen e një apartamenti të përfutur nga pjesa 50% në pronësi, sipas marrëveshjes nr. {***} rep., {***} kol., datë 4.6.2013.*

deklarimit nuk lënë hapësira për të ngritur pretendime, lidhur me mosdeklarimin e detyrime financiare ndaj personave juridikë e fizikë, të lindura nga zyrtari gjatë vitit të deklarimit²⁶.

26.3. Lidhur me pretendimin e subjektit se nuk kishte çfarë shume të deklaronte si investim të z. G. B., pasi sipas saj *personi i lidhur [djali] nuk kishte dijeni sa ishte ekzaktesisht vlera e materialit ndërtimor të sjellë nga shoqëria “{***}” ShPK.*, referuar marrëveshjes private, me nr. {***}rep., {***}kol., datë 4.6.2013, lidhur mes K.H. dhe S.T. në cilësinë e bashkëinvestitorëve të objektit 10-katësh, përcaktohet se: *[...]...prej zotit K.H. është kryer një ndërtim i cili rezulton i ndërtuar deri në fazën e karabinasë, në katin e 5 (pestë) teknik karabina dhe kolonat e betonuara mbi këtë kat. Vlera e këtij investimi (karabinasë) rezulton të jetë 207.400 euro, sipas preventivit të bashkëngjitur, projektit konstruktiv dhe fotove përkatëse. [...].* Nga përmbajtja e kësaj marrëveshjeje, rezulton se në qershor 2013, prej personit të lidhur është përcaktuar e gjithë vlera e investimit në objekt deri në atë moment, përfshirë edhe vlerën e materialeve të ndërtimit të sjella nga z. G. B., dëshmuar edhe nga preventivi me përlllogaritje të zërave përkatës, pjesë e marrëveshjes. Në këtë situatë faktike, kur marrëveshja mes djalit të subjektit dhe investitorit S.T. është lidhur tre muaj pas dorëzimit nga ana e subjektit të DIPP-në 2012, trupi gjykues e vlerëson të pabazuar pretendimin e subjektit për padijeni të vlerës së materialeve të sjella në objekt nga z. G. B., si për vitin 2012, ashtu dhe për vitin 2013. Trupi gjykues, në konsideratë të kundërshtimit të subjektit në ankim për shumën e investimit prej 18.174.721 lekësh vendosur nga Komisioni për vitin 2012, me pretendimin se *investimi ka qenë në një vlerë më të vogël, si për faktin që sapo kishin filluar punimet, edhe për faktin që këto muaj ka qenë me shumë reshje*, vlerëson se subjekti edhe me këtë deklaram dëshmon për dijeninë e saj lidhur me vlerën e investimit në objekt të pretenduar si të kryer nga z. G. B., në këtë vit.

26.4. Nga ana e subjektit, në përmbushje të barrës së provës, në materialin e dorëzuar në Komision në datën 05.06.2020, janë përfshirë në format fotografie 115 fletëdalje të lëshuara nga shoqëria “{***}” ShPK, të pretenduara prej saj si *të ruajtura rastësisht prej tyre dhe të paraqitura në cilësinë e dokumentacionit justifikues ligjor që vërteton materialet e marra nga kjo shoqëri.* Duke abstraguar nga forma si janë paraqitur këto fletëdalje²⁷, në disa prej tyre evidentohen data të vitit 2012 dhe për shkak edhe të këtij dokumentacioni të paraqitur prej saj, pretendimi se në vitin 2012 personi i lidhur nuk kishte dijeni për vlerat e materialeve të ndërtimit të sjella nga G. B. është i tejkaluar. Nëse fletëdaljet do të ishin paraqitur në formën e kërkuar nga ligji dhe përmbajtja e tyre do të ishte konform me kërkesat e ligjit, përmes tyre do të provohej se punimet e ndërtimit të objektit janë kryer me materiale ndërtimi të shoqërisë “{***}” ShPK, por nuk do të provonin natyrën e marrëveshjes së *kleringut* apo të dhurimit, mes z. G. B. dhe personit të lidhur.

26.5. Pjesë e praktikës së ALUIZNI-t është edhe “Projekti konstruktiv i objektit godinë banimi me dyqane 10 kate”, i datës 5.10.2012, me porositës personin e lidhur, K.H. dhe i hartuar prej një

²⁶ Në formularin “Të dhëna konfidenciale”, për subjektin deklarues qartësohet *...përshkruani hollësisht llojin e dhuratës në vlerën mbi 10.000 lekë, si dhe trajtime preferenciale, nga deklarimi i mëparshëm deri në 31 dhjetor të vitit të deklarimit..., si dhe... përshkruani të dhënat KONFIDENCIALE që kanë lidhje me: pasuritë private të paluajtshme dhe/ose të luajtshme, të regjistruara ose jo në regjistrat publikë, detyrimet financiare, identitetin e personit juridik ose fizik, huadhënës a huamarrës....*

²⁷ Fletëdaljet janë paraqitur në format fotografie, mbivendosur te njëra-tjetra, në 17 faqe format A4, ku shquhet vetëm gjysma e sipërme e tyre [për shkak të mbivendosjes së tyre, pjesa e poshtme/përmbyllëse e tyre është e padukshme]. Vetëm njëra prej tyre me nr. 153, është paraqitur pothuaj e plotë dhe në të shquhen dy nënshkrime dhe vlera 51.800 lekë [si prodhim i 7x5400, ku shifra 7 figuron e pasqyruar në kolonën “sasia” dhe shifra tjetër në kolonën “çmimi”. Për sa të gjithë fletëdaljet janë të plotësuara në kolonat “sasia” dhe “çmimi”, pavarësisht se kolona e tretë e tyre “vlera” nuk është e plotësuara, nuk përjashtohet që të jetë plotësuar sikundër në faturën nr. {***}.

grupi prej katër inxhinierësh konstruktorë. Nga përmbajtja e këtij projekti, rezulton që ai të jetë bazuar edhe në raporte të studimeve gjeologjike dhe raporte sizmike të hartuara nga inxhinierë të fushave përkatëse. Referuar në aktet e kohës,²⁸ hartimi i këtij dokumentacioni do të dëshmonte për kryerjen e shpenzimeve të tjera në funksion të ndërtimit të objektit 10-katësh, të cilat nuk janë deklaruar prej subjektit apo referuar që të jenë siguruar nga personi i lidhur, me ndonjë marrëveshje për mënyrën e shlyerjes apo shlyerjen e mëvonshme të tyre. Subjekti, gjithashtu, në ankim deklaroi për angazhimin e *ndjekësit të punimeve*²⁹, të cilit i dorëzohej malli dhe fletëdaljet e materialeve të ndërtimit, po ashtu për kryerje të punimeve për përgatitjen e sheshit të ndërtimit, hapjen e gropës së themeleve, hedhjen e themeleve, kostot e të cilave nuk deklarohen prej saj. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se për vitin 2012, në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 9049/2003³⁰, subjekti nuk ka deklaruar fillimin e punimeve dhe shpenzimet për ndërtimin informal, të cilat nuk kufizohen vetëm në materiale ndërtimi, por përfshijnë edhe zëra të tjerë shpenzimesh, sipas akteve të administruara dhe deklarimeve të vetë subjektit.

27. Lidhur me pretendimin e subjektit se *nuk ka deklaruar përfundimin e punimeve të ndërtimit në DIPP-në 2014, për sa investimi i djalit prej 207.400 eurosh, i deklaruar në vitin 2013, ka qenë i pandryshueshëm për vitet në vijim, për pasojë nuk kishte detyrim të deklaronte situacionin e punimeve të kryera nga të tretët deri në përfundimin e ndërtimit, por ka deklaruar që godina ishte në proces legalizimi*, trupi gjykues vlerëson se:

27.1. Në marrëveshjen private, me nr. {***} rep., {***} kol., datë 4.6.2013, palë e parë K.H. dhe palë e dytë S.T., palët kanë formalizuar për rregullimin e marrëdhënies si bashkëinvestitorë të objektit, duke përcaktuar të drejtat dhe detyrimet mes tyre. Sipas përmbajtjes së këtij akti, marrëdhënia mes palëve kushtëzohet nga kryerja pas përfundimit të karabinasë e legalizimit të objektit në afatet të përcaktuara, nga personi i lidhur [djali i subjektit]³¹. Në këto kushte, deklarimi i përfundimit të punimeve të ndërtimit do të provonte për raportin përfundimtar të ndarjes së përfitimit nga bashkëinvestimi në ndërtim, nëse palët ruanin të njëjtin raport, sikundër përcaktuar në këtë marrëveshje apo kishte pasur aplikim të kushteve të marrëveshjes për ndryshim të raporteve të pronësisë në objekt.

27.2. Në konkluzion të analizës së kryer për këto shkaqe ankimi, Kolegji ndonëse konfirmon qëndrimin e Komisionit për mungesën e deklarimeve në kundërshtim me ligjin nr. 9049/2003, të

²⁸ Referuar vendimit nr. 444, datë 05.09.1994, të Këshillit të Ministrave, "Tarifat e studimit, projektimit, drejtimit dhe kolaudimit të veprave të ndërrimit", sipas llojit të objekteve, fazave të ndryshme (projektim, zbatim, kolaudim etj.), si dhe klasifikimit të ndërtimeve, përcaktohen tarifat për vlerësimin e punës studimore, projektuese, drejtim dhe kolaudim të punimeve të ndërtimit që financohen nga Buxheti i Shtetit. Tarifat në përqindje për studimin e projektimin, i referohen kushtimit të punimeve të montim-ndërtimit të llogaritur në përqindje sipas preventivit, për kushtimin në nivelin 10 milion lekë, 5.2 -10.4, sipas tipologjive dhe specifikave të tjera të parashikuara. Referuar aktit të kolaudimit, vlera e objektit sipas preventivit, është 113.950.000 lekë dhe kostoja e projekteve teknike, për llogaritur sipas tarifave të VKM-së sipërcituar, tejkalon mbi shumën e përcaktuar si kufi të shpenzimeve për të cilat nuk ka detyrimin për të kryer deklarim.

²⁹ Sipas parashikimeve të Udhëzimit nr. 2, datë 13.05.2005, "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit".

³⁰ Me ligjin ndryshues nr. 85/2012, datë 18.09.2012, në ligjin nr. 9049/2003, i ndryshuar, ndër të tjera, në nenin 4 u shtua shkronja "h" me këtë përmbajtje "h" çdo shpenzim i deklarueshëm, me vlerë mbi 500.000 (pesëqind mijë) lekë, i kryer gjatë vitit të deklarimit.

³¹ Në pikën 2.2. të marrëveshjes përcaktohet se [...] Pala e parë (djali i subjektit) pas përfundimit të karabinasë merr përsipër dhe do të kryejë legalizimin e plotë të veprës me të gjitha shpenzimet. Në rast se legalizimi nuk kryhet, atëherë pala e dytë, do presë tre muaj dhe nëse pas përfundimit të karabinasë nuk është kryer ende legalizimi pala e parë do të kthejë shumën e lekëve ose do të futen për leje legalizimi si bashkëpronarë 50% me 50%, në këtë rast vendimi i përket palës së dytë, dhe në këtë rast palët janë pronarë të vetëm 50% me 50%.

momentit të fillimit e përfundimit të punimeve në këtë pasuri, nuk e konsideron këtë shkelje si të kualifikueshme në ndonjë nga rastet e parashikuara nga neni 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, për sa kohë ajo referohet si e tillë në raport me DIPP-të përkatëse.

28. Lidhur me pretendimin e subjektit se pasurinë truall me sipërfaqe 142 m², të përfituar me vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë e ka deklaruar në DIPP-në 2013, trupi gjykues analizon si vijon.

28.1. Subjekti i rivlerësimit, në DIPP-në 2013, në formatin “ndryshime të interesave private në pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme”, ka deklaruar se: *[..] marrëveshje private nr. {***} rep., {***} kol., datë 4.6.2013, palë e parë: K.H. dhe palë e dytë: S.T.. Pala e parë disponon truallin prej 890 m² dhe pala e dytë përfunduar objekt 10-katësh i palegalizuar, në pritje të legalizimit (bashkëpronarë 50% me 50%). Të dhënat e tjera në vitin 2014... [..]. Ky deklaram, në të cilin, sipas pretendimeve të subjektit, sipërfaqja e deklaruar prej 890 m² përfshin edhe sipërfaqen e truallit me sipërfaqe 142 m² konsiderohet se nuk vjen në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9049/2003 sepse: së pari, trualli me sipërfaqe 142 m² nuk është pasqyruar si pasuri veçmas, kërkesë e ligjit e specifikuar qartë në formularin e deklaramit se shtesat apo pakësimet e pasurive të pasqyrohen veçmas, me qëllim kontrollin e tyre nga ILDKPKI-ja; së dyti, duke mosdeklaruar burimin e krijimit të pasurisë, subjekti nuk ka përmbushur detyrimin e pikës 2, neni 4 të ligjit nr. 9049/2003, së treti, vendimi i gjykatës³² shprehet për pronësi të truallit të subjektit dhe tre fëmijëve të saj, ndërkohë që në DIPP-në 2013 subjekti ka deklaruar posedimin vetëm nga djali të truallit me sipërfaqe 890 m², i cili përfshin sipërfaqen 142 m².*

28.2. Komisioni duke konkluduar se *mosdeklarimi i saktë dhe në përputhje me ligjin i kësaj pasurie të përfituar në vitin 2013, nuk mund të përbëjë i vetëm shkak për shkarkim duke qenë se ka deklaruar sipërfaqen totale të truallit përfshirë edhe sipërfaqen 142 m², nuk e ka ngarkuar subjektin me përgjegjësi për pasaktësitë në deklaramin e kësaj pasurie në DIPP-në 2013. Në këtë situatë faktike, trupi gjykues vlerëson jo relevat shkakun e ankimit të ngritur nga subjekti për këtë konkluzion të Komisionit.*

29. Lidhur me pasurinë truall me sipërfaqe 150 m², subjekti kundërshton konkluzionin e Komisionit se *nuk ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin, në deklaratën e interesave private të vitit 2015, këtë pasuri të përfituar me VKM-në nr. 823, datë 7.10.2015 dhe kontratën për kalimin e disa parcelave ndërtimore nr. {***}, datë 23.12.2005, duke pretenduar se: (i) në zyrën noteriale ku u firmos kontrata na u pohua që si pjesë e procesit të legalizimit, kontrata do të konsiderohet e përfunduar vetëm pas miratimit të legalizimit të godinës dhe regjistrimit të saj në ZVRPP, proces që do të bëhet nga ALUIZNI në një kohë të dytë; (ii) kontrata nuk ka qenë e depozituar për regjistrim pranë ZVRPP-së në vitin 2015, vit ku ende nuk kishte përfunduar procesi i legalizimit, nuk u deklarua në DIPP-në 2015, duke u konsideruar procedurë në vazhdim; (iii) sipërfaqja e tokës truall 890 m² e deklaruar në DIPP-në 2013 e në vijim përfshin edhe sipërfaqen 150 m², sikundër edhe sipërfaqen 142 m². Për këtë shkak ankimi, trupi gjykues analizon si vijon.*

29.1. Në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se sipërfaqen e truallit prej 150 m² e ka përfituar me legalizim në bazë të kontratës për kalimin e pronësisë së disa parcelave ndërtimore me nr. {***}, datë 23.12.2005. Shuma e paguar për këtë blerje është 978.268 lekë. Në DIPP-në 2015, në formularin “Ndryshimet e pasurive dhe burimi i krijimit”, subjekti nuk ka

³² Pronësia mbi truallin me sipërfaqe 142 m² është fituar me vendimin nr. {***}, datë 30.07.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. {***}, datë 31.10.2013, të Gjykatës së Apelit Tiranë.

deklaruar lidhur me këtë pasuri dhe burimin e krijimit të saj, megjithëse pagesat për fitimin e pronësisë janë kryer në datën 22.15.2015, në kundërshtim me germën “a”, nenit 4 të ligjit nr. 9049/2003³³.

29.2. Sipas kontratës për kalimin e pronësisë së disa parcelave ndërtimore të datës 23.12.2015,³⁴ me palë shitëse ALUIZNI, ka kaluar në pronësi të palës blerëse, subjektit të rivlerësimit dhe personat e lidhur [tre fëmijët e subjektit], parcela ndërtimore me sipërfaqe 150 m². Veprimi juridik i lidhjes së kontratës për kalimin e pronësisë së truallit me sipërfaqe 150 m², plotëson të gjitha kushtet e parashikuara në nenet 79, 663 dhe 659 të Kodit Civil dhe me nënshkrimin e kontratës, subjekti dhe personat e lidhur janë bërë pronarë të ligjshëm të pasurisë truall me sipërfaqe 150 m². Pretendimi i subjektit se kontrata nuk u depozitua për regjistrim pranë ZVRPP-së në vitin 2015, pasi si pjesë e procesit të legalizimit do të konsiderohej e përfunduar vetëm me miratimin e legalizimit dhe për këtë shkak nuk u deklarua në DIPP-në 2015, vlerësohet nga trupi gjykues i pabazuar, për sa kohë regjistrimi i veprimit juridik [kontratës] në regjistrat e pasurive të paluajtshme i mundëson blerësit që të tjetërsojë pasurinë të të tretët, por nuk është element i vlefshmërisë së kontratës për kalimin e pronësisë. Referuar në parashikimet e ligjit nr. 9049/2003, subjekti ka pasur detyrimin të deklarojë pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to, sipas Kodit Civil, detyrim i qartësuar edhe në formularin e deklarimit të *çdo lloj pasurie, të regjistruar ose jo në regjistrat publikë* dhe, për rrjedhojë, trupi gjykues vlerëson të pabazuar pretendimin e subjektit.

29.3. Lidhur me pretendimin e subjektit se trualli me sipërfaqe 150 m² është deklaruar në DIPP-në 2013 e në vijim, pasi prej saj është deklaruar marrëveshja private mes personit të lidhur dhe investitorit S.T. në vitin 2013 dhe ky truall është pjesë e sipërfaqes së truallit prej 890 m² të deklaruar në aktmarrëveshje si investim i personit të lidhur, trupi gjykues vlerëson se përfshirja e këtij trualli si pjesë e investimit prej personit të lidhur [djali i subjektit], i korrespondon posedimit faktik të tij, por jo zotërimit ligjor, duke qenë se as ai dhe as subjekti nuk e kishin fituar ende formalisht këtë të drejtë. Pronësia për këtë pasuri është fituar në datën 23.12.2015 dhe në DIPP-në 2015, subjekti nuk ka përmbushur detyrimin e buruar nga ligji nr. 9049/2003, për deklarimin e saj, si dhe për vlerën e paguar në shumën totale 978.267 lekë, nga të cilat shuma prej 402.267 lekësh e paguar në lekë, shuma prej 560.000 lekësh në Bono Privatizimi dhe shuma prej 16.000 lekësh pagesë si tarifë e shërbimit për legalizim, pagesa të kryera sipas mandatit të datës 22.12.2015 të lëshuar nga “Credins Bank”³⁵.

³³ Neni 4 ligjit nr. 9049/2003, përcakton se: “Subjektet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji detyrohen të deklarojnë në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave brenda datës 31 mars të çdo viti, gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të interesave privatë, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare si më poshtë: a) pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to, sipas Kodit Civil ...”.

³⁴ Kontrata nr. {***}, datë 23.12.2015, notere M. D., me objekt kalimin në pronësi të parcelës ndërtimore me sipërfaqe 150 m² [sipërfaqe të parcelës ndërtimore sipas gentplanit bashkëlidhur prej 887,3 m², dhe me sipërfaqe të ndërtimit prej 207 m², me numër të dosjes së vetdeklarimit {***}...] shitësi i autorizuar nga Këshilli i Ministrave për të kryer veprimet e kalimit të pronësisë i kalon të drejtën e pronësisë mbi këtë sipërfaqe blerësit, pasi blerësi ka paguar vlerën e parcelës ndërtimore ..në shumën totale 978.267 lekë, nga të cilat pagesë e kryer për parcelën ndërtimore është shuma e paguar në lekë prej 402.267, në Bono Privatizimi shuma prej 560.000 lekësh dhe pagesë si tarifë e shërbimit për legalizim shuma prej 16.000 lekësh”.

³⁵ Në nenin 3 të kontratës, “Të drejtat dhe detyrimet e palëve” parashikohet se shitësi deklaroi se do ta lëshojë dokumentacionin tekniko-ligjor për legalizimin e objektit, nëse dokumentacioni i paraqitur nga blerësi është në përputhje me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar. Pala shitëse garanton kryerjen e procedurave të regjistrimit të parcelës ndërtimore dhe të objektit, sipas

29.4. Sipas nenit 179/b të Kushtetutës, objekti i hetimit dhe i vlerësimit të pasurisë së subjekteve, që i nënshtrohen procesit të rivlerësimit, është kontrolli i saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklarimeve të subjektit [*në deklaratën vetting dhe ato periodike*]. Në çdo rast, subjekti duhet të shpjegojë bindshëm ligjshmërinë e krijimit të pasurisë dhe ekzistencën e të ardhurave të ligjshme për krijimin e saj. Në këto kushte përveç sa më lart, Komisioni, pasi ka kryer analizën financiare duke marrë në konsideratë pasuritë, të ardhurat, detyrimet dhe shpenzimet e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur³⁶, ka arritur në konkluzionin se për vitin 2015, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë mungesë të ardhurash të ligjshme për blerjen e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve në vlerën 1.504.977 lekë. Subjekti kundërshton këtë konkluzion të Komisionit duke pretenduar që vlera prej 418.267 lekësh, shumë e paguar për fitimin e kësaj pasurie, të zhvendoset nga seksioni “shpenzime” në seksionin “pasuri”. Ky pretendim nuk ndryshon balancën negative të vitit 2015, e cila nga analiza financiare e kryer në Kolegj rezulton -1.354.977 lekë, duke dëshmuar se në vitin 2015 subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur nuk kanë pasur mundësi financiare për shlyerjen e detyrimeve për krijimin e kësaj pasurie dhe përbalimin e shpenzimeve familjare.

29.5. Në konkluzion, lidhur me këtë qëndrim të Komisionit, Kolegji, ndonëse konfirmon qëndrimin e Komisionit për mungesën e deklarimeve në DIPP-në e vitit 2015, në kundërshtim me ligjin nr. 9049/2003, të fitimit të pronësisë mbi sipërfaqen e truallit prej 150 m² në viti 2015, nuk e konsideron këtë shkelje si të kualifikueshme në ndonjë nga rastet e parashikuara nga neni 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, për sa kohë ajo referohet, si e tillë, në raport me DIPP-të përkatëse. Ndërsa në konsideratë të konkluzioneve të analizës financiare të kryer në Kolegj, sipas së cilës rezulton se subjekti gjendet në kushtet e mungesës të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar vlerën e shpenzuar për krijimin e pasurisë truall me sipërfaqe 150 m², të blerë në zbatim të VKM-së nr. 823, datë 07.10.2015, e konsideron këtë situatë faktike si të kualifikueshme, sipas përcaktimeve të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

30. Lidhur me shumën prej 207.400 eurosh³⁷, subjekti kundërshton konkluzionin e Komisionit se *nuk ka deklaruar në mënyrë të qartë në deklaratën vetting burimin e krijimit të saj, duke pretenduar se ka deklaruar në formularin e detyrimeve shumën 10.000.000 lekë ndaj z. G. B. [{"***"} ShPK], si dhe në formularin “angazhime dhe veprimtari private dhe/ose publike dhe të ardhurat e krijuara prej tyre” ka deklaruar shumën 160.000 euro, përftuar nga shitja e biznesit të djalit në favor të E.H. dhe F.P., sqaruar të dy këto në formularin e “deklarimeve konfidenciale”, në të cilin, për shumën e parë është deklaruar se është marrë në formën e materialeve të ndërtimit dhe për të dytën është deklaruar se është përftuar nga shitja e investimit të kryer në ambientin e marrë me qira, ku investimi është realizuar nëpërmjet kredisë së marrë nga “Alpha Bank”.*

30.1. Në deklaratën e rivlerësimit *vetting*, subjekti ka deklaruar detyrimin financiar ndaj z. G. B., në shumën prej 10.000.000 lekësh dhënë personit të lidhur [djalit të subjektit], si *vlerë e marrë në*

deklarimeve të bëra në dokumentacionin e legalizimit, pasi blerësi të ketë përmbushur detyrimet në bazë të kësaj kontrate dhe të ligjit nr. 9482/2006... Në nenin 5 “Dispozita të fundit”, përcaktohet dokumentacioni bashkëlidhur, si pjesë përbërëse e kontratës, ku me numër rendor 3 figurojnë mandatpagesat e “Credins Bank”.

³⁶ *Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit administrativ, ku për vitin 2015, duket se ka mungesë burimesh të ligjshme në shumën 1.504.997 lekë, duke i vënë në dispozicion subjektit Aneksin 01 - analiza financiare e detajuar dhe Aneksin 02 – shpjegime lidhur me analizën financiare.*

³⁷ *Subjekti, lidhur me këtë shumë të pretenduar si investim në godinën 10-katëshe, përkatësisht në karabinanë 5-katëshe dhe në kolonat e katit të 6-të, shprehet se përbëhet nga 68.342.32 euro [10.000.000 lekë materiale ndërtimi] + 139.139,69 euro nga shitja e biznesit të personit të lidhur [djalit].*

formën e materialeve të ndërtimit në fazën e ndërtimit të karabinasë të pallatit 10-katësh të ndërtuar mbi truallin pronë e jona, si pjesë e financuar nga ana jonë (deklaratë 20.01.2015). Bashkëlidhur deklaratës vetting, subjekti ka dorëzuar një deklaratë me nënshkrim G. B. që mban datën 20.01.2015, e panoterizuar, në përmbajtje të së cilës pasqyrohet se G. B., administrator i shoqërisë “{***}” ShPK, deklaroi se i kam dhënë z. K. H., 10.000.000 lekë të reja (me marrëveshje verbale), për ndërtim karabinaje, pallati... që kjo shumë të më kompensohet me hyrje banimi, në këtë objekt, sa i përket pjesës takuese, si pronarë truall, ndërkohë që në një deklaratë tjetër të datës 14.01.2015³⁸, të gjendur në dosjen e ILDKPKI-së, të nënshkruar nga ky shtetas, e panoterizuar, vlera e materialeve të ndërtimit dhënë djalit të subjektit deklarohet 100.000 euro. Deklarimet e subjektit se vlera e materialeve të ndërtimit të dhënë nga z. G. B. është rakorduar në përfundim të punimeve të ndërtimit të objektit 10-katësh, në shifrën 68.260, 31 euro, mbështetur me deklaratën noteriale të z. G. B., nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 23.12.2019, mbeten të paprovuara për sa vijon.

30.1.1. Nga hetimi administrativ është provuar se shoqëria “{***}” ShPK nuk ka lëshuar fatura tatimore në emër të subjektit të rivlerësimit apo personit të lidhur K.H., dokumentacion i detyrueshëm për veprimtarinë e shoqërisë bazuar në përcaktimet e ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar³⁹. Nga informacioni i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve;⁴⁰ (i) në librat e shitjeve të viteve 2012-2013, të deklaruar nga shoqëria “{***}” ShPK, nuk ka rezultuar asnjë faturë shitje për subjektin e rivlerësimit apo personin e lidhur; (ii) në raportin e kontrollit të datës 22.4.2015,⁴¹ në zërin e bilancit “kërkesa të arkëtueshme”, ku pasqyrohen të gjithë klientët që i detyrohen shoqërisë “{***}” ShPK, një shumë mbi 3.000.000 lekë, në datën 31.12.2012 dhe në datën 31.12.2013 nuk pasqyrohen emrat e tyre. Subjekti, si në përmbushje të barrës së provës, ashtu edhe me ankimin ndaj vendimit të Komisionit, nuk ka paraqitur asnjë dokument ligjor për të mbështetur pretendimet e saj, lidhur me materialet e ndërtimit të marra nga shoqëria “{***}” ShPK, në vitet 2012 dhe 2013. Fletëdaljet e përfshira në format fotografie nuk plotësojnë kriteret ligjore për t’u marrë në cilësinë e provës⁴². Sa i përket

³⁸ Deklarata e G. B. e datës 14.01.2015 nuk mban datë pranimi/numër protokoll nga ILDKPKI-ja, si dhe nuk rezultoi të jetë administruar nga ILDKPKI-ja në kuadër të një hetimi administrativ, nuk ka një procesverbal për administrimin e saj. Subjekti, në ankim, teksa ngre pretendime lidhur me një tjetër shkak ankimi, shprehet se ka dhënë sqarime pranë ILDKPKI-së, ku është pyetur posaçërisht, si për vlerën e investimit në ndërtimin e godinës 10-katëshe, ashtu dhe për ndryshimin me rritje të sipërfaqes së tokës truall në 890 m². Nën këtë pretendim, deduktohet që subjekti të jetë paraqitur në ILDKPKI për të dhënë shpjegime lidhur me deklaratat e saj, pasuritë dhe interesat private. Por nga shqyrtimi i raportit të ILDKPKI-së dërguar në Komision, sikundër edhe nga dokumentacioni në dosje, nuk rezultoi ndonjë dokument apo e dhënë për të provuar se subjekti ka dhënë shpjegime në ILDKPKI [ftesë e ILDKPKI-së drejtuar subjektit për të dhënë shpjegime, procesverbal mbi shpjegimet e dhëna nga subjekti apo dokumente të dorëzuara prej saj në mbështetje të shpjegimeve të dhëna].

³⁹ Ligji nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 46, pika 1, përcakton: “Tatimpaguesit, që janë subjekt i TVSH-së ose i tatim-fitimit, për përlllogaritjen e detyrimit tatimor, mbajnë regjistrat, dokumentacionin kontabël, librat dhe informacionin financiar, si dhe lëshojnë faturë tatimore, dëftesë tatimore ose kupon tatimor, në përputhje me ligjet e fushës, si dhe aktet nënligjore, të nxjerra në zbatim të tyre”.

⁴⁰ Shkresa nr. {***} prot., datë 7.02.2020, administruar në Komision me nr. {***} prot., datë 13.02.2020.

⁴¹ Kontrolli i ushtruar në shoqërinë “{***}” ShPK, nga inspektori i Kontrollit tatimor në Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë, Njësia e Tatimpaguesve të Mëdhenj Tiranë.

⁴² Për këto fletëdalje, duke abstraguar nga mënyra si ato janë paraqitur, evidentohet mungesa e nënshkrimit të palëve dhe, për rrjedhojë, ato nuk plotësojnë kriteret e përcaktuara në VKM-në nr. 783, datë 22.11.2006, “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël”. Konkretisht, në pikën 2.2. të VKM-së sipërcituar përcaktohet se: “Çdo dokument justifikues duhet të përmbajë: ‘... tregimin e personit ose të njësive administrative që urdhëron kryerjen e

deklaratës noteriale të z. G. B., të datës 23.12.2019, të cilën subjekti e ka paraqitur në Komision në përmbushje të barrës së provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit administrativ: *mungesë financiare, shoqëruar me dokumentacion justifikues ligjor për shumën 68.260,31 euro [10.000.000 lekë], e deklaruar si e marrë me klering në formën e materialeve të ndërtimit*, trupi gjykues, në konsideratë të qëndrimit të mbajtur nga Kolegji për zbehje të forcës provuese të deklaratës noteriale të kryer gjatë procesit të rivlerësimit në favor të pretendimeve të subjektit, vlerëson se ky deklarim vjen në kundërshtim me situatën faktike të provuar nga informacioni i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerëson se subjekti ka dështuar të provojë me dokumentacion justifikues ligjor marrjen e materialeve të ndërtimit nga shoqëria “{***}” ShPK, në shumën 68.260,31 euro [10.000.000 lekë], në vitin 2012.

30.2. Lidhur me pretendimet e subjektit për konkluzionin e Komisionit se *nuk e ka deklaruar detyrimin për vlerën 10.000.000 lekë, për vitet 2012, 2013, 2014 dhe 2015 dhe, për pasojë, subjekti ka bërë deklarim të pasaktë në deklaratimet periodike vjetore, vërtetuar kjo me deklaratat periodike vjetore të këtyre viteve nga ILDKPKI-ja:*

30.2.1. Trupi gjykues vlerëson të pabazuar pretendimin e subjektit se në vitin 2012 dhe në vitet 2013, 2014 dhe 2015, mosdeklarimi i detyrimit ndaj z. G. B., lidhet me faktin se sipas marrëveshjes verbale të tij me personin e lidhur, nëse nuk do të lejohej nga organet përkatëse vijimi i ndërtimit, personi i lidhur nuk do të kishte asnjë detyrim të tij, prandaj edhe investimi i parë u krye, pikërisht prej tij, me kushtin që do të ishte jo më shumë se 10.000.000 lekë, meqenëse ishte vënë në dijeni që do të investonte në një ndërtim pa leje, në një parcelë ndërtimore të disponuar prej shumë vitesh nga subjekti, por që një pjesë e saj ende nuk ishte regjistruar në pronësi të tyre. Veprimet e kryera nga personi i lidhur K.H. deri në qershor 2013, si investimi i shumës 207.400 euro në ndërtimin e karabinasë 5-katëshe dhe kolonave të katit të gjashtë të ndërtimit informal⁴³, lidhja e marrëveshjes private me investitorin S.T. si bashkëinvestor për përfundimin e ndërtimit të objektit 10-katësh, përcaktimet në këtë marrëveshje për ndarjen e sipërfaqes ndërtimore ndërmjet bashkëinvestitorëve, nuk dëshmojnë për pasiguri për realizimin e ndërtimit informal, jo vetëm prej subjektit dhe personit të lidhur, po ashtu edhe prej bashkëinvestitorit të angazhuar për vijimin e investimit deri në përfundimin e plotë të tij. Në referim të përmbajtjes së deklaratave të datës 14.01.2015 dhe të datës 20.01.2015, si edhe të deklaratës noteriale të datës 23.12.2019, z. G. B. nuk deklaroi se detyrimi i subjektit dhe personit të lidhur do të ishte 0 (zero) lekë në rast të prishjes/moslegalizimit së objektit, për rrjedhojë pretendimi i subjektit se kemi të bëjmë me *një rast të veçantë marrëveshjeje kleringu* rezulton të jetë i pambështetur edhe nga vetë z. G. B.. Trupi gjykues vlerëson të pabazuar edhe pretendimin e subjektit se në vitet 2013, 2014 dhe 2015 nuk ka pasur çfarë detyrimi të deklaronte, pasi marrëveshja ishte e hapur deri në përfundim të procesit të legalizimit e më pas do të bëheshin rakordimet e do të llogariteshin materialet e sjella. Referuar marrëveshjes së personit të lidhur me bashkëinvestitorin S.T. të datës 4.06.2013, vlera e investimit në ndërtimin informal, në periudhën shtator 2012-qershor 2013, përfshin në përlllogaritje të gjithë zërat e punimeve të ndërtimit deri në atë moment, pra edhe materialet e ndërtimit të sjella nga shtetasi G. B.. Në DIPP-të 2013, 2014 dhe 2015, deklarimi i marrëveshjes private prej subjektit nuk është shoqëruar me deklarim të detyrimit ndaj z. G. B., për rrjedhojë deklaratimet e subjektit janë të pasakta, në kuptim të përcaktimeve të ligjit nr. 9046/2003. Fakti që formulari i deklaratimit të detyrimeve kërkon

veprimet, të personit që ekzekuton veprimin, si dhe, në vartësi të organizimit të lëvizjeve të vlerave e të veprimeve financiare, tregimin dhe firmën e personit që merr në ngarkim vlerat materiale apo monetare”.

⁴³Shumë e deklaruar si investim i kryer nga personi i lidhur në marrëveshjen private të datës 4.6.2013 lidhur me bashkëinvestitorin S. T..

pasqyrimin e të dhënave të dokumentacionit justifikues ligjor nuk përbën shkak, që një detyrim i buruar nga një marrëveshje verbale e paformalizuar me akt të shkruar⁴⁴ të konsiderohet i përjashtuar nga detyrimi për deklaram.

30.2.2. Sipas deklaramëve të subjektit marrëveshja me G. B. ishte e hapur deri në përfundim të legalizimit të objektit 10-katësh, kohë kur do të kryheshin rakordimet për shlyerjen e vlerës së materialeve ndërtimore me sipërfaqe banimi, ndërsa objekti është legalizuar në datën 10.01.2016, prej subjektit shuma 68.260,31 euro është transferuar te shoqëria “{***}” ShPK, në datën 07.03.2017, me përshkrimin *kthim borxhi kundrejt G. B.*⁴⁵. Duke abstraguar nga deklarami i subjektit për shlyerjen e detyrimit me sipërfaqe ndërtimore, mbeten të paqarta arsyet e transferimit një vit pas përfundimit të legalizimit të shumës prej 68.260,31 eurosh, përderisa referuar deklaramëve të interesave private të viteve 2015 dhe 2016, subjekti ka deklaram të ardhura të përfituara nga shitje të apartamenteve në godinën 10-katëshe, në një vlerë më të madhe se detyrimi i pretenduar i pashlyer ndaj z. G. B.. Në këtë situatë faktike, përderisa mbetet e paprovuar me dokumentacion justifikues furnizimi me materiale ndërtimi nga shoqëria “{***}” ShPK, në vitet 2012-2013, trupi gjykues e vlerëson të pabazuar pretendimin e subjektit për të marrë në konsideratë investimin nga ana e kësaj shoqërie në ndërtimin infomal edhe për shkak të transferimit të shumës 68.260,31 euro te shoqëria “{***}” ShPK, të pretenduar si likuidim i detyrimit ndaj saj.

30.2.3. Mosdeklarami nga subjekti i rivlerësimi në deklaramat periodike vjetore 2012-2015 i detyrimit ndaj shtetasit G. B. [shoqërisë “{***}” ShPK], si dhe për sa nga hetimi administrativ subjekti nuk ka arritur të provojë që në vitet 2012-2013 shtetasi G. B. apo shoqëria “{***}” ShPK kanë dërguar në objektin informal materiale ndërtimi, trupi gjykues vlerëson se deklarami i subjektit, lidhur me burimin e krijimit të shumës 10.000.000 lekë në investimin e objektit informal, është i pasaktë dhe shkakton situatën e mungesës të burime të ligjshme të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur për të investuar në këtë vlerë në këtë objekt.

30.3. Në konkluzion të kësaj analize, Kolegji arrin në përfundimin se subjekti ka kryer deklaram të pasaktë në deklaramen e pasurisë *vetting* sepse dështoi të provonte furnizimin me materiale ndërtimi nga shoqëria “{***} ShPK”, në shumën 68.260,31 euro [10.000.000 lekë], në vitin 2012, në kundërshtim me parashikimin e nenit 33, pika 5, germa “a”, situatë e cila passjell mungesë të burimeve të ligjshme financiare, duke e kualifikuar si shkelje, sipas përcaktimit edhe të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

31. Lidhur me pretendimet me të cilat subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionin e Komisionit *se e ardhura në shumën 160.000 euro, e përfituar nga shitja e biznesit të personit të lidhur, nuk përmbush kriteret e pikës 3, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe, si e tillë, nuk merret në konsideratë nga Komisioni [nga e cila 139.139, 69 euro është investuar në ndërtimin informal], trupi gjykues analizon si vijon.*

31.1 Në deklaramen *vetting*, subjekti ka deklaram të ardhura nga shitja e investimit të realizuar me anë të aktmarrëveshjes për zgjidhjen e kontratës së qirasë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 5.6.2009, në shumën 160.000 euro⁴⁶. Në këtë aktmarrëveshje në nenin 4 të saj me titull “Vlera e

⁴⁴ Neni 80 i Kodit Civil përcakton: “Veprimi juridik mund të kryhet me shkrim, me gojë dhe me çdo lloj shfaqje tjetër të padyshimtë të vullnetit”.

⁴⁵ Sipas informacionit nga Banka e Tiranës, shkresa nr. {***} prot., datë 7.2.2019.

⁴⁶ Nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 06.06.2012, notere E. H., Dhoma e Noterisë Tiranë.

kontratës”, përcaktohet se palët⁴⁷ kanë rënë dakord që pala e tretë do t’i paguajnë palës së parë K.H. për efekt të zgjidhjes kontratës së qirasë nr.{***}, datë 05.06.2009, një vlerë prej 160.000 eurosh, e cila përfshin të gjithë investimin që pala e parë ka bërë në objektin ish-salla e lojërave të Qytetit Studenti, si dhe fitimin që pala e parë kishte parashikuar të realizonte në rast se kontrata e sipërcituar do të vazhdonte t’i shtrinte efektet për gjithë periudhën që ajo ishte lidhur. Subjekti pretendon se shprehja *fitim i munguar* ka mbetur e pakorrigjuar në tekstin e aktmarrëveshjes së hartuar paraprakisht te noterja me kërkesë të personit të lidhur [djalit të saj]. Sipas subjektit, për faktin se fitimi i munguar nuk vërtetohej, pala e tretë nuk pranoi të paguante një fitim aforfe për një periudhë rreth 7 vjet dhe, pas diskutimesh, në ditën e nënshkrimit të kontratës u ndryshua vetëm shuma nga 200.000 euro në 160.000 euro, duke mos ndryshuar tekstin e, për pasojë, mbeti në kontratë shprehja *fitim i munguar* [sipas subjektit shuma 200.000 euro, e pretenduar nga personi i lidhur, do të përfshinte investimin (që minimalisht ishte sa kredia në Alpha Bank)+këstet e paguara të kredisë deri në atë moment + një fitim të munguar minimalisht 350 euro/muaj.] Në përfundim, subjekti shprehet se vlera 160.000 euro është shumë më e vogël se investimi në rikonstrukcion e mobilim të dy zëra të patatueshëm për shkak të amortizimit në kohë dhe kjo shumë nuk përfshin asnjë euro *fitim të munguar*, për pasojë konkluzioni i Komisionit është i pabazuar.

31.1.1. Pretendimi i subjektit se shuma 160.000 euro nuk përfshin fitimin e munguar vlerësohet i pabazuar nga trupi gjykues, pasi, *së pari*, termi “fitim i munguar” theksohet në dispozitat që rregullojnë marrëdhënien mes palëve në kontratë dhe përcaktojnë detyrimet respektive⁴⁸, *së dyti*, referuar në nenin 10 të aktmarrëveshjes, përmbajtja e saj është lexuar për palët me zë të lartë nga noteri, palët kanë deklaruar se e kanë kuptuar përmbajtjen e saj, e gjejnë në përputhje të plotë me vullnetin e tyre dhe e kanë nënshkruar atë. Për rrjedhojë, përjashtohet mundësia që përcaktimet në këtë akt të jenë në kundërshtim me vullnetin e palëve, për sa ata kanë rënë dakord mes tyre dhe pretendimi i subjektit për mos korrigjime të termave në tekstin e marrëveshjes është i tejkaluar. Në DIPP-në 2012 subjekti ka deklaruar *shitje të investimit dhe biznesi “{***}”, në Qytetin Studenti, të djalit K. H.*, kontratë noteriale nr. {***} rep, nr. {***} kol., datë 6.6.2012, shuma 160.000 euro. Në vështrim të krahasuar të deklarimeve të subjektit për burimin e krijimit të shumës 160.000 euro, në deklaratën *vetting*, të aktmarrëveshjes së datës 06.06.2012, e cila përcakton edhe *fitimin e munguar*, në DIPP-në 2012, *shitje e investimit dhe biznesit*, është evidente se subjekti në deklarimet e saj nuk ka përjashtuar krijimin e kësaj të ardhure edhe nga fitimi i munguar. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit se shuma 160.000 euro nuk përfshin *fitimin e munguar* është i pabazuar.

⁴⁷ Në aktmarrëveshje, nenin 1 “Palët kontraktuese”, palë e dytë përcaktohen shtetasit që kanë fituar pronësinë e objektit me të drejtën e parablerjes së tij; pala e tretë përcaktohet F. P. dhe E. H..

⁴⁸ Në aktmarrëveshje përcaktohet, neni 1 “Pala e tretë F. P. dhe E. H. kanë lidhur me palët e dytë një kontratë premtim shitje pasurie të paluajtshme me objekt shitblerjen e “ish salla e lojërave të Qytetit Studenti, Tiranë”. Në këtë kontratë palët kanë rënë dakord që një pjesë e shitjes së pasurisë së paluajtshme pala e tretë do ta paguajë në favor të K. H., për efekt të zgjidhjes së kontratës së qirasë në këmbim të investimeve të kryera prej K. H. dhe fitimit që ky i fundit kishte parashikuar të realizonte në rast se kontrata e qirasë nr. {***}, datë 05.06.2009, do të vazhdonte të shtrinte efektet për të gjithë kohën që ajo ishte lidhur”; neni 2, objekti, “...palët bien dakord që për efekte të zgjidhjes së kontratës së qirasë nr. {***}, datë 05.06.2009, palës së parë t’i paguhet i gjithë investimi dhe fitimin që pala e parë kishte parashikuar të realizonte...”; neni 4, vlera e kontratës, “...palët bien dakord që pala e tretë do t’i paguajë palës së parë K. H. për efekt të zgjidhjes së kontratës së qirasë një vlerë prej 160 mijë euro.....kjo vlerë përfshin të gjithë investimin që pala e parë ka bërë në objektin...si dhe fitimin që pala e parë kishte parashikuar të realizonte...”.

32. Lidhur me pretendimin e subjektit se Komisioni pa asnjë fakt ka ndryshuar qëllimin e përdorimit të kredisë së marrë në “Alpha Bank”, nga rikonstruksion lokali që është deklaruar prej saj në DIPP-në 2007 e në vijim, në përdorim për rikonstruksion banese, trupi gjykues analizon si vijon.

32.1. Në deklaratën *vetting*, subjekti deklaroi se investimi në objektin e marrë me qira nga K.H. është realizuar nëpërmjet kredisë së marrë nga “Alpha Bank” me “Kontratën për kufi kredie shumëqëllimore nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 29.10.2007” dhe shtesës së kontratës nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 29.10.2007, në shumën 18.830.000 lekë, për një periudhë kohëzgjatjeje 15 vjet. Subjekti i rivlerësimit, në DIPP-në 2007, ka deklaruar kredinë e marrë nga “Alpha Bank”, shumën e saj dhe nuk ka deklaruar qëllimin për të cilën është marrë kjo kredi, si dhe nuk ka deklaruar shumën prej 13.174.850 lekësh të tërhequr këtë vit apo përdorimin e saj, *ndërsa në ankim prej saj pretendohet se me shumën e kredisë u bënë direkt pagesa, sipas investimeve të porositura përpara akordimit të saj apo të kryera për ambientin që po përgatitjes për biznes.*⁴⁹ Në DIPP-në 2008, në seksionin e detyrimeve, subjekti ka deklaruar kredinë për arsye rikonstruksioni të një ambienti të marrë me qira nga djali im K. H., me sipërfaqe rreth 280 m², pranë Qytetit Studenti. *Këstet e kredisë shlyhen nga personi i lidhur K. H. nga të ardhurat e lokalit.*⁵⁰ Nga dokumentacioni i administruar nuk rezulton asnjë e dhënë që të tregojë se ky objekt ishte zotëruar nga personi i lidhur K.H. përpara datës së lidhjes së kontratës së qirasë me METE në datën 05.06.2009.

32.1.1. Nga dokumentacioni i praktikës së kredisë së marrë në “Alpha Bank”, nuk rezultojnë të dhëna që qëllimi i kredisë të përfutur në vitin 2007 të ketë qenë për rikonstruksionin e ambientit ish-salla e lojërave e Qytetit Studenti, që personi i lidhur ka marrë me qira nga në vitin 2009, për biznes “{***}”. Konkretisht, në praktikën bankare: (i) në dokumentet e firmosur nga personi i lidhur, në kërkesën drejtuar “Alpha Bank”, datë 18.07.2007, përcaktohet *rikonstruksion shtëpie në Tiranë*, në formularin e aplikimit për kredi, datë 22.10.2007, përcaktohet *rikonstruksion/pajisje banese*; (ii) në memon e brendshme të strukturave të bankës pasqyrohet “*Formular aplikimi për hua shtëpie*”; (iii) në “Vendim për kufi kredie e huadhënie nr. {***}, datë 23.10.2007”, Komiteti i Kreditit, pas shqyrtimit të kërkesës së klientit [subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur] për *rikonstruksion godinë në Tiranë* dhe dokumentacionit përkatës, ka vendosur miratimin e një kufi kredie/huaje për *financimin e projektit rikonstruksion godine pranë ish-bllokut të {***}, me kosto të përgjithshme projekti 250.000 euro, kontribut të kredimarrësit në financimin e projektit 100.000 euro, kontribut i bankës në financimin e projektit 150.000 euro*; (iv) në kontratën e huas⁵¹, në pikën

⁴⁹Në formularin “*deklarimi i interesave private, pasuritë e paluajtshme, pasuritë e luajtshme*” përcaktohet “*përshkruani hollësisht ndryshimet (shtesa dhe pakësime) në llojin, sipërfaqen, adresën ku ndodhen, momentin e kryerjes së veprimit, vlerën në lekë apo valutë që pasqyrohet në dokumentacionin që dispononi, në mungesë të dokumenteve vlerën që keni shtuar apo pakësuar, pjesën takuese të çdo lloj pasurie që zotëroni, të paluajtshme dhe të luajtshme, të regjistruar ose jo në regjistrat publikë...*”.

⁵⁰ Subjekti për kredinë e marrë nga “Alpha Bank” ka deklaruar: në DIPP-në 2009: në seksionin e të ardhurave dhe angazhimeve në veprimtari publike dhe/ose private - ambient të marrë me qira në Qytet Studenti, Tiranë nga personi i lidhur/K. H. me kontratën nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 5.6.2009, nga METE, me afat 10-vjeçar, aktualisht funksionon si bar-kafe, pa deklaruar vlerën e të ardhurave të përfuturara; në seksionin e detyrimeve financiare deklaroi se vlera e investuar në këtë ambient është kredia në shumën 19.000.000 lekë, marrë në “Alpha Bank”, në datën 29.10.2007; në DIPP-në 2010 deklaroi kredi e marrë nga djali për investim të lokalit me qira në Qytetin Studenti, pa deklaruar të ardhura të përfuturara nga ushtrimi i aktivitetit; në DIPP-në 2011, kredi e marrë nga “Alpha Bank”; DIPP-të 2012-2015, kredi e marrë pranë “Alpha Bank”, për arsye rikonstruksioni të një ambienti të marrë me qira nga djali në Qytetin Studenti; në DIPP-në 2016, kredi e marrë nga “Alpha Bank”.

⁵¹ Nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 29.10.2007; Kontratë Huaje nr. {***}, datë 26.10.2007, shtesë e Kontratës për Kufi Kredi Shumëqëllimore nr. {***}, datë 26.10.2007.

2, “Projekti dhe financimi i tij”, përcaktohet se *kredimarrësi ka paraqitur në bankë projektin rikonstruksion godine; projekti ka kosto të përgjithshme prej 250.000 eurosh; kontributi i kredimarrësit në financimin e projektit është 100.000 euro ose 40% e koston së përgjithshme të projektit; pjesa tjetër e koston së përgjithshme të projektit prej 18.830.000 lekësh ose 60 % e tij është kërkuar të financohet nga banka dhe banka ka pranuar të financojë këtë shumë në këtë projekt; (v) në kërkesën drejtuar “Alpha Bank”, nënshkruar nga personi i lidhur dhe subjekti i rivlerësimit, njoftohet banka për tërheqjen prej tyre të shumës 150.000 euro, e cila do të aplikohet për rikonstruksion godine; (vi) në “Situacion; Objekti: banesa e z. K. H.”,⁵² përshkrimi i punimeve i klasifikon zërat e listuar në tri nënndarje:(1) punime ndërtimi; (2) sistem kondicionimi; (3) punime territori, me vlerat përkatëse për çdo zë dhe totali i shumës përlllogarit 266.104,52 euro. Pretendimet e subjektit se *banka, pas besimit që krijon tek klienti, plotëson një dosje sipas kushteve të tyre, duke filluar nga formularët tip, por edhe të disa dokumenteve të dosjes të cilët i ka marrë përsipër t’i plotësojë me specialistët që punojnë të pavarur për të, për sa i përket situacionit të punimeve, zërave të punimeve dhe preventivat përkatës për punime ndërtimore e mobilim dhe unë jam vënë në dijeni të tyre nga ILDKPKI-ja pas disa vitësh, pas një takimi zyrtar me ta, është në kundërshtim me dokumentacionin e administruar në praktikën e kredisë, i cili provon se banka ka shqyrtuar kërkesa për kredi të subjektit dhe personit të lidhur, sipas qëllimit dhe dokumentacionit të paraqitur prej tyre. Nga vetë emërtesa e dokumentit teknik “Situacion; Objekti: banesa e z. K. H.”, totalit të shumës së punimeve, që përkon me vlerën e projektit, 60% të së cilit është investuar nga banka, zërat e punimeve, ku shumica e tyre nuk përkojnë me punime për përshtatjen si “{***}” të një ambient të ndodhur në katin e dytë të godinës, si: *kangjella metalike+portë kryesore, ndërtim+suvatime muri rrethues, shtresë betoni territor+ bordura+pllaka+trotuar; ndriçues pishine, bar artificial, palma pishine, mobilim pishine (bari, kondra bari, stola, tavolina, karrige, shezlona, çadra), dhoma gjumi, fëmije dhe çifti, etj., vendndodhjes së godinës pranë {***}, e cila përkon me adresën e banesës së subjektit, pretendimi i subjektit, se pavarësisht termit *godinë* në kontratën e huas nr. {***}, datë 29.10.2007, në të nuk specifikohet se bëhet fjalë për shtëpinë e saj të banimit, vlerësohet nga trupi gjykues i pambështetur në faktet e rezultuara nga aktet e cituara më lart.***

32.2. Në kontratën e qirasë nr. {***}, datë 05.06.2009, lidhur mes djalit të subjektit dhe METE⁵³, përcaktohet si qëllimi i saj *dhënia me gëzim të përkohshëm e objektit për ushtrim aktiviteti në fushën e shërbimeve tregtare dhe ngritjen e Bar “{***}”*; në nenin 4 “Të drejtat dhe detyrimet e qiradhënësit”, në pikën 4.1. përcaktohet se *qiradhënësi, nëpërmjet administratës së. “Trajtimi i Studentëve Nr. {***} Tiranë”, ShA, si njësi që ka në administrim objektin, dorëzon pronën e përcaktuar në pikën 1.1. të kësaj kontrate, të lirë për t’u shfrytëzuar për qëllimin e kësaj kontrate. Në momentin e dorëzimit do të hartohet procesverbali i objektit që jepet me qira, i cili është pjesë përbërëse e kontratës. Referuar procesverbalit “Për dorëzimin e objektit të dhënë me qira”⁵⁴,*

⁵² Përpiluar nga preventivuese A. H., licence nr. {***}.

⁵³ Shkresa nr. {***} prot., datë 27.01.2020, e MFE -së, me të cilën është përcjellë në Komision dokumentacioni përkatës në përgjigje të kërkesës së Komisionit për vënien në dispozicion të gjithë akteve dhe korrespondencës së mbajtur mes Drejtorisë së Administrimit të Pronës Publike dhe shtetasit K.H., person fizik i regjistruar me NIPT {***}.

⁵⁴ Procesverbali është hartuar bazuar në ligjin nr. 7638/1992, “Për shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, VKM-në nr. 1712, datë 24.12.2008, “Për dhënien me qira ose emfiteozë të pasurive shtetërore”, në Urdhrin nr. 168, datë 24.07.2008, të Drejtorit të N.T.S.Nr. {***}, ShA.

mbajtur në datën 8.06.2009, të nënshkruar nga K.H. dhe nga anëtarët e Komisionit [ing. D. L., Sh. Q., L. M.], përcaktohet se *gjendja aktuale në momentin e marrjes në dorëzim të objektit nga qiradhënësi është në kushte normale teknike dhe shfrytëzuese*. Në vlerësim të përmbajtjes së këtyre akteve, rezulton se objekti është dorëzuar te qiramarrësi pas lidhjes së kontratës së qirasë, si dhe nuk figuron asnjë e dhënë që ky ambient të jetë poseduar prej personit të lidhur përpara lidhjes së kontratës së qirasë apo që të jetë investuar përpara këtij momenti për kryerjen e punimeve, për shkak të gjendjes së amortizuar të këtij ambienti.

32.3. Subjekti i rivlerësimit pretendon se personit të lidhur [djali], në bisedë informale me sektorin që mbulonte dhënien me qira të ambienteve pronë shtetërore të ish-METE [aktualisht MFE], verbalisht i është rekomanduar që të dakordësonte me Drejtorinë e Qytetit Studenti për të marrë në përdorim ndonjë prej ambienteve të godinës së ish-mensës së Qytetit Studenti, shkatërruar pas ngjarjeve të vitit 1997, e pa rikonstruktuar në një pjesë të konsiderueshme, me kushtin që pas përfundimit të investimit në të ta vinte në shfrytëzim vetëm pas lidhjes së një kontrate qiraje me METE-n. Sipas subjektit, në bazë të këtij rekomandimi, në bisedime me Drejtorinë e Qytetit Studenti u pa ambienti me sipërfaqe 306,5 m² (ish-salla e lojërave), për të cilin nga Bashkia Tiranë u bë *genplani* që mban datën 27.07.2007 dhe pas përcaktimit të zërave të punimeve që do të nevojiteshin për ta kthyer ambientin në gjendje pune⁵⁵, si dhe vlerës paraprake të investimit që do të nevojitej, personi i lidhur [djali] negocioi me “Alpha Bank” për të mbuluar një pjesë të investimit. Lidhur me këtë pretendim, trupi gjykues analizon si në vijim.

32.3.1. Pretendimi i subjektit se punimet në ambient kishin filluar nga mesi i vitit 2007 dhe deri në datën 05.06.2009, që është lidhur kontrata e qirasë me ish-METE-n dhe personi i lidhur të ketë pasur në dispozicion një objekt shtetëror për të kryer punime për përshtatjen e tij për qëllime biznesi, bazuar në *rekomandime apo bisedime*, konstatohet se vjen në kundërshtim me përcaktimet e VKM-së nr. 1712, datë 24.12.2008, “Për dhënien me qira ose enfiteozë të pasurive shtetërore”⁵⁶.

32.3.2. Lidhur me pretendimin e subjektit se dokumenti “Genplan për dhënie me qira, objekti, lokal në Qytetin Studenti”, i cili mban datën 27.07.2007, provon rikonstruktionin/përdorimin e ambientit në funksion të vënies së tij në gjendje pune, duke qenë se ky dokument teknik: (i) nuk ka asnjë të dhënë që është përpiluar nga institucionet përkatëse në funksion të procedurave për dhënien me qira të ambientit; (ii) nuk ka në të dhëna që lidhin përpilimin e tij me personin e lidhur; (iii) nuk është pjesë integrale e kontratës së qiradhënies lidhur me METE apo i referuar/përmendur në kontratë, vlerësohet nga trupi gjykues si një pretendim i pabazuar i subjektit, lidhur me vlerën

⁵⁵ Subjekti pretendon që ambienti të mund të bëhej gati për t’u shfrytëzuar i nevojiteshin shkallë komunikimi me katin përdhe, punime për rikonstruktion të brendshëm dhe të fasadës së jashtme [ndërtim i mureve të jashtme dhe atyre ndarës], suvatime, patinime, shtrim nivelim e veshje me pllaka e parket të dyshemesë, punime tavanore gips e mure ndarës karton-xhes, shtrim rrjeti të ri të ujit të pijshëm, rrjetit elektrik, tubacion e linja të shkarkimeve, vetrata dopio xham e dyer dru/duralumin, pajisje hidrosanitare, ndriçim anësor e tavanor, ndriçim artistik, sistem aspirim-kondicionimi, mobilim, kolltukë, karrige, tavolina, televizorë, abazhure, gota, filxhanë, aksesorë të ndryshëm të domosdoshëm.

⁵⁶ VKM-ja në pikën 3 parashikon se: [...] kriteret e konkurrimit në dhënien me qira të pasurisë shtetërore janë: Niveli i investimit, niveli i punësimit dhe tarifa e qirasë mujore. Më tej, referuar kreut II, pikat 3 dhe 4, përcaktohet se: “Njoftimi për botim për dhënien me qira ose enfiteozë të objektit, shpallet 2 herë në Buletinin e Njoftimeve Publike dhe përmban të dhënat për objektin, kategorizimin e veprimtarisë, pikët vlerësuese për elementet e konkurrimit, dokumentacionin, që duhet të paraqesin konkurrentët, si dhe vendin, datën e orën e paraqitjes së dokumentacionit. Data e konkurrimit të jetë jo më parë se 7 ditë kalendarike nga data e botimit të fundit. Dokumentacioni për marrjen me qira, që paraqesin konkurrentët, i dorëzohet komisionit dhe përmban: (a) kërkesën e subjektit për marrjen me qira të objektit; (b) planbiznesin e hollësishëm për vënien në funksionim të objektit, ku të përshkruhen qartë plani i punësimit, plani i investimeve dhe treguesit, që do të realizohen [...]”.

provuese të këtij dokumenti për komunikimin me institucionet shtetërore që kanë pasur në administrim këtë pronë publike para marrjes së saj me qira nga personi i lidhur.

32.3.3. Aktmarrëveshja për zgjidhjen e kontratës së qirasë për ambientin “ish-salla e lojërave të Qytetit Studenti”, në nenin 8 me titull “Dorëzimi i objektit”, përcakton se palët bien dakord që për dorëzimin e objektit do të mbahet një procesverbal, i cili do të pasqyrojë gjendjen e objektit në datën e dorëzimit, inventarin e sendeve që ndodhen në objekt, dorëzimin e çelësave të objektit, librezave të ujit dhe energjisë elektrike, si dhe çdo detaj tjetër që lidhet me objektin. Si pjesë integrale e aktmarrëveshjes, në “{***}, Inventar asetesh, datë 05.06.2012”, i vulosur me vulë të noteres, listohen pajisje të ndryshme [teknike, elektroteknike, elektroshtëpiake, dhe mobilierie], përcaktohen sasia/numri i copëve për secilin lloj, pa përcaktuar çmimet përkatëse apo vlera në total në dy kolonat “çmimi” dhe “vlera”. Në këtë inventar, ku sipas përcaktimit kontraktual do të pasqyrohej çdo detaj që ka lidhje me objektin, nuk rezulton të jenë përfshirë zëra punimesh të pretenduar nga subjekti se janë kryer për rikonstruksionin e tij *si: prishje e rifiniturës ekzistuese [e shkatërruar dhe amortizuar], ndërtim të shkallëve, të mureve të fasadës dhe atyre ndarëse, suvatime, punime gipsi, lysterje, nivelim të dyshemesë, sistem kondicionimi, aspirimi, ndriçimi, rrjeti i ujit të pijshëm*, të cilat, sipas subjektit janë investime për shkak të të cilave vlera e objektit pësoi rritje. Sipas parashikimit të nenit 817 të Kodit Civil, nëse qiramarrësi ka bërë shtesa në sendin e marrë me qira ka të drejtë t’i heqë ato në mbarim të qirasë, kur kjo mund të kryhet pa dëmtuar sendin, përveç kur pronari pranon t’i mbajë vetë ato dhe kompenson qiramarrësin. Mospërfshirja në inventar e punimeve ndërtimore që për natyrën e tyre trupëzohen me godinën, qoftë edhe si total i vlerës e tyre, nuk vjen as në interes të qiramarrësit [personit të lidhur], i cili në kushtet e zgjidhjes para afatit të kontratës së qirasë pretendonte shlyerjen e vlerës së investimit dhe në as në interes të pronarit të ri për shmangien e pretendimeve të mëvonshme nga ish-qiramarrësi lidhur me to. Bazuar edhe në këtë dokument, trupi gjykues vlerëson të pabazuar pretendimin e subjektit se vlera 160.000 euro është përfituar edhe për investimet për punime rikonstruksioni të ambientit të marrë me qira nga personi i lidhur, K.H..

33. Për gjithë sa analizuar më sipër, në konkluzion, Kolegji arriti në përfundimin se subjekti nuk ka arritur të provojë se shuma 160.000 euro, përfituar nga shitja e biznesit “{***}” të personit të lidhur, përfaqësonte investimin e kryer në këtë objekt prej djalit të saj dhe se në të nuk përfshihej vlera e fitimit të munguar nga prishja përpara afatit të kontratës së qirasë. Si pasojë, në kushtet kur për shumën 160.000 euro nuk janë paguar detyrimet tatimore, ajo u konsiderua e gjitha si një e ardhur e re e subjekti të rivlerësimit, e cila nuk plotësonte kriteret e përcaktuara në Nenin D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenin 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016, për t’u konsideruar si e ardhur e ligjshme. Mospërfshirja e kësaj shume si burim i ligjshëm, për financimin e ndërtimit të objektit karabina 5 kate, e vendosi subjektin e rivlerësimit në kushtet e përcaktuara nga neni 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016. Trupi gjykues vlerëson se subjekti gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme financiare për kryerjen e investimit në vlerën prej 139.139,69 eurosh, për ndërtimin e objektit 10-katësh, si dhe për të përballuar shpenzimet e tjera për periudhën 2012-2013, në vlerën prej 34.924.070 lekësh.
34. Konkluzionin e Komisionit se *në lidhje me shumën e investuar nga personi tjetër i lidhur, S.T., subjekti i rivlerësimit nuk provoi me dokumentacion ligjor justifikues ligjshmërinë e burimit dhe ligjshmërinë e të ardhurave të personit tjetër të lidhur*, subjekti i rivlerësimit e kundërshton me pretendimin se: (1) z. S.T. është vetëm investitor në ndërtimin e godinës; (2) pas lidhjes së marrëveshjes private mes djalit të saj dhe z. S.T. në vitin 2012, prej tyre nuk është kryer asnjë investim në godinë; (3) megjithëse pa detyrim për të verifikuar dhe paraqitur dokumentacion ligjor

për të ardhurat e z. S.T. ka arritur të sigurojë 8 kontrata porosie të lidhura mes tij dhe blerësve të sipërfaqeve ndërtimore në pallat, të cilat vërtetojnë pohimin e z. S.T.⁵⁷se investimi i tij kishte bazë edhe të ardhurat nga shitja me këto kontrata. Trupi gjykues, për këto pretendime të subjektit, shqyrtoi dhe vlerësoi rrethanat e faktit të rezultuara nga hetimi sa i përket bashkëinvestimit në ndërtimin e objektit 10-katësh ndërlidhur me konkluzionet e Komisionit në këndvështrim të dispozitave ligjore që rregullojnë statusin e personave të tjerë të lidhur.

34.1. Komisioni e ka konsideruar z. S.T. person tjetër të lidhur me subjektin, sipas pikës 14, të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, duke vlerësuar se marrëdhënia e tyre rrjedh nga një interes pasuror dhe marrëdhënie biznesi siç është marrëveshja private e vitit 2013, shtesa e marrëveshjes private në vitin 2014 dhe kontrata e shkëmbimit në vitin 2016, me palë shkëmbyese pronarët e [subjekti i rivlerësimit dhe tre fëmijët e saj] dhe palë shkëmbyese investitore z. S.T..

34.1.1. Në marrëveshjen private të lidhur në datën 4.6.2013, mes K.H. dhe S.T., palët kanë përcaktuar për rregullimin e marrëdhënies, të drejtave dhe detyrimeve në cilësinë e bashkëinvestitorëve të objektit me 10 kate [objekti i ndërtuar nga K.H. në fazën e karabinasë, në katin e 5-të teknik dhe kolonat e betonuara mbi këtë kat]. Në këtë aktmarrëveshje, në nenin 4 të saj, palët kanë rënë dakord dhe kanë miratuar paraprakisht ndarjen e sipërfaqeve që do të përfitojnë, duke bërë pjesë të pandarë të kontratës tabelën me pasqyrimet dhe planimetrinë. Referuar dokumentit “Kontratë formimi të shoqërisë së thjeshtë”, të nënshkruar nga K.H. dhe S.T. në nenin “Kontributet”, përcaktohet kontributi i tyre në investim 50% me 50%, si dhe përcaktohet ndarja e pjesëve takuese të palëve në kate, në zbatim të parimit të shpërndarjes vertikale dhe horizontale në proporcion të drejtë me raportin e përfitimit, mënyra si do të bëhet caktimi i pjesës takuese [e cila përfshin komunikimin me shkrim mes palëve në rast të mosparaqitjes në afat për të vendosur caktimin proporcional të pjesëve takuese]. Kushtet e kontratës dëshmojnë për rregullimin paraprak të marrëdhënies së personit të lidhur [djalit] me S.T. me përcaktime të qarta sa i përket investimit dhe ndarjes së pjesëve takuese [kontrata ka pjesë të saj tabelën me ndarjen paraprake të sipërfaqeve takuese të godinës për palët kontraktore]. Me shtesën e marrëveshjes private nr. {***}rep., nr. {***} kol., datë 10.09.2014, përcaktohet se në kushtet kur S.T. ka përfunduar procesin e ndërtimit të godinës 10-katëshe, sipas parashikimit të marrëveshjes dhe pala tjetër [subjekti dhe tre fëmijët e saj] po ndërmarrin hapat finalë të procedurës së legalizimit të objektit në tërësi, bien dakord për ndarjen e pjesëve takuese në objektin ndërtimor të krijuar, sipas parashikimeve të nenit 4 të marrëveshjes. Gjithashtu, në këtë marrëveshje shtesë, me qëllim arritjen e barazisë në përfitim, sipas parashikimeve dhe parimeve të marrëveshjes së vitit 2013, përcaktohen kompensime me sipërfaqe shtesë për kontribute të secilës prej palëve, njohur prej tjetrës. Pas pajisjes me leje legalizimi të ndërtimit informal në datën 10.01.2016, në emër të subjektit të rivlerësimit dhe tre fëmijëve të saj, regjistrimit të objektit në ZVRPP-në Tiranë, referuar kontratës së shkëmbimit⁵⁸, palët në kontratë, personi i lidhur dhe S.T., në bazë të akteve noteriale të vitit 2014, kanë përcaktuar përfundimisht për shkëmbimin e marrjen në dorëzim të pronave të përcaktuara në këtë kontratë dhe kanë garantuar se me nënshkrimin e kontratës nuk do të kenë asnjë lloj pretendimi të tashëm apo të ardhshëm, në lidhje me sipërfaqet e tjera takuese, duke qenë të vetmet dhe përfundimtare për marrëdhënien e shkëmbimit objekt kontrate lidhur mes tyre.

⁵⁷ Subjekti ka paraqitur në Komision, në përmbushje të barrës së provës deklaraten noteriale të z. S. T., nr. {***}, datë 26.12.2019, notere M. D., Dhoma e Noterisë Tiranë.

⁵⁸ Nr. {***}, datë 25.04.2016, notere M. D., Dhoma e Noterisë Tiranë.

34.1.2. Trupi gjykues, në analizën që i bën situatës faktike, lidhur me kualifikimin ligjor të statusit të bashkëinvestitorit S.T. në ndërtimin e objektit informal 10 kate, për llogari të procesit të rivlerësimit, mban në konsideratë trajtimin ligjor të kryer prej Kolegjit në rastet precedentë, sipas të cilit, kur nga hetimi administrativ nuk rezulton asnjë gjetje mbi bazën e së cilës të mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për fshehje nga ana e subjektit të rivlerësimit të pasurisë së tij në emër të këtyre bashkëinvestitorëve, kualifikimi si persona të tjerë të lidhur i bashkëinvestitorëve nuk është i bazuar në ligj⁵⁹. Nga aktet e administruara në fashikuj provohet: (i) për një marrëdhënie bashkëinvestimi të rregulluar e të formalizuar me akte të shkruara qysh në pikënisje të saj, ku është përcaktuar qartë vlera e investimit e secilit prej bashkëinvestitorëve dhe ndarja paraprake e sipërfaqeve ndërtimore në raport proporcional me vlerën e investimit; (ii) për caktimit përfundimtar të pjesëve takuese, sipas parashikimeve në aktet noteriale të nënshkruara nga palët, dhe pa të drejtë për pretendime të mëvonshme prej tyre; (iii) bashkëinvestitori S.T. ka investuar në objekt, ka përfituar në përputhje me investimin pjesën e tij takuese, pa kaluar ndonjë e drejtë te subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues vlerëson se situata faktike nuk mund të kualifikohet nën parashikimin e nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 dhe z. S.T. nuk konsiderohet si person tjetër i lidhur, për të cilin lind detyrimi i subjektit për justifikimin e burimeve të ligjshme të pasurisë së tij. Në këto kushte, Kolegji e gjen të drejtë shkakun e ankimit që lidhet me këtë konkluzion të Komisionit.

35. Subjekti i rivlerësimit, për pasurinë njësi me sipërfaqe 67.5 m², në “{***}”, Tiranë, kundërshtoi si të pambështetur në ligj dhe në provat e administruara konkluzionin e Komisionit se *ka mospërputhje ndërmjet deklaratës vetting dhe deklaratës periodike vjetore 2003, lidhur me burimin e krijimit të pasurisë; subjekti nuk ka shpjeguar bindshëm mospërputhjet që ekzistojnë për vlerën e paguar mes kontratës së shitjes me vlerë 1.700.000 lekë dhe kontratës së sipërmarrjes me vlerë blerje 125.000 USD, duke pretenduar se: (i) kontrata e sipërmarrjes e përpiluar me shoqërinë “{***}” ShPK, ishte kontratë TIP në të cilën bëheshin shënime dore nga punonjësit e shoqërisë, dhe se ajo u plotësua vetëm formalisht për rezervim të njësisë; (ii) në llogarinë e firmës “{***}” ShPK⁶⁰, prej saj nuk është depozituar asnjë vlerë, sikundër është shënuar në kontratë; (iii) me shoqërinë “{***}” ShPK, nuk ka asnjë kontratë shitblerje të finalizuar pranë ndonjë zyre noteriale dhe asnjë të tillë të regjistruar pranë ZVRPP-së Tiranë; (iv) shuma e blerjes së njësisë, sipas kontratës së shitjes lidhur me z. A.U., është siguruar nga shitja e apartamentit në bulevardin “{***}”. Trupi gjykues, për këto pretendime të subjektit, shqyrtoi dhe vlerësoi faktet e rezultuara nga hetimi administrativ ndërlidhur me konkluzionet e Komisionit, në këndvështrim të dispozitave ligjore që rregullojnë me fitimin e pronësisë, deklaramit të saj, si dhe burimeve të krijimit.*

35.1. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pronësinë mbi njësinë (lokal), me sip. 67,5 m², në katin përdhe të godinës 11-katëshe, në “{***}”, Tiranë, përfituar me kontratë shitblerje nr. {***}, datë 2.10.2003. *Burimi i fondeve:* të ardhura nga shitja e apartamentit në datën 15.03.2002, nr. {***}, i cili është përfituar me kontratë huaje nr. {***}, datë 31.10.2000, me huadhënës Dega e Bankës së Kursimeve Tiranë, e cila është shlyer. Vlera: 1.700.000 lekë. Pjesa takuese: 100 %. Në DIPP-në 2003, subjekti e deklaroi këtë pasuri me burim krijimi “dhuruar nga kunati”. Për mospërputhjen e deklarimeve, si gjatë hetimit administrativ, ashtu edhe në ankim, subjekti ka shpjeguar se kunati, R. H., bashkëinvestitor në pallatin në bulevardin “{***}”, me

⁵⁹ Shih vendimin (JR) nr. 14, datë 15.06.2021, të Kolegjit.

⁶⁰ Nr. llogarisë{***}, pranë Bankës Amerikane të Shqipërisë. Subjekti ka përfshirë në oponentin e datës 05.06.2020, statement bankar për këtë numër llogarie për periudhën 01.07.2001 (para datës së kontratës së sipërmarrjes) deri në 31.12.2003 (pas datës së kontratës së shitjes).

lindjen e djalit të vogël të subjektit, ka shprehur dëshirën për t'i dhuruar asaj një nga apartamentet në pronësi të tij. Meqenëse kredia nga Banka e Kursimeve akordohej vetëm për blerje banese, për tërheqjen e kredisë u lidh kontrata e shitjes {***}, datë 11.09.2000. Shumën e kredisë kunati e kaloi për rikonstruksion të shtëpisë [vilës] duke e konsideruar apartamentin dhurim ashtu siç kishte premtuar. Në bisedime me shoqërinë “{***}” ShPK, për të porositur një njësi [dyqan] në pallatin që po ndërtohej kjo shoqëri në {***}, u plotësua një kontratë sipërmarrje TIP e tyre në disa rubrika, ndërmjet tyre edhe vlera, por, siç vërtetohet nga statement e Bankës Amerikane [në kontratën e sipërmarrjes përcaktohet numri i llogarisë së shoqërisë pranë kësaj banke] prej subjektit nuk është bërë asnjë pagesë për periudhën 01.07.2001-31.10.2003 [periudhë që përkon përpara datës së kontratës së sipërmarrjes deri pas datës së lidhjes së kontratës së shitjes]. Më pas, në respekt të figurës së bashkëshortit të ndjerë të subjektit, kjo njësi iu shit subjektit nga z. A. U. në vlerën 1.7 milion lekë [kosto+shpenzime administrative], vlerë të cilën ajo nuk e dispononte, por e siguroi nga shitja e apartamentit të ndodhur në bulevardin “{***}”, duke dakordësuar me kunatin që nga shitja do të merrte vetëm vlerën e blerjes së njësisë plus shpenzimet administrative që shkonte rreth 2 milion lekë. Subjekti shpjegon se kjo është arsyeja pse në DIPP-në 2003 burimi i krijimit të pasurisë, njësi me sipërfaqe 67,5 m², në “{***}”, është shënuar “dhurim nga kunati”, ku në kolonën vijuese “të ardhura vjetore” është pasqyruar shuma 10.800 USD, e cila nuk është dhurim nga kunati, por i referohet të ardhurave vjetore nga njësia e dhënë me qira mujore 900 USD/muaj.

35.2. Mospërputhja e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, lidhur me burimin e krijimit të pasurisë njësisë/lokal, në deklaratën *vetting* - të ardhura nga shitja e apartamentit të përfituar me kontratë huaje në vitin 2002, me ato të DIPP e vitit 2003 - dhuruar nga kunati, nuk janë shpjeguar bindshëm prej saj në ankim, shpjegime të cilat janë të njëjta me ato të dhëna gjatë hetimit administrativ. Trupi gjykues konstaton se deklarimi i subjektit të rivlerësimit se kontrata e shitjes së apartamentit në bulevardin “{***}” u realizua vetëm në funksion të përfitimit të kredisë, jo vetëm që nuk është arritur të provohet prej saj, por dëshmon se: (i) kontrata e shitjes përmban elemente të fiktivitetit, referuar germës “ç”, të nenit 92 të Kodit Civil; (ii) subjekti të ketë kryer veprimeve juridike në mashtrim të ligjit, përderisa në kërkesën drejtuar Bankës së Kursimeve ka deklaruar se familjarisht dhe personalisht nuk zotëron banesë të përfituar nga procesi i privatizimit të banesave, ndërkohë që zotëronte një të tillë qysh në vitin 1995.

35.3. Referuar kontratës së sipërmarrjes, datë 20.07.2001, lidhur mes shoqërisë “{***}” ShPK, [sipërmarrësi] dhe subjektit të rivlerësimit [porositësi], porositësi merr përsipër t'i paguajë sipërmarrësit shumën 125.000 USD që përfaqëson vlerën e lokalit nr.{***}, në katin përdhe në planimetri dhe detyrohet që me nënshkrimin e kontratës, kur objekti të jetë në fazën e ndërtimit karabina konstruksion beton arme, të derdhë në llogarinë bankare të sipërmarrësit me nr. {***}, në Bankën Amerikane të Shqipërisë, shumën 50.000 USD, kurse diferencën brenda datës 30.06.2002 dhe mosrespektimi i afatit me korrektësi nga porositësi, i jep të drejtë sipërmarrësit të prishë në mënyrë të njëanshme kontratën. Kontrata e sipërmarrjes i ka shërbyer subjektit të rivlerësimit si dokumentacion ligjor për të lidhur kontratën me nr.{***}, datë 04.08.2003, për dhënie me qira të njësisë për një afat 5-vjeçar, duke dëshmuar për mundësinë e subjektit për të disponuar pa pengesa njësinë, për të cilën rreth dy muaj më vonë do të fitonte pronësinë me kontratën e shitblerjes. Sipas përmbajtjes së kontratës së qirasë rezulton se qiradhënësja [subjekti i rivlerësimit] ka deklaruar përpara noterës se ka lidhur me shoqërinë “{***}” ShPK, kontratën e sipërmarrjes në datën 20.07.2001, për blerjen e lokalit, në katin përdhe të pallatit që po ndërton kjo shoqëri dhe se pallati ka përfunduar së ndërtuari, por nga ana e shoqërisë nuk janë përfunduar veprimet përkatëse në ZVRPP-në Tiranë për ta kaluar në pronësi, me qëllim që t'i lindë e drejta për të përfunduar së bashku kontratën e shitblerjes dhe kalimin e pronësisë së lokalit të sipër

përshkruar. Për më tepër, në kontratën e qirasë, përcaktohet se *për sa i përket shpenzimeve të bëra nga qiramarrësi A.V., në shumën 150.000 lekë palët kanë rënë dakord që ato do të likuidohen nga qiradhënësja nëpërmjet qirasë mujore*, përcaktim i cili dëshmon se njësia është disponuar qetësisht prej subjektit përpara nënshkrimit të kontratës së qirasë, duke pasur mundësinë për të kryer punime në të.

35.4. Kontrata e shitjes së kësaj njësie, datë 02.10.2003, është lidhur mes subjektit dhe z. A. U., përfaqësuar me prokurë nga z. I. C.. Sipas vërtetimit nga dokumenti hipotekor [bashkëlidhur kontratës], njësia figuron e regjistruar në pronësi të z. A. U. me nr. hipoteke {***}, datë 30.12.1997. Subjekti nuk ka dhënë shpjegime: (i) për faktin që ka disponuar lirisht njësinë duke e dhënë atë me qira, sipas pretendimit të saj pa kryer asnjë pagesë që më së paku do të jepte garanci për shoqërinë “{***}” ShPK, si dëshmi e interesit dhe qëllimit të subjektit për blerjen e kësaj njësie; (ii) se përse në lidhjen e kontratës së qirasë është cituar pretendimi i saj që pengesë për realizimin e kontratës së shitjes së njësisë është kryerja e veprimeve nga shoqëria “{***}” SHPK, në ZVRPP-në Tiranë, ndërkohë që provohet se njësia ishte e regjistruar në pronësi të z. A. U. përpara se subjekti të nënshkruante kontratën e sipërmarrjes. Në vijim, në dokumentacionin e kredisë bankare të “Alpha Bank” është administruar një raport vlerësimi për këtë njësi, që mban datën 30.10.2007, nga ku rezulton se vlera e tregut të pronës në datën e vlerësimit ka qenë 230.000 euro. Në këtë situatë faktike, trupi gjykues vlerëson të paprovuar dhe jo bindës pretendimin e subjektit se pas nënshkrimit të kontratës së sipërmarrjes, prej saj nuk është kryer asnjë pagesë për shoqërinë “{***}” ShPK.

35.5. Lidhur me apartamentin në blv. “{***}”, të ardhurat nga shitja e të cilit subjekti i deklaroi burim për krijimin e pasurisë njësi me sipërfaqe 67 m², subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionin e Komisionit *se nuk ka deklaruar saktë çmimin e shitjes së këtij apartamenti, duke shmangur detyrimet tatimore mbi vlerën reale të këtij apartamenti*, duke pretenduar se nuk ka shmangur detyrimet tatimore, pasi nga shitja e tij ka marrë vetëm 2.000.000 lekë që kanë shërbyer për blerjen e njësisë 1.700.000 lekë dhe për kryerjen e shpenzimeve administrative dhe pagesave noteriale. Në referim të akteve të administruara në fashikuj, faktet e rezultuara provojnë të kundërtën e asaj që ka pretenduar subjekti: (i) më datë 13.10.2001⁶¹, subjekti ka deklaruar se ka marrë nga shtetasi R. Gj. [i biri i V.] shumën prej 20.000 USD si paradhënie për blerjen e apartamentit të ndodhur në rrugën “{***}”, pranë Gjykatës së Apelit. Me pagesën e kësaj tjetër në shumën 50.000 USD nga ana e z. R. Gj., i cili do të paguhet deri në datën 31.01.2002, do të lidhet dhe kontrata e shitjes së apartamentit; (ii) më datë 15.03.2002, sipas kontratës së shitblerjes nr.{***}, me blerës znj. V. Gj., subjekti e ka shitur apartamentin në vlerën 2.000.000 lekë, likuiduar jashtë zyrës noteriale. Përkundrejt këtyre fakteve, pretendimet e subjektit *që ka rënë dakord me kunatin që nga shitja e apartamentit të merrte vetëm vlerën e blerjes së njësisë me sipërfaqe 67 m², shumë që në total shkonte rreth 2 milion lekë që pavarësisht çmimit të dakordësuar në deklaratën noteriale nr.{***}, datë 13.10.2001, në kontratën e shitjes nr. {***}, datë 15.03.2002, para së njëjtës notere, u shënuar vlera 2 milion lekë dhe në DIPP-në 2003 është shënuar “dhuruar nga kunati”, janë të pabazuara duke qenë se: (i) në deklaratën noteriale nr. {***}, datë 13.10.2001, nuk është dakordësuar vetëm çmimi i shitjes së apartamentit mes subjektit dhe palës blerëse, por, gjithashtu është deklaruar prej saj marrja e shumës 20.000 USD si paradhënie; (ii) nuk ka asnjë provë që shuma prej 20.000 USD i është kthyer blerësit; (iii) deklarata nr. {***}, datë 13.10.2001, nuk është revokuar prej subjektit me ndonjë deklaratë të mëvonshme. Nën dritën e fakteve të dala nga hetimi administrativ, trupi gjykues vlerëson se me realizimin e*

⁶¹ Nr. {***}, notere M. Xh., Dhoma e Noterisë Tiranë.

këtyre veprimeve juridike subjekti ka shmangur detyrimet tatimore mbi vlerën e saktë të shitjes së apartamentit në bulevardin “{***}”.

35.6. Për pasurinë njësi me sipërfaqe 67,5 m², të ndodhur në “{***}”, Tiranë, në përmbyllje të analizës si më sipër, trupi gjykues arrin në konkluzionin se deklarimi i subjektit të rivlerësimit në deklaratën pasurisë *vetting* ka mospërputhje me deklarimin e bërë në deklaratën fillestare të pasurisë, lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie, e cila nuk arriti të shpjegohej bindshëm prej subjektit të rivlerësimit. Për rrjedhojë, situata kualifikohet, sipas përcaktimeve të nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016. Gjithashtu, nga analiza financiare e kryer në Kolegj, duke e llogaritur vlerën e njësisë sipas çmimit të kontratës së sipërmarrjes së vitit 2001, por edhe sipas çmimit të kontratës së shitjes të vitit 2003, rezultoi se subjekti nuk ka pasur mundësi financiare për të blerë këtë pasuri dhe për të përballuar shpenzimet e tjera familjare: (i) përpara vitit 2003, në shumën 18.294.037 lekë, duke e llogaritur vlerën e njësisë sipas çmimit të kontratës së sipërmarrjes; (ii) gjatë vitit 2003, në shumën 2.761.438 lekë, duke e llogaritur vlerën e njësisë sipas çmimit të kontratës së shitjes. Për rrjedhojë, situata kualifikohet, sipas përcaktimeve të nenit 33, pika 5, gerrat “a” dhe “b” e ligjit nr. 84/2016.

36. Subjekti i rivlerësimit, për pasurinë, automjet tip “Mercedes Benz”, me targa {***}, kundërshton konkluzionet e Komisionit se *nuk ka bërë deklaram të mjaftueshëm në lidhje me këtë pasuri, pasi ka pasaktësi në deklarime dhe mungesë të të ardhurave të ligjshme, shoqëruar me dokumentacion justifikues ligjor nga personi tjetër i lidhur, motra e subjektit*, duke pretenduar për analizë të gabuar të fakteve nga Komisioni se huan e marrë nga motra nuk e ka deklaruar duke e konsideruar marrëdhënie brenda familjes dhe se motra emigrante në Gjermani para vitit 2000 ka pasur gjithnjë punë dhe të ardhura të mira.

36.1. Në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se zotëron automjet tip “Mercedes-Benz”, me targa {***}, blerë në datën 13.9.2009. Vlera: 19.889 euro. Pjesa takuese: 100 %. Si burim krijimi subjekti deklaroi vlerën 9.889 euro nga kursimet dhe vlerën 10.000 euro marrë hua, deklaratë e dorëzuar në ILDKPKI në deklaratimet periodike. Në DIPP-në 2009 deklaroi se *aktualisht disponoj një mjet tip “Mercedes-Benz”, me targa {***}, në vlerën 18.000 euro.*

36.2. Subjekti i rivlerësimit, në DIPP-në 2009 dhe në deklaratimet e viteve në vijim, nuk ka deklaruar si detyrim huan e marrë për krijimin e kësaj pasurie në vlerën 20.000 euro, sipas deklaratës me shkrim dore të datës 06.08.2009 të së motrës së ndjerë, e cila gjendet në dosjen e ILDKPKI-së, por nuk ka datë pranimi, numër protokollit apo procesverbal të nëpunësve të ILDKPKI-së për të qartësuar mënyrën e administrimit të saj apo vlerën 10.000 euro, duke marrë të mirëqenë pretendimin e subjektit për shlyerjet e bëra prej saj brenda vitit 2009. Në deklaratën noteriale të fëmijëve të motrës së ndjerë, dorëzuar prej subjektit gjatë hetimit administrativ, prej tyre deklarohet se *brenda vitit 2009, gojarisht mami të gjithë neve, në prezencë të tezes [subjektit] tha që pjesën tjetër prej 10.000 eurosh, tezja ta mbante si kujtim e dhuratë prej saj. Me largimin nga jeta të mamasë, pavarësisht se tezja donte të na likuidonte, asnjë nga ne nuk i pranoi, sot me anë të kësaj deklaratë, po rikonfirmojmë se si trashëgimtarë të mamasë, ia kemi falur të gjithë shumën hua tezes sonë, duke realizuar përfundimisht amanetin e saj. Pavarësisht zbehjes së forcës provuese të deklaratave noteriale të bëra gjatë procesit të rivlerësimit, nga përmbajtja e saj rezulton që subjektit në vitin 2009 i është dhuruar shuma prej 10.000 eurosh. Mosdeklarimi në deklaratat periodike vjetore i huas apo dhurimit të saj, si burim krijimi të kësaj pasurie, vjen në shkelje të përcaktimeve të ligjit nr. 9049/2003, sikundër edhe mosdeklarimi i faljes së huas vjen në shkelje të përcaktimeve të nenit 4, germës “f” të ligjit sipërcituar. Gjithashtu, subjekti për burimin e*

ligjshëm të huas të dhënë nga e motra, me deklarin se motra ka qenë gjithmonë me punë të mira dhe duke mos paraqitur dokumentacion ligjor justifikues, nuk ka përmbushur detyrimin e buruar nga neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

36.3. Në konkluzion të analizës së mësipërme, lidhur me pasurinë automjet tip “Mercedes-Benz”, me targa {***}, trupi gjykues arriti në përfundimin se subjekti nuk arriti të provonte marrëdhënien e huas/dhurimit me motrën e saj për vlerën 10.000 euro të krijuar në vitin 2009 dhe as burimet e ligjshme të krijimit të kësaj shume prej personit tjetër të lidhur, sipas nenit 32 pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Në konsideratë të këtij konkluzioni u krye analiza financiare në Kolegj, nga e cila rezultoi se subjekti ka mungesë burimesh të ligjshme financiare për të investuar në blerjen e kësaj pasurie dhe për të përballuar shpenzimet e tjera familjare në vitin 2009 në vlerën (-) 5.556.207 lekë, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

37. Për pasurinë ullishte me sipërfaqe 950 m², në Durrës, kundërshtimi prej subjektit të rivlerësimit i konkluzionit të Komisionit se *nuk ka deklaruar saktë në DIPP-të 2003 dhe 2004, pasuritë në pronësi të saj*, duke pretenduar se asnjë marrëdhënie financiare [as blerja dhe as shitja] nuk janë bërë pas fillimit të punës si gjyqtare, në mes të nëntorit 2003, prandaj nuk ka menduar ta shënojë në deklarin të parë përpara fillimit të detyrës, vlerësohet nga trupi gjykues i pabazuar për sa kohë nga aktet e administruara në fashikuj, provohet kryerja e veprimeve juridike në periudhën që subjekti ka pasur detyrimin e deklarin të interesave dhe pasurive, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9046/2003. Konkretisht, në datën 30.12.2002, subjekti në bashkëpronësi me shtetasin K. R. kanë blerë pasurinë ullishte me sipërfaqe 1.900 m², në vlerën 800.000 lekë⁶². Në datën 23.04.2004 me aktpjesëtim vullnetar është bërë ndarja e pronës nga e cila subjekti ka përfituar sipërfaqen⁶³ 950 m². Në datën 24.04.2004 subjekti ka shitur pjesën e saj takuese prej 950 m², në shumën prej 1.500.000 lekësh⁶⁴. Pretendimi i subjektit, se shumën e përfituar nga shitja e kësaj prone e ka marrë paraprakisht në muajin nëntor 2003, vlerësohet i pabazuar nga trupi gjykues për sa: (i) subjekti ka pasur qartësinë për pjesën takuese, pozicionin gjeografik dhe kufizimet e saj, vetëm në vitin 2004, pas aktpjesëtimit të pasurisë në bashkëpronësi, për rrjedhojë në vitin 2003 ka qenë në pamundësi për disponimin e sipërfaqes takuese në bashkëpronësi; (ii) në DIPP-në e vitit 2004, subjekti nuk ka deklaruar të ardhura të përfituara nga shitja e kësaj pasurie. Për rrjedhojë, trupi gjykues i vlerëson të pabazuar pretendimet e subjektit të rivlerësimit, për sa i përket kundërshtimit të konkluzionit të Komisionit se ajo nuk ka deklaruar saktë pasuritë në pronësi në DIPP-të e viteve 2003 e 2004. Në ndryshim nga Komisioni, Kolegji vlerëson se kjo pasaktësi e referuar në deklaratat periodike të pasurisë nuk mund të konsiderohet si një shkak shkarkimi në kuptim të deklarin të pasaktë që konstatohet nga kontrolli i deklaratës së pasurisë *vetting* dhe që vjen në kundërshtim me parashikimin e nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016.
38. Subjekti i rivlerësimit, kundërshton konkluzionin e Komisionit se *subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarin të pasaktë, për shkak se nuk ka deklaruar pronësinë e kuotave të shoqërive “{***}” dhe “{***}” ShPK, në emër të personit të lidhur, K. H., në deklaratën vetting, si dhe ka mungesë të dokumentacionit ligjor justifikues lidhur me burimin e krijimit të tyre nga dhuruesit*, duke pretenduar se: (i) nuk ka deklaruar dhurimet e kuotave në deklaratën *vetting* dhe as në deklaratat e interesave dhe pasurisë të viteve përkatëse, pasi djali nuk e kishte vënë në dijeni të këtyre veprimeve noteriale, pasi në asnjë prej rasteve nuk pati transferim shume në “dhurim” apo

⁶² Kontrata nr. {***}, datë 30.12.2002, notere M. P.: subjekti dhe shtetasi K. R. kanë blerë pasurinë e llojit ullishte me sipërfaqe 1,900 m², në shumën 800.000 lekë.

⁶³ Nr. {***}, datë 23.04.2004.

⁶⁴ Kontratë shitje nr. {***}, datë 24.04.2004.

shpërndarje dividendi në fund të vitit ushtrimor; (ii) djalit i kanë kaluar kuotat e këtyre shoqërive, por jo shuma lekësh; (iii) dy dhurimet duhej të deklaroheshin nga personi i lidhur, në formularët përkatës që plotësoheshin prej tij, por meqë ai as nuk ka paguar as nuk ka fituar, nuk kishte se çfarë të deklaronte. Për këtë pretendimet e ngritura prej subjektit për këtë shkak ankimi, trupi gjykues analizon si vijon.

38.1. Pretendimi i subjektit se *nuk është vënë në dijeni të veprimeve noteriale të dhurimit të kuotave të shoqërisë “{***}”*, rezulton i pabazuar, pasi: *së pari*, në DIPP-në 2015, personi i lidhur [djali], në formularin “Të ardhurat dhe angazhimet në veprimtari publike dhe/ose private” ka deklaruar *administrator dhe ortak i vetëm i shoqërisë “{***}” ShPK, NIPT {***}, nga e cila nuk kam pasur fitime*. Për sa në përmbushje të detyrimeve të ligjit nr. 9049/2003, deklarata e personit të lidhur është dorëzuar prej subjektit së bashku me deklaratën personale, dëshmohet më së paku dijenia e saj për sa deklaruar prej personit të lidhur; *së dyti*, Unioni Financiar ka konfirmuar se K. H. ka pasur marrëdhënie biznesi me shoqërinë “{***}”, me administrator të vetëm shtetasin R. R., e nënkontraktuar prej Unionit në rolin e agjentit në datën 30.07.2014 dhe nga data 09.02.2015, K. H., shfaqet në rolin e administratorit dhe ortakut të vetëm; *së treti*, në DIPP-në 2015, personi i lidhur në formularin “Ndryshimet e pasurive dhe burimi i krijimit” ka deklaruar “Pakësim në pasuri si rezultat i depozitimit të një garancie depozitë pranë Western Union” dhe në datën 19.2.2015, subjekti i rivlerësimit ka tërhequr shumën 20.000 euro nga llogaria e saj “Tirana Bank”, me përshkrim “Western Union, arsye biznesi lik aksioneri”. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se në kushtet e dijenisë të dinamikave të angazhimit privat të personit të lidhur, të kryerjes së veprimeve financiare në mbështetje të tyre, pretendimi për padijeni të veprimeve noteriale të dhurimit të kuotave nga ana e personit të lidhur, është i pabazuar.

38.2. Pretendimi i subjektit se nuk pati transferim shume në “dhurim”, se personit të lidhur i kanë kaluar kuotat e shoqërisë por jo shuma lekësh, vlerësohet nga trupi gjykues i pabazuar për sa nga faktet e dala nga hetimi administrativ, rezulton se:

38.2.1. Me marrëveshjen e transferimit të pjesëve të kapitalit, z. R. R., në cilësinë e ortakut që zotëron 100% të kuotave të kapitalit të shoqërisë “{***}” ShPK, të regjistruar sipas legjislacionit përkatës, me një kapital 1.000.000 lekë, i ka transferuar 100% të kuotave në pronësi të K.H., pa kundërshtim. Marrëveshja për transferimin e pjesëve të kapitalit prej 1.000.000 lekësh është pasqyruar në faqen zyrtare të QKB-së. Në këtë situatë, mosdeklarimi i dhurimit vjen në kundërshtim me germën “f”, të nenit 4 të ligjit nr. 9049/2003, i cili përcakton detyrimin e deklarimit të dhuratave apo trajtimeve preferenciale, si edhe identitetin e personit prej nga vijnë apo krijohen dhuratat a trajtimet preferenciale me vlerë mbi 10.000 lekë. Përkundëjt situatës faktike të provuar me akte dhe informacion zyrtar, deklarata noteriale e z. R. R. në datën 27.01.2020, sipas së cilës shuma prej 1.000.000 lekësh është shënuar në mënyrë simbolike në statutin e shoqërisë, por nuk ka ekzistuar as në kohën e krijimit të shoqërisë e as në kohën e dhurimit të kuotave, jo vetëm që nuk i ka shërbyer provueshmërisë, lidhur me burimin e krijimit të vlerave të kuotave të dhuruara, por rinxjerr sërish në pah zbehjen e fuqisë provuese të deklaratës noteriale bërë gjatë procesit të rivlerësimit, sikundër Kolegji ka mbajtur qëndrimin në jurisprudencën e tij.

38.2.2. Me “Kontratë për dhurimin e aksioneve” nr.{***}, datë 21.07.2012, z. F. R. i ka dhuruar personit të lidhur 14% të aksioneve të shoqërisë “{***}” ShA që zotëroheshin prej tij, kontratë e pasqyruar në faqen zyrtare të QKB-së, ku vlera e aksioneve të dhuruara evidentohet 2.800.000 lekë, vlerë e shtuar nga ajo prej 280.000 lekësh që kishte më parë. Mosdeklarimi prej subjektit i

këtij dhurimi në deklaratën *vetting* vjen në kundërshtim me përcaktimet kushtetuese dhe ligjore dhe pretendimet e subjektit për mos kalim të ndonjë shume në “dhurim” vlerësohen nga trupi gjykues të pabazuara. Për pretendimin e subjektit, se në *dijeninë tonë nga viti 2014 e vijim shtetasi F. R. ndodhet jashtë Shqipërisë e, për këtë shkak, nuk u mundësua ndonjë deklaratë pohimi e fakteve*, trupi gjykues vlerëson subjekti nuk ka qenë në kushtet e pamundësisë objektive, sipas parashikimeve të pikës 2, neni 32 të ligjit nr. 84/2016, për të siguruar dokumentacion ligjor provues për ligjshmërinë e burimeve të krijimit të vlerave të kuotave të dhuruara prej z. F. R., për rrjedhojë subjekti nuk ka arritur të përmbushë detyrimin e pikës 4, neni 32 të ligjit nr. 84/2016.

38.3. Pretendimi i subjektit se dy dhurimet duhej të deklaroheshin nga personi i lidhur [djali], në formularët përkatës që plotësoheshin prej tij, vjen në kundërshtim me përcaktimet e pikës 1, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, ku përcaktohet se: *“Subjektet e rivlerësimit i nënshtrohen deklaratimit dhe kontrollit të pasurive të tyre, me qëllim që të identifikohen ata që kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht ose ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur”*. Situata faktike, ku subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe as në deklaratat periodike të viteve përkatëse, dhurimin e këtyre kuotave, në kundërshtim me parashikimet e nenit D, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës dhe shtojcës nr. 2 të ligjit nr. 84/2016 dhe nuk ka arritur të provojë burimin e ligjshëm të krijimit të këtyre pasurive prej personave të tjerë të lidhur, në zbatim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, e kualifikon subjektin e rivlerësimit, sipas përcaktimeve të nenit 33, pika 5, geramat “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016.

39. Subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionin e Komisionit lidhur me ndërtimin pa leje, *se ka cenuar besimin e publikut dhe ka cenuar etikën së magjistratit*, duke pretenduar se këto dy elementë janë të mirëpërcaktuar në formulimin e tyre, lidhen me veprime apo sjellje që konsiderohen se përbëjnë shkelje të normave ligjore dhe në rastin e saj nuk mund të cenohen nga një ndërtim pa leje i realizuar me iniciativën e djalit të saj, i cili është nxitur kryesisht nga parashikimet e kuadrit ligjor të kohës⁶⁵.

39.1. Lidhur me pretendimin e subjektit, se *me këtë konkluzion vërtetohet qëndrimi me dy standarde i Komisionit, i cili është i ndryshëm në raste të ndërtimeve pa leje që i përkasin magjistratëve të tjerë*, Kolegji ka një jurisprudencë të konsoliduar⁶⁶, ku, nën dritën e parimeve kushtetuese dhe të jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese, ka analizuar se nuk prezumohet që të ketë zgjidhje të njëjlojta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Barazia në ligj dhe para ligjit presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta. Procesi kushtetues i rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, rregullat e posaçme të përcaktuara në ligjin nr. 86/2014, roli dhe kompetencat që ky ligj i njeh Kolegjit të Posaçëm të Apelit, për shqyrtimin e ankimeve ndaj vendimeve të Komisionit, përbëjnë garanci të plota për të përmbushur qëllimin dhe objektin e ligjit. Në referim të shkaqeve të ankimit, pretendimet, shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit i nënshtrohen shqyrtimit dhe vlerësimit përgjatë procesit gjyqësor në Kolegjin e Posaçëm të Apelit.

39.2. Kolegji ka një jurisprudencë të konsoliduar, lidhur me aplikimin e masës disiplinore të shoqëruar dhe me cenimin e besimit të publikut, ku është analizuar gjerësisht se subjektet e

⁶⁵ Subjekti referon shtyrjen disa herë të afateve të vetdeklarimit të ndërtimeve pa leje, politikat qeveritare të kësaj periudhe që hapën rrugën si për dënimin e atyre që ndërtonin pa leje dhe për legalizimin e atyre që ndërtonin pa leje

⁶⁶ Shih vendimet nr. 7, datë 05.04.2019 dhe nr. 34, datë 15.11.2021, e Kolegjit.

rivlerësimit kanë përgjegjësinë që edhe në jetën jashtëgjyqësore të mos cenojnë autoritetin e pushtetit gjyqësor me sjellje që afektojnë drejtpërdrejt besimin e publikut te sistemi i drejtësisë.⁶⁷ Gjithashtu, rëndësia e integritetit të figurës së gjyqtarit apo prokurorit, theksuar në një numër aktesh ndërkombëtare⁶⁸, kërkon që gjykatësi të këtë një sjellje të denjë përkundrejt një vëzhguesi të arsyeshëm. Pretendimi i subjektit se ndërtimi pa leje është realizuar me iniciativë të djalit të saj vlerësohet nga trupi gjykues jo koherent për sa ky ndërtim ka filluar dhe është zhvilluar në truallin në bashkëpronësi të subjektit, sikundër prej saj janë ndërmarrë veprime për të fituar pronësinë për sipërfaqe të tjera trualli në funksion të këtij ndërtimi: kërkuar dhe fituar gjyqësish pronësinë për truallin me sipërfaqe 142 m²,⁶⁹ aplikuar dhe fituar përmes procesit të legalizimit pronësinë për truallin me sipërfaqe 150 m². Trupi gjykues, në vlerësim të fakteve dhe rrethanave në të cilat ato kanë ndodhur, mban në konsideratë se:

39.2.1. Ndërtimi informal i objektit 10 kate, në shkelje të parashikimeve të ligjit nr. 8405/1998, “Për urbanistikën”,⁷⁰ në një kohë që ky veprim parashikohej nga legjislacioni si vepër penale,⁷¹ dëshmon se në kundërshtim me ligjin subjekti ka dakordësuar veprimet e personit të lidhur për realizimin e këtij ndërtimi, duke u përfshirë edhe vetë në këto veprime dhe, për rrjedhojë, ka cenuar vlerat e sjelljes që gjyqtari duhet të demonstrojë si dëshmi e integritetit të tij.

39.2.2. Fakti që jo për arsye të diktuar nga nevoja bazike për strehim, por për ndërtimin të një objekti me qëllim përfitimi pasuror dhe maksimalizimit të këtij përfitimi, dëshmuar nga madhësia e ndërtimit pa leje, janë arsye më se evidente për cenimin e besimit të publikut te drejtësia, për sa individit dhe funksioni të cilin ai kryen ndërthuren në mënyrë të pandarë. Pavarësisht qëndrimit të mbajtur më lart e me anë të të cilit konfirmohet qëndrimi i Komisionit, lidhur me konstatimin dhe vlerësimin e situatës faktike si një sjellje jashtëgjyqësore e subjektit që cenon besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, trupi gjykues vlerëson se ky konkluzion nuk mund të ngrihet në nivelin e një shkaku shkarkimi, sipas parashikimit të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, për shkak të faktit se procesi i rivlerësimit të subjektit mbështetet në vlerësimin e dy prej tre kriterëve të rivlerësimit. Në kushtet kur ushtrimi i kontrollit për vendimin e Komisionit, nuk përfshin kriterin profesional, por dy kriteret e tjera mbi të cilat është marrë vendimi, dhe kjo çështje konsiderohet se nuk bën pjesë brenda vlerësimit të këtyre kriterëve, qëndrimi i Komisionit mbi problematikat që lidhen me ndërtimin e paligjshëm, u konsiderua si jo përcaktues për zgjidhjen e çështjes.

⁶⁷ Shih vendimet nr. 17/2019, nr. 26/2019, nr. 34/2019, nr. 26/2020, nr. 35/2020.

⁶⁸ “Parimet themelore të pavarësisë së sistemit të drejtësisë” i OKB-së, 1985, “Parimet e Bangalor-it për sjelljen në sistemin gjyqësor”, 2002, “Udhëzuesi evropian për etikën dhe sjelljen e prokurorëve”, i Këshillit Konsultativ të Prokurorëve Evropianë, 2005 etj., të cilat i drejtohen drejtpërdrejt gjyqtarëve, definojnë kodin e etikës së gjyqtarëve, duke identifikuar integritetin si njërin prej vlerave themelore që duhet të demonstrojnë edhe në sjelljen e tyre jashtëgjyqësore.

⁶⁹ Në datën 20.01.2012, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë regjistruar kërkesë padinë me objekt “Anulimin e shkresës nr. {***} prot., datë 19.05.2011, të ZVRPP-së Tiranë. Detyrimin e palës së paditur ZVRPP Tiranë të regjistrojë në emër të palës paditëse pasurinë e paluajtshme, tokë me sipërfaqe 390 m², të ndodhur në Tiranë, {***}, të liuar nga largimi i rrjedhës së ujit”. Gjykata ka pranuar pjesërisht padinë, duke u shprehur për detyrimin e ZVRPP të regjistrojë në emër të palës paditëse sipërfaqen prej 142 m².

⁷⁰ Ligji nr. 8405/1998, “Për urbanistikën”, në nenin 45 parashikon: “Çdo person fizik e juridik, vendas ose i huaj, që do të ndërtojë në territorin e Republikës së Shqipërisë duhet të pajiset me leje ndërtimi. Ky është dokumentacioni i vetëm ligjor mbi bazën e të cilit lejohet ndërtimi”.

⁷¹ Ndërtimi i paligjshëm është parashikuar si vepër penale me ndryshimet e Kodit Penal të miratuara me ligjin nr. 10023, datë 27.11.2008, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të cilat kanë hyrë në fuqi më datë 15.01.2009.

40. Lidhur me konkluzionet e Komisionit, *se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë mungesë të ardhurash të ligjshme për blerjen e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve në vlerën 18.799.664 lekë, për periudhën përpara vitit 2003 dhe në vlerën totale prej 80.805.536 lekësh, për vitet 2003, 2005, 2006, 2007, 2008, 2009, 2010, 2011, 2012, 2013, 2015 dhe 2016*, subjekti i rivlerësimit i kundërshton, duke pretenduar përfshirjen në analizën financiare të vlerave të papërfshira sipas saj, kryesisht të likuiditeteve *cash*, si dhe për ndryshim të vlerave në disa raste. Sipas pretendimeve të subjektit, për periudhën para vitit 2003 deri në dhjetor 2016, të gjithë vitet dalin me balancë pozitive, gjë që çon në përfundimin se për periudhën e analizuar ajo dhe personat e lidhur kanë pasur burime financiare të ligjshme për krijimin e pasurive dhe përballimin e shpenzimeve familjare dhe, nëse për arsye të ndryshme i është dashur të marrë kredi, hua nga familjarët apo të investojë me risk, ka pasur gjithnjë mundësi likuidimi të tyre. Lidhur me këto pretendime, trupi gjykues analizon si vijon.

40.1. Subjekti nuk ka deklaruar gjendje të likuiditetit *cash* jashtë sistemit bankar në deklaratat periodike për periudhën 2003-2014. Në ankim nga ana e saj pretendohet se *...[..] plotësimi i gjendjes cash në DIPP vonë na u bë e ditur nga institucioni përkatës që duhet ta reflektonim. Gabime materiale në mosinterpretim të saktë se çfarë kërkohej në formularë, mundësia e kufizuar e informacionit në qelizat përkatëse ndonjëherë na bënte të reflektonim shkurt çfarë kërkohej, duke menduar që më hollësisht inspektorët do t'i gjenin pikërisht në to.[..]* Mospërmbushja e detyrimit të germës “d”, neni 4 të ligjit nr. 9049/2003, sipas të cilit subjektet kanë detyrimin të deklarojnë vlerën e likuiditeteve, gjendjen në *cash* jashtë sistemit bankar në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj, detyrim i qartësuar edhe në formularë, nuk është pranuar prej Kolegjit si një gabim material. Në materialin oponent të dorëzuar në datën 05.06.2020, pas njohjes me rezultatet e hetimit administrativ kryesisht, subjekti, në analizën financiare të përpiluar prej saj, nuk ka vendosur vlera për kursime *cash*, ndërsa në analizën financiare të paraqitur në seancë dëgjimore, datë 15.06.2020, ka vendosur vlera për kursime *cash*. Në konsideratë të qëndrimit të mbajtur nga Kolegji,⁷² për sa subjekti nën përgjegjësinë e ligjit nr. 9049/2003, në deklaratimet periodike nuk ka deklaruar gjendje likuiditeti *cash*, në kuptim të përcaktimeve të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, pretendimi i subjektit, gjatë procesit të rivlerësimit për gjendje të likuiditetit *cash* jashtë sistemit bankar për periudhën 2003-2014, mbetet i paprovuar.

40.2. Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar të ardhura nga dhënia me qira në periudha të ndryshme e njësisë që gjendet në zonën kadastrale {***}, nr. pasurie {***}, adresa “{***}”, me sipërfaqe 67.5 m², në shumën 3.050.000 lekë. Në deklaratat e interesave private të pasurisë qysh nga viti 2003 e në vijim, subjekti ka deklaruar të ardhura nga dhënia me qira e kësaj njësie. Për çdo vit të deklaratimit, trupi gjykues konstaton se shumatat e deklaruara nga subjekti në DIPP nuk përputhen me të ardhurën vjetore që rezulton nga përllogaritja sipas vlerës mujore të qirasë të përcaktuar në kontratat respektive. Në analizën financiare të paraqitur prej subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues konstaton se vlerat e qirasë: (i) të çdo viti nuk përputhen me shumën e përllogaritur sipas vlerës mujore të qirasë të përcaktuar në kontratat respektive; (ii) totali i shumave të pasqyruara për të ardhurat vjetore nga qiraja në vite nuk përputhet me shumën e deklaruar në deklaratën *vetting*. Subjekti pretendon përfshirjen në analizën financiare vjetore të vlerave të të ardhurave nga qiraja, sipas shifrave të pasqyruara prej saj, pa dhënë shpjegime për mospërputhjet e këtyre vlerave me përllogaritjet, sipas vlerës së qirasë në kontratat respektive apo edhe me vlerat deklaruara prej saj në DIPP. Gjithashtu, subjekti nuk jep shpjegime lidhur me shlyerjen e tatimeve

⁷² Shih vendimet nr. 11, datë 22.05.2019(JR); nr. 19, datë 26.07.2019(JR), e Kolegjit.

për të ardhurat nga qiraja, shkak për të cilin prej Komisionit këto të ardhura nuk janë përfshirë në analizën financiare, kjo edhe në kushtet kur nga informacioni i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve rezultoi që për të gjithë periudhën e qiradhënies së kësaj njësie nuk janë paguar tatimet mbi të ardhurat nga qiratë. Referuar përcaktimeve të kuadrit ligjor të kohës për tatimet⁷³ dhe bazuar në të dhënat e kontratave të qirave të administruara në fashikuj sa i përket qiramarrësve, trupi gjykues evidentoi periudhat kur detyrimi për pagimin e tatimit i atribuohet qiramarrësit për shkak të cilësisë person fizik apo juridik, por në kushtet kur shuma e deklaruar prej subjektit në DIPP tejkalon vlerën e përlogaritur sipas çmimit të përcaktuar në kontratë, trupi gjykues vlerëson se edhe në këto raste të ardhurat e subjektit nuk plotësojnë kriteret e të ardhurës së ligjshme, e parë në këndvështrim të sjelljes e dijenisë së subjektit për mospagimin e detyrimeve tatimore. Kolegji, vlerëson se me të drejtë Komisioni ka ngarkuar me përgjegjësi subjektin për mospagimin e këtyre detyrimeve për gjatë gjithë periudhës që objekti është dhënë me qira, për shkak të moskrijimit të bindjes për sa subjekti ka deklaruar. Në këto rrethana, edhe në analizën financiare të kryer në Kolegj, këto të ardhura nuk janë konsideruar se plotësojnë kriteret e parashikuara nga neni 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016, për të ardhurën e ligjshme.

40.3. Subjektit pretendoi reduktimin e shpenzimeve të personave të lidhur: (i) të vajzës R. H. në SHBA, të shpenzimeve të akomodimit për periudhën 2002-2005, sipas saj e akomoduar te të afërm dhe të shpenzimeve të shkollimit për periudhën 2005-2009, sipas saj financuar në masën 75% nga shteti, si dhe nga shkolla për rezultatet e saj; (ii) të djalit K.H. për periudhën 1999-2003 në Francë, si të akomodimit ashtu edhe të shkollimit në kolegjin {***} Francë, sipas saj të mbuluara nga Ambasadori i Francës në Shqipëri, si dhe nga familja L.P. (drejtor i Akademisë Franceze), pretendime të cilat mbetën në nivel deklarativ, për sa subjekti nuk dorëzoi asnjë provë në kuptim të ligjit për të provuar ato, për rrjedhojë trupi gjykues i vlerëson këto pretendime të pabazuara.

40.4. Subjektit pretendoi reduktimin e shpenzimeve të udhëtimeve të saj dhe personave të lidhur jashtë vendit, sipas saj të mbuluara nga institucionet [në rastin e vajzës], nga shkolla [në rastin e djalit] apo nga të afërmit, por edhe këto pretendime nuk u provuan nga ana e subjektit me prova apo dokumentacion, për rrjedhojë trupi gjykues i vlerësoi ato të pabazuara.

40.5. Nga analiza financiare e kryer në Kolegj, në konsideratë edhe të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit të ngritura në ankim, ajo sërish gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive dhe përballimin e shpenzimeve të kryera: (i) duke referuar për blerjen e njësisë në “{***}”, vlerën e përcaktuar në kontratën e sipërmarrjes, në vlerën 18.294.037 lekë përpara vitit 2003 dhe në vlerën 68.162.663 lekë gjatë periudhës 2003-2016; (ii) duke referuar për blerjen e kësaj njësie vlerën e përcaktuar në kontratën e shitblerjes, në vlerën 1.423.263 lekë përpara vitit 2003 dhe në vlerën 69.862.663 lekë gjatë periudhës 2003-2016. Kjo situatë faktike kualifikohet nga trupi gjykues, sipas parashikimeve të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

⁷³ Referuar në ligjin nr. 8438/1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, ndryshimet që u bënë me ligjin nr. 8841/2001, bënë ndryshime në nenet 33/1 dhe 34/4, duke përcaktuar: “Një person i cili i paguan një individ rezident të ardhura nga kontratat e qirasë, mban tatimin për këto të ardhura në masën 10%. Ky do të jetë tatimi përfundimtar i pagueshëm për këto të ardhura nga qiradhënia dhe kushtet e parashikuara në nenin 8, dhe ato në paragrafin e dytë të nenit 9 të këtij ligji, nuk zbatohen”. Referuar Udhëzimit nr. 3, datë 11.02.2002, pikën 4.1.5.1., përcaktohet se: “Në kuptim të pikës “d” të nenit 33 të ligjit lidhur me tatimin e mbajtur në burim për qiradhënie, çdo tatim pagues i regjistruar si subjekt i TVSH-së apo biznesit të vogël apo çdo person tjetër (ent i çfarëdoshëm), për rastet kur paguan detyrim qiraje për ndërtesa apo tokë të marrë prej tij, është i detyruar që kur bën pagesat e qirasë, të mbajë tatimin në burim dhe ta transferojë atë në buxhet...”.

41. Në konkluzion të sa më sipër, Kolegji vlerësoi se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe gjendet në kushtet e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

Ç. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit lidhur me kriterin e kontrollit të figurës

42. Subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionin e Komisionit se *nuk ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, pasi ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kontrollin e figurës, duke mos plotësuar formularin e deklaramit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi, si dhe duke fshehur fakte e rrethana të ndodhura para deklaramit, sipas ligjit të këtij formulari, në kushtet kur subjekti ka qenë në dijeni të këtij faktit duke pretenduar se: (i) pas datës 27.01.2017 është telefonuar nga Ambasada e SHBA dhe njoftuar se duhet të paraqitej dhe vetëm ditën që ka shkuar në ambasadë [data nuk i kujtohet, por ka qenë pas datës 27.01.2017, kur ka dorëzuar formularin pranë DSIK-së], nga Konsullja i është komunikuar që kanë proceduar me revokimin e vizës B1/B2, duke e sqaruar verbalisht se viza është revokuar deri në përfundim të procesit *vetting*; (ii) vula e vendosur mbi vizë nuk shoqërohet me datë në mënyrë që ta konfirmojë me bindje datën e revokimit; (iii) deklaratën për kontrollin e figurës e ka plotësuar duke mos pasur asnjë dijeni për deklaratën publike të Ambasadës së SHBA-së, deklaratë e cila nuk kishte emra konkretë; (iv) për të vërtetuar pretendimet e saj i është drejtuar dhe ridrejtuar Ambasadës së SHBA-së, por nuk ka marrë përgjigje dhe në dijeni të saj deri në datën e dorëzimit të ankimit shërbimet konsullore janë pjesërisht të mbyllura, për shkak të gjendjes së pandemisë; (v) në dosjen hetimore të Komisioni nuk gjendet asnjë shkresë apo tabulat telefonik që të vërtetojë që në datën 26 janar, ditën e plotësimit të deklaratës dhe në datën 27 janar, ditën e dorëzimit të saj, të jetë vënë në dijeni të revokimit të vizës nga Ambasada e SHBA-së. Lidhur me pretendimet e subjektit për këtë shkak ankimi, trupi gjykues analizon si vijon.*

42.1. Referuar raportit të DSIK-së⁷⁴, në datën 26.01.2017, subjektit të rivlerësimit i është revokuar viza e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe është njoftuar personalisht ose me shkrim në datën 26.01.2017. Pretendimi i subjektit se DSIK-ja ka pohuar se ajo është njoftuar personalisht ose me shkrim në datën 26.01.2017 për revokimin e vizës, por nuk e ka vërtetuar, duke vepruar në tejkalim të detyrimit ligjor të verifikimit të të dhënave, vlerësohet i pabazuar në kuptim të përcaktimeve të ligjit nr. 8457/1999 “Për informacionin e klasifikuar ‘Sekret Shtetëror’”, të ndryshuar.⁷⁵ Bazuar në rolin dhe misionin e DSIK-së, procedurat në bazë të së cilave ky institucion ushtron kompetencat dhe përgjegjësitë, të përcaktuara në ligj e të detajuara në kuadrin nënligjor përkatës, DSIK-ja, duke u shprehur në raport se *në vlerësim të të dhënave të ardhura pas konstatimit fillestar mbi subjektin e rivlerësimit*, dëshmon se përfundimi i arritur nga ky institucion, mbi papërshtatshmërinë e vijimit të detyrës nga subjekti i rivlerësimit, nuk është i pabazuar në të dhëna të administruara nga ky institucion në përputhje me rolin dhe misionin e tij.

42.2. Shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në ankim me shpjegimet e dhëna prej saj gjatë hetimit administrativ dëshmojnë për mungesë konsistence: (i) lidhur me marrjen e telefonatës nga Ambasada e SHBA-së, në ankim deklaroi se e ka marrë pas datës 27 janar, në përgjigje të pyetësorit nuk referohet kohë apo datë; (ii) lidhur me paraqitjen në Ambasadën e SHBA-së, në

⁷⁴ Raporti mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit Fatmira I. Hajdaraj, deklasifikuar plotësisht me vendim nr. {***}, datë 06.02. 2020, të KDZh-së dërguar në Komision me shkresën nr. {***} prot., datë 18.02.2020.

⁷⁵ Ligji nr. 8457/1999 “Për informacionin e klasifikuar “Sekret Shtetëror””, i ndryshuar, në nenin 2 përcakton “Informacion” do të thotë çdo njohuri që mund të komunikohet apo të dokumentohet, pavarësisht nga forma dhe që është nën kontrollin e shtetit.

ankim shprehet se përmes telefonatës është njoftuar se duhet të paraqitej pranë tyre [data kur është paraqitur nuk i kujtohet], në përgjigje të pyetësorit shprehet se i është kërkuar të paraqitej pas muajit janar; (iii) lidhur me komunikimin e revokimit të vizës B1/B2, në ankim shprehet se ditën që ka shkuar në ambasadë [data nuk i kujtohet, por ka qenë pas datës 27.01.2017, kur ka dorëzuar formularin pranë DSIK-së], nga Konsullja i është komunikuar që kanë proceduar me revokimin e vizës B1/B2 duke e sqaruar verbalisht se viza është revokuar deri në përfundim të procesit *vetting*], në përgjigje të pyetësorit shprehet se në momentin që është paraqitur në Ambasadën e SHBA-së i kanë mbajtur pasaportën dhe pas disa ditëve e kanë kontaktuar sërish dhe e kanë njoftuar që duhej të paraqitej për tërheqjen e pasaportës, ku i është komunikuar që kanë proceduar me revokimin e Vizës B1/B2 Amerikane. Trupi gjykues, nisur nga referimi i të dhënave të ndryshme, evidenton rëndësinë që ka konsistenca në shpjegime në funksion të krijimit të bindjes për saktësinë e të dhënave të referuara e që lidhen me momente me rëndësi për procesin e rivlerësimit.

41.3. Sipas qëndrimit të Ambasadës së SHBA-së të bërë publik në datën 26 janar 2017⁷⁶ është deklaruar se: *“Ambasada e Shteteve të Bashkuara ka revokuar vizat joemigruese për disa gjyqtarë dhe prokurorë shqiptarë, pasi ka dalë në përfundimin që këta zyrtarë nuk kualifikohen për këto viza. Për shkak se të dhënat e vizave janë konfidenciale, sipas ligjit të Shteteve të Bashkuara, ne nuk mund të komentojmë mbi raste individuale. Ambasada e Shteteve të Bashkuara e ka ndër marrë këtë veprim përpara procesit të pritshëm të vetting-ut, i cili do të vlerësojë lidhjet e zyrtarëve të caktuar me korrupsionin, si dhe në përgjigje të një rasti që përfshinte abuzim flagrant të një vize zyrtare nga një prokuror i nivelit të lartë dhe bashkëshortja e tij, gjë që çoi në revokimin e vizave të tyre. Ambasada e Shteteve të Bashkuara i merr seriozisht akuzat për korrupsion dhe do të vazhdojë t’i shqyrtojë vizat dhe aplikimet për vizë të zyrtarëve të drejtësisë me vëmendje të shtuar. Departamenti i Shtetit ka një autoritet të gjerë për të mohuar dhe revokuar viza, bazuar në informacione që tregojnë se zotëruesi i vizës mund të jetë i papranueshëm në Shtetet e Bashkuara dhe Departamenti i Shtetit do të vazhdojë ta përdorë këtë autoritet për t’i çuar përpara përpjekjet kundër korrupsionit në Shqipëri”*. Referuar informacioneve nga burime të hapura, po në datën 26.01.2017, në mediat elektronike i është bërë menjëherë jehonë qëndrimit publik të Ambasadës së SHBA-së. Në datën 28.01.2017, referuar në burime pranë gjykatave dhe prokurorive, mediat kanë informuar se Ambasada Amerikane në Tiranë në mënyrë individuale ka njoftuar të gjithë ata gjyqtarë e prokurorë që u është revokuar viza amerikane⁷⁷ dhe për informacionin se gjyqtarët e prokurorët të cilëve iu është revokuar viza janë parë ditën e premte [datë 27.01.2017] në hyrje të Ambasadës dhe se prej tyre është sqaruar se revokimi i vizës i është bërë nga zyra konsullore. Në vijim, në burimet të hapura të datës 2.02.2017 [faqet elektronike të mediave të shkruara] është botuar lista e gjyqtarëve dhe prokurorëve të cilëve iu ishte revokuar viza nga kjo ambasadë, ku përfshihet edhe emri i subjektit⁷⁸. Edhe në këndvështrim të informacionit të publikuar nga mediat, i cili ka referuar burime pranë gjykatave dhe prokurorive apo dhe vetë subjekteve të cilëve i është revokuar viza, pretendimet dhe shpjegimet e subjektit vlerësohen të pabazuara.

41.4. Në konkluzion të kësaj analize, lidhur me kriterin e kontrollit të figurës, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se subjekti nuk arriti të provonte të kundërtën e konkluzionit të Komisionit se ajo ishte njoftuar personalisht ose me shkrim për revokimin e vizës nga Ambasada e SHBA-së, në

⁷⁶ <https://al.usembassy.gov/sq/deklarate-e-ambasades-se-shteteve-te-bashkuara-te-amerikes-5/>.

⁷⁷ <https://www.standard.al/2017/01/28/ambasada-e-shba-se-therret-gjyqtaret-dhe-prokuroret-ge-u-revokoi-vizat/>, <https://www.gazetatema.net/2017/01/28/ambasada-e-shba-se-therret-gjyqtaret-dhe-prokuroret-ge-u-revokoi-vizat/>.

⁷⁸ <https://www.balkanweb.com/lista-e-zeze-kush-jane-gjyqtaret-e-prokuroret-ge-ambasada-e-shba-iu-refuzoi-vizat-emrat/>.

Tiranë, në datën 26.01.2017, një ditë para dorëzimit fizikisht të deklaratës për kontrollin e figurës. Në konsideratë të këtij vlerësimi, arrihet në konkluzionin se subjekti ka dorëzuar formularin të plotësuar në mënyrë të pasaktë dhe jo në përputhje me parashikimet e pjesës 5, germa “g” e shtojcës 3 të ligjit nr. 84/2016. Mosdeklarimi i kësaj rrethane, në përputhje me kërkesat e nenit Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, e vendos subjektin në kushtet e deklaramit të pamjaftueshëm lidhur me kriterin e kontrollit të figurës, sipas parashikimit të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

43. Pas shqyrtimit gjyqësor të çështjes dhe analizimit të rrethanave si më lart, trupi gjykues, bazuar në konkluzionet e mësipërme, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, znj. Fatmira Hajdaraj, ka bërë deklaramit të pamjaftueshëm lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe kriterin e kontrollit të figurës dhe nën dritën e parashikimeve të nenit D, pikat 1, 2 dhe 3 dhe nenit Dh, pika 4 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, vlerësohet se vendimi nr. 265, datë 18.06.2020, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që ka vendosur shkarkimin e saj nga detyra është i mbështetur në prova e në ligj dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në nenin 66, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 265, datë 18.06.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Fatmira Hajdaraj (Hajdari).
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 24.10.2022, në Tiranë.

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

RELATORE

Ina RAMA

nënshkrimi

KRYESUESE

Natasha MULAJ

nënshkrimi